



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada – Government

*Ministria e Arsimit, Shkencës dhe e Teknologjisë
Ministarstvo Obrazovanja, Nauke i Tehnologije
Ministry of Education Science & Technology*

Kurrikula Bërthamë

për arsimin e mesëm

të lartë


(Klasa X, XI, XII)



S

(2012)

Georg-Eckert-Institut BS78



1 170 560 4



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë
Ministarstva Obrazovanja Nauke i Tehnologije
Ministry of Education Science and Technology

KURRIKULA BËRTHAMË

PËR ARSIMIN E MESËM TË LARTË TË KOSOVËS

(Klasa X, XI, XII)

MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCËS DHE E TEKNOLOGJISË

Këshilli redaktues:

Nehat Mustafa

Drita Kadriu

Ramush Lekaj

Redaktori gjuhësor:

Sulejman Dermaku

Georg-Eckert-Institut -
Leibniz-Institut für internationale
Schulbuchforschung
- BIBLIOTHEK -

Radhitja:

2014/240

Granit Salihu

Ballina:

RKS

Granit Salihu

Z-5

(1, 2012)



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada-Government

Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe Teknologjisë- Ministarstva za Obrazovanje Nauku i
Tehnologiju-Ministry of Education Science & Technology

Kabineti i Ministrit /Kabinet Ministra / Cabinet of the Minister

Nr. 290/018

Datë: 22.10.2012

Ministri i Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT), në mbështetje të neneve 4, 21, 22 të Ligjit nr. 03/L-189 për administratën shtetërore të Republikës së Kosovës, (Gazeta zyrtare, nr. 82, 21 tetor 2010) si dhe duke u bazuar në nenin 8 paragrafi 1.4 dhe shtojcën 6 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive (22.03.2011) si dhe në Kornizën e Kurrikulës së Arsimit Parauniversitar të Republikës së Kosovës, miratuar me vendimin nr.262/018 të datës 29.08.2011, nxjerr:

V E N D I M

1. Miratohet dokumenti: Kurrikula bërthamë për arsimin e mesëm të lartë të Kosovës.
2. Dokumenti: Kurrikula bërthamë për arsimin e mesëm të lartë të Kosovës, është i kompletuar dhe i zbatueshëm në arsimin parauniversitar të Kosovës.
3. Vendimi hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

A r s y e t i m

Dokumenti: Kurrikula bërthamë për arsimin e mesëm të lartë, synon ndryshimin e vazhdueshëm dhe progresiv të arsimit parauniversitar në Republikën e Kosovës, vendos themelet për ngritjen e cilësisë dhe të barazisë në zbatimin e kurrikulave për të gjithë nxënësit /et . Ky dokument do të shërbejë si bazë e mirë për hartimin dhe zbatimin e një vargu të dokumenteve tjera, planeve dhe programeve, teksteve shkollore dhe udhëzuesve tjerë pedagogjikë për zhvillimin e arsimit në nivelin e tretë të arsimit parauniversitar, prandaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi u dërgohet:

1. Kabinetit të Ministrit;
2. Zyrës së SP;
3. Departamentit të ZHAP;
4. DL;
5. Arkivit.

Prof. dr. Ramë Buja, ministër



Fjala e Ministrit

Nxënës, mësimdhënës, prindër, përfaqësues të arsimit dhe ju qytetarë të Republikës së Kosovës, një vit më parë në duart e të gjithë atyre që në çfarëdo mënyre janë të ndërlidhur me arsimin parauniversitar, Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë e Republikës së Kosovës, pasi e miratoi, solli Kornizën e Kurrikulës të Arsimit Parauniversitar të Kosovës. Ndërsa, tani bazuar në këtë dokument - Kurrikula bërthamë, promovohet vizioni i ri shumë më i përimtuar e i konkretizuar i Qeverisë së Republikës së Kosovës.

Ky dokument u dedikohet dhe ju shërben mësimdhënësve, nxënësve, prindërve, drejtorëve të shkollave dhe komunitetit në përgjithësi. Rëndësia e Kurrikulës Bërthamë, struktura, qëllimet dhe parimet e arsimit parauniversitar janë të peshës së një dokumenti bazik, i cili përcakton dhe rregullon rrugët e mësimdhënies, mësimnxënies, metodologjisë, vlerësimit, etj. Përmbajtjet e këtij dokumenti janë të obligueshme për zbatim për të gjitha institucionet edukative arsimore publike dhe private në Republikën e Kosovës.

Kurrikulat bërthamë përmbajnë gjithë strukturën e arsimit parafillor dhe arsimit fillor, arsimit të mesëm të ulët dhe arsimit të mesëm të lartë. Përmbajtjet përbrenda përkufizojnë në detaje veçoritë e arsimit të të gjitha niveleve të arsimit parauniversitar, kompetencat e të nxënësve, shkallët e kurrikulës, rezultatet e të nxënësve, fushat e kurrikulës, planet mësimore, mësimi me zgjedhje, udhëzimet (metodologjitë) për organizimin e procesit mësimor, vlerësimi i nxënësve dhe aspekte tjera lidhur me zbatimin. Këto dokumente, besoj se përmbushin të gjitha kërkesat e shoqërisë për secilin nivel formal i arsimit parauniversitar. Kështu krijohen mundësi të reja që të zhvillohen tek nxënësit dijet, shkathtësitë, qëndrimet dhe vlerat duke kultivuar identitetin personal, kombëtar, të përkatësisë shtetërore e kulturore, duke promovuar vlerat e përgjithshme kulturore dhe qytetare, duke zhvilluar përgjegjësitë ndaj vetes, ndaj të tjerëve, ndaj shoqërisë dhe ndaj mjedisit, si dhe duke aftësuar për jetë dhe për punë në kontekste të ndryshme shoqërore e kulturore, duke zhvilluar ndërmarrësin dhe përdorimin e teknologjisë, si proces e mësim gjatë gjithë jetës.

Me përkushtim profesional është mundur zbatueshmëria e kurrikulave bërthamë në koherencë dhe qëndrueshmëri të të gjitha niveleve formale të arsimit parauniversitar. Ky objektivi është arritur duke u mbështetur në parimin e gjithëpërfshirjes, zhvillimit të kompetencave, mësimdhënies dhe të nxënësve të integruar dhe koherent, në autonominë dhe fleksibilitetin në nivel të shkollës, në përgjegjësinë dhe llogaridhënien. Parime këto që detyrimisht do të ndikojnë në ngritjen e cilësisë së arsimit.

Të gjitha dokumentet e kurrikulave bërthamë janë të strukturuar rreth një sistemi prej gjashtë kompetencash kryesore dhe janë ndërtuar mbi shtatë fushat kurrikulare.

Dua të sigurojë të gjithë atyre që ju dedikohet dokumenti, se nivelet formale të arsimit parauniversitar të Kosovës përputhen me sistemin ndërkombëtar të klasifikimit të arsimit (SNKA) të përpiluar nga UNESCO. Andaj, shpresoj të jetë bërë një punë kruciale e me qëndrueshmëri afatgjate që kurrikulat bërthamë të jenë të aplikueshme për të gjitha nivelet formale të arsimit parauniversitar, duke filluar nga klasa parafillore dhe arsimit fillor, për arsimin e mesëm të ulët, për arsimin e mesëm të lartë (për gjimnaze dhe për shkolla profesionale). Ministria kështu po përmbushë edhe një synim nga projekti qeveritar që ky dokument të mundësojë progres në zhvillimin e kompetencave tek nxënësit, në zhvillimin e mësimdhënësve të suksesshëm, dhe prindërve që dinë të përcjellin saktë arritshmëritë e kompetencave të fëmijëve të tyre. Kurrikula Bërthamë mundëson hartimin e planeve dhe programeve me bazë në shkollë, teksteve mësimore dhe burimeve tjera si dhe shumë dokumenteve tjera që e lehtësojnë mësimdhënien dhe mësimnxënien të bazuar në kompetenca. Me këtë hap të rëndësishëm dhe reflektues të reformave sistemi arsimor i Republikës së Kosovës po kompletohet dhe po demonstron përkushtimi për finalizimin e projektit tonë për arsimin evropian e me njohje ndërkombëtare.

Sinqerisht,

Prof. Dr. Ramë Buja, Ministër

Shkurtesat

KB	Kurrikula Bërthamë
RNSH	Rezultatet e të nxënit për shkallë
FK	Fushë e Kurrikulës
ShK	Shkallë e Kurrikulës
KK	Kurrikula e Kosovës
KKK	Korniza e Kurrikulës së Kosovës
RNF	Rezultate të nxënit për fushë
MASHT	Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë
Shk	Shkathtësi
L	Lëndë
RML	Rezultate Mësimore për Lëndë
Pp	Planprogram
T	Tema
RMT	Rezultate Mësimore për Tema
GP	Grup Punues

Përmbajtja

Vendimi.....	3
Fjala e Ministrit.....	4
Shkurtesat.....	5
I. HYRJE.....	9
Rëndësia e Kurrikulës Bërthamë.....	10
Struktura e arsimit parauniversitar.....	10
Qëllimet e arsimit parauniversitar.....	11
Parimet e arsimit parauniversitar.....	12
Struktura e Kurrikulës Bërthamë.....	13
II. KURRIKULA BËRTHAMË PËR ARSIMIN E MESËM TË LARTË KLASA X-XI.....	15
1.Kurrikula Bërthamë.....	16
2. Struktura e Kurrikulës Bërthamë.....	18
3.Veçoritë e arsimit të mesëm të ;artë, klasa X, XI, XII.....	18
4.Kompetencat e të nxënit.....	18
5. Shkallët e Kurrikulës.....	20
III. FUSHAT E KURRIKULËS ARSIMIN E MESËM TË LARTË.....	35
Fushat e Kurrikulës.....	36
Fusha kurrikulare - Gjuhët dhe Komunikimi.....	37
Fusha kurrikulare - Artet.....	45
Fusha kurrikulare - Matematika.....	53
Fusha kurrikulare - Shkencat e natyrës.....	60
Fusha kurrikulare - Shoqëria dhe mjedisi.....	68
Fusha kurrikulare - Shëndeti dhe mirëqenia.....	76
Fusha kurrikulare - Jeta dhe puna.....	83
IV. PLANET DHE PROGRAMET MËSIMORE.....	91
1. Përkufizimi.....	92
2.Plani i përgjithshëm mësimor (fondi i përgjithshëm i orëve) për arsimin parauniversitar.....	92
3.Plani mësimor (PM) për arsimin e mesëm të lartë.....	93
4. Kriteret për hartimin e planit mësimor.....	98
5. Zbatimi i planit mësimor.....	99
6. Autonomia e shkollës.....	99

V. KURRIKULA ZGJEDHORE PËR NIVELIN E TRETË	103
1. Koncepti	104
2. Qëllimi	104
3. Përmbajtja dhe realizimi	104
4. Struktura e Kurrikulës zgjedhore.....	104
5. Procedura për hartimin e Kurrikulës zgjedhore.....	104
6. Procedura për zgjedhjen e lëndës me zgjedhje	105
7. Zbatimi	105
VI. METODOLOGJIA E PËRGJITHSHME - UDHËZIME	107
1.Hyrje	108
2. Përkufizimi	108
3.Ndërlidhja e rezultateve të të nxënit për shkallë me rezultatet e fushave kurrikulare/mësimore	108
4.Mësimdhënia dhe nxënia me nxënësin në qendër dhe gjithëpërfshirja	109
5.Mësimdhënia dhe nxënia e bazuar në qasjen e integruar	110
6.Mësimdhënia dhe nxënia e bazuar në kompetenca	110
7.Mësimdhënia dhe nxënia e diferencuar.....	111
8.Çështjet ndërkurrikulare	112
9.Çështjet jashtëkurrikulare	112
VII. VLERËSIMI - UDHËZIME TË PËRGJITHSHME	115
1.Hyrje	116
2.Qëllimet e vlerësimit.....	116
3.Parimet themelore të vlerësimit	116
4.Vlerësimi i brendshëm	116
5.Vlerësimi i jashtëm	119
BIBLIOGRAFIA	133
NË HARTIMIN E KURRIKULAVE BËRTHAMË MORËN PJESË:	135

Si rezultat i punës së bashku të profesorëve të universitetit të Prizrit, në vitin 2017 është krijuar

kurrikulum i ri i

arsimit të mesëm të lartë të Kosovës

që synon të përcaktojë

konceptet dhe përmbajtjet kryesive të

arsimit të mesëm të lartë të Kosovës

që duhet të mësohen dhe të kuptohen

nga studentët për të siguruar

qilësori të arsimit të mesëm të lartë të Kosovës.

Qilësoria e arsimit të mesëm të lartë të Kosovës

është:

• Të përcaktuar

• Të përcaktuar

• Të përcaktuar

• Të përcaktuar

• Të përcaktuar

• Të përcaktuar

• Të përcaktuar

• Të përcaktuar

• Të përcaktuar

• Të përcaktuar

• Të përcaktuar

• Të përcaktuar

I.

HYRJE

Rëndësia e Kurrikulës Bërthamë

Struktura e arsimit parauniversitar

Qëllimet e arsimit parauniversitar

Parimet e arsimit parauniversitar

Çështjet e përbashkëta të dokumentave të kurrikulave bërthamë

Struktura e Kurrikulës Bërthamë

Rëndësia e Kurrikulës Bërthamë

Kurrikula Bërthamë është dokument që në shkollat e Kosovës e bën të zbatueshme Kornizën e Kurrikulës së Kosovës, të miratuar nga MASHT-i në gusht të vitit 2011. Me këtë dokument përcaktohen rezultatet e kompetencave për lëmenj të ndryshëm të jetës, të shprehura nëpërmjet njohurive faktike dhe procedurale, nëpërmjet shkathtësive, qëndrime dhe vlerave që duhet të zhvillohen te nxënësit gjatë periudhave të caktuara kohore si dhe qasjet, metodologjitë e zbatueshmërisë, monitorimi dhe vlerësimi. Gjithashtu, ky dokument përcakton shpërndarjen kohore nëpër fusha të Kurrikulës dhe ndërlihdjen ndërmjet tyre, të cilat mundësojnë progres në zhvillimin e kompetencave te nxënësit.

Dokumenti i Kurrikulës Bërthamë mbështet:

- nxënësit - në zhvillimin gradual të tyre, në zhvillimin e kompetencave për arsimim tërëjetësor dhe në integrimin e lehtë shoqëror, duke i përgatitur që të ballafaqohen me sfida të jetës;
- mësimdhënësit - në planifikimin dhe realizimin e suksesshëm të punës me nxënës - aktiviteteve mësi more në klasë dhe jashtë klase, në përgjigjet pyetjeve: Përse dhe për Ç'qëllim duhet të mësojnë nxënësit; Çfarë, Kur, Sa dhe Si do të mësojnë nxënësit, si dhe Çfarë, Kur dhe Si të vlerësohen arritjet e nxënësve - realizimi dhe efektiviteti i aktiviteteve mësimore dhe
- prindërit - në ndjekjen e saktë të arritjeve të kompetencave të fëmijëve të tyre në periudha të caktuara kohore në bazë të njohurive, sjelljeve, ndjenjave dhe qëndrimeve që manifestojnë në situata të ndryshme jetësore, në harmoni me rezultatet e të nxënësit të fushave dhe shkallëve kurrikulare.

Struktura e arsimit parauniversitar

Nivelet formale të arsimit parauniversitar të Kosovës përputhen me sistemin ndërkombëtar të klasifikimit të arsimit (SNKA), përpiluar nga UNESCO, dallime ka në përbërjen e strukturës së Kurrikulës Bërthamë të SNKA 1, në kuadër të së cilës hyn klasa parafillore, që është pjesë përbërëse e edukimit parafillos. Të gjitha nivelet formale të arsimit parauniversitar janë të ndara në nën nivele formale, me emërtim - Shkallët e Kurrikulës, që kanë qëllime të caktuara dhe janë në funksion sipas emërtimeve të secilës prej tyre (Shih në tabelën e mëposhtme emërtimet e secilës shkallë të Kurrikulës dhe seksionin 2 të këtij dokumenti).

Kurrikulat bërthamë (janë të hartuara) për të gjitha nivelet formale të arsimit parauniversitar, si:

- Kurrikula Bërthamë për zhvillimin e fëmijërisë së hershme (lindje - 5 vjeç);
- Kurrikula Bërthamë për klasën parafillore dhe arsimin fillor;
- Kurrikula Bërthamë për arsimin e mesëm të ulët;
- Kurrikula bërthamë për arsimin e mesëm të lartë (Kurrikula Bërthamë për gjimnaze dhe Kurrikula Bërthamë për shkolla profesionale).

Sistemi	Nivelet formale të arsimit parauniversitar në Kosovë	Shkallët e Kurrikulës		Kurrikulat bërthamë
SNKA3	Arsimi i mesëm i lartë (klasat X-XII)	Klasa XII	Shkalla e Kurrikulës 6: Konsolidim dhe specializim	Kurrikula Bërthamë për klasat X-XII të arsimit të mesëm të lartë
		Klasat X-XI	Shkalla e Kurrikulës 5: Zhvillim i përgjithshëm themelor dhe profesional	
SNKA 2	Arsimi i mesëm i ulët (klasat VI-IX)	Klasat VIII-IX	Shkalla e Kurrikulës 4: Përforsim dhe orientim	Kurrikula Bërthamë për klasat VI-IX të arsimit të mesëm të ulët
		Klasat VI-VII	Shkalla e Kurrikulës 3: Zhvillim i mëtejshëm dhe orientim	
SNKA 1	Arsimi fillor (Klasat I-V)	Arsimi fillor	Shkalla e Kurrikulës 2: Përforsim dhe zhvillim	Kurrikula Bërthamë për klasën parafillore dhe klasat I-V të arsimit fillor
		Klasat III-V		
Arsimi fillor	Shkalla e Kurrikulës 1: Përvetësim themelor			
Klasat I-II				
SNKA 0	Arsimi (Edukimi) parashkollor	Klasa parafillore	Shkalla përgatitore e Kurrikulës: Edukimi në fëmijërinë e hershme	Kurrikula Bërthamë e edukimit parashkollor
		Mosha 0-5		

Secila kurrikulë bërthamë është në linjë me qëllimet e përgjithshme të arsimit parauniversitar dhe zbatohet duke respektuar parimet e themelore që dalin nga Korniza e Kurrikulës së Kosovës.

Qëllimet e arsimit parauniversitar

Secili nivel formal i arsimit parauniversitar te nxënësit duhet të zhvillojë dijet, shkathtësitë, qëndrimet dhe vlerat, në harmoni me kërkesat e shoqërisë demokratike, duke:

- kultivuar identitetin personal, kombëtar, të përkatësisë shtetërore e kulturore,
- promovuar vlerat e përgjithshme kulturore dhe qytetare,
- zhvilluar përgjegjësitë ndaj vetes, ndaj tjerëve, ndaj shoqërisë dhe ndaj mjedisit,
- i aftësuar për jetë dhe për punë në kontekste të ndryshme shoqërore e kulturore,
- zhvilluar ndërmarrësinë dhe përdorimin e teknologjisë,
- i aftësuar për mësim gjatë gjithë jetës.

Parimet e arsimit parauniversitar

Zbatueshmëria e Kurrikulës Bërthamë siguron koherencë dhe qëndrueshmëri të të gjitha niveleve formale të arsimit parauniversitar duke u mbështetur në këto parime:

Gjithëpërfshirjen e fëmijëve dhe të rinjve në mënyrë të barabartë në arsim cilësor;

Zhvillimin e kompetencave, që reflektohen në rezultatet e të nxënësve, që priten të arrihen në mënyrë progresive dhe të vazhdueshme nga të gjithë nxënësit në periudha të ndryshme të shkollimit;

Mësimdhënien dhe të nxënësve të integruar dhe koherent, që promovon të nxënësve të plotë, duke reflektuar ndër-lidhjet dhe ndërvarësitë e natyrës dhe të botës së krijuar nga njeriu me dijen dhe informacionin që kanë nxënësit për to;

Autonominë dhe fleksibilitetin në nivel shkolle në zbatimin e Kurrikulës Bërthamë dhe pjesës zgjedhore që reflektohen në hartimin vjetor të planit mësimor dhe në metodologjinë e mësimdhënies dhe të të nxënësve;

Përgjegjësinë dhe llogaridhënien, që reflektohen në krijimin e kulturës për vlerësim të vazhdueshëm - ndjekje të progresit në zbatimin e kërkesave të Kurrikulës përmes mbledhjes dhe analizës së të dhënave, dokumentimit të sfidave dhe zgjidhjeve, drejt një paraqitjeje me të mirë në përmbushjen e kërkesave të Kurrikulës dhe ngritjes së cilësisë së arsimit.

Çështjet e përbashkëta të dokumenteve të kurrikulave bërthamë

Të gjitha dokumentet e kurrikulave bërthamë janë të strukturuar rreth një sistemi prej gjashtë kompetencash kryesore, në përputhje me qëllimet e arsimit parauniversitar dhe shtatë fushat kurrikulare. Gjashtë kompetencat, të pranishme në të gjitha kurrikulat bërthamë, janë:

- Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit;
- Kompetenca e të menduarit;
- Kompetenca e të mësuarit;
- Kompetenca për jetë, për punë dhe për mjedis;
- Kompetenca personale;
- Kompetenca qytetare.

Ndërkaq, shtatë fushat kurrikulare të pranishme në të gjitha kurrikulat bërthamë janë:

1. Gjuhët dhe komunikimi;
2. Artet;
3. Matematika;
4. Shkencat e natyrës;
5. Shoqëria dhe mjedisi;
6. Shëndeti dhe mirëqenia;
7. Jeta dhe puna.

Rezultatet e të nxënësve për çdo shkallë dhe rezultatet e të nxënësve për çdo fushë i bëjnë të dallueshme kompetencat dhe fushat kurrikulare nga secili nivel formal i arsimit dhe secila shkallë kurrikulare (shih seksionet II dhe III të këtij dokumenti).

Struktura e Kurrikulës Bërthamë

Kurrikula Bërthamë në vete përmban këtë strukturë:

- Fushëveprimin, strukturën dhe përshkrimin e përgjithshëm të nivelit formal të sistemit arsimor përkatës
- Fushëveprimin e shkallëve kryesore të Kurrikulës për nivelin formal përkatës
- Rezultatet e të nxënit për shkallë kryesore të Kurrikulës, që shprehin nivelin e domosdoshëm të arritjes së kompetencave kryesore me rastin e përfundimit të çdo shkalle të Kurrikulës
- Si do të përdoren rezultatet e të nxënit për shkallë kryesore të kurrikulës në procesin mësimor dhe të vlerësimit
 - Kërkesat e progresit gjatë niveleve formale të arsimit, duke përfshirë kërkesat minimale të kalimit prej një shkalle kryesore të Kurrikulës në një shkallë tjetër
 - Kriteret dhe format e vlerësimit
- Fushat e Kurrikulës dhe fushëveprimi i tyre nëpër shkallë kryesore të Kurrikulës
- Rezultatet e të nxënit për fusha të Kurrikulës për secilën shkallë të Kurrikulës
- Si përdoren rezultatet e të nxënit për fusha në procesin mësimor dhe të vlerësimit
 - Kërkesat e progresit në fushat e Kurrikulës, duke përfshirë kërkesat minimale për kalimin prej një shkalle kryesore të Kurrikulës
 - Kriteret dhe format e vlerësimit
- Planin dhe programin mësimor
- Lëndët në kuadër të fushave të Kurrikulës dhe fushëveprimin e tyre
- Udhëzimet (metodologjitë) për organizimin e procesit mësimor
- Vlerësimin e nxënësve
- Aspekte lidhur me zbatimin.

STRUKTURA E KURRIKULës BËRTHAMË PËR ARSIMIN E MËSËM TË LARTË TË KOSOVËS

Struktura e kurrikulës bërthamë përbëhet nga disa komponente kryesore që përcaktojnë përmbajtjen dhe organizimin e arsimit të lartë në Kosovë. Këto komponente janë:

- 1. **Programi i studimit:** Dokumenti që përcakton përmbajtjen, strukturën dhe objektivat e arsimit të lartë në një fushë të caktuar.
- 2. **Planifikimi i kursit:** Dokumenti që përcakton strukturën, përmbajtjen dhe objektivat e arsimit të lartë në një kurs të caktuar.
- 3. **Planifikimi i mësimi:** Dokumenti që përcakton strukturën, përmbajtjen dhe objektivat e arsimit të lartë në një mësim të caktuar.
- 4. **Planifikimi i vlerësimit:** Dokumenti që përcakton strukturën, përmbajtjen dhe objektivat e arsimit të lartë në një vlerësim të caktuar.

Kurrikula bërthamë përbëhet nga disa komponente kryesore që përcaktojnë përmbajtjen dhe organizimin e arsimit të lartë në Kosovë. Këto komponente janë:

- 1. **Programi i studimit:** Dokumenti që përcakton përmbajtjen, strukturën dhe objektivat e arsimit të lartë në një fushë të caktuar.
- 2. **Planifikimi i kursit:** Dokumenti që përcakton strukturën, përmbajtjen dhe objektivat e arsimit të lartë në një kurs të caktuar.
- 3. **Planifikimi i mësimi:** Dokumenti që përcakton strukturën, përmbajtjen dhe objektivat e arsimit të lartë në një mësim të caktuar.
- 4. **Planifikimi i vlerësimit:** Dokumenti që përcakton strukturën, përmbajtjen dhe objektivat e arsimit të lartë në një vlerësim të caktuar.



Struktura e kurrikulës bërthamë përbëhet nga disa komponente kryesore që përcaktojnë përmbajtjen dhe organizimin e arsimit të lartë në Kosovë. Këto komponente janë:

- 1. **Programi i studimit:** Dokumenti që përcakton përmbajtjen, strukturën dhe objektivat e arsimit të lartë në një fushë të caktuar.
- 2. **Planifikimi i kursit:** Dokumenti që përcakton strukturën, përmbajtjen dhe objektivat e arsimit të lartë në një kurs të caktuar.
- 3. **Planifikimi i mësimi:** Dokumenti që përcakton strukturën, përmbajtjen dhe objektivat e arsimit të lartë në një mësim të caktuar.
- 4. **Planifikimi i vlerësimit:** Dokumenti që përcakton strukturën, përmbajtjen dhe objektivat e arsimit të lartë në një vlerësim të caktuar.

STRUKTURA E KURRIKULës BËRTHAMË PËR ARSIMIN E MËSËM TË LARTË TË KOSOVËS

Struktura e kurrikulës bërthamë përbëhet nga disa komponente kryesore që përcaktojnë përmbajtjen dhe organizimin e arsimit të lartë në Kosovë. Këto komponente janë:

- 1. **Programi i studimit:** Dokumenti që përcakton përmbajtjen, strukturën dhe objektivat e arsimit të lartë në një fushë të caktuar.
- 2. **Planifikimi i kursit:** Dokumenti që përcakton strukturën, përmbajtjen dhe objektivat e arsimit të lartë në një kurs të caktuar.
- 3. **Planifikimi i mësimi:** Dokumenti që përcakton strukturën, përmbajtjen dhe objektivat e arsimit të lartë në një mësim të caktuar.
- 4. **Planifikimi i vlerësimit:** Dokumenti që përcakton strukturën, përmbajtjen dhe objektivat e arsimit të lartë në një vlerësim të caktuar.

II.

KURRIKULA BËRTHAMË PËR ARSIMIN E MESËM TË LARTË (klasa X - XI)

Kurrikula Bërthamë

Struktura e Kurrikulës

Veçoritë e arsimit të mesëm të lartë, klasa X - XII

Kompetencat e të nxënit

Shkallët e Kurrikulës

Rezultatet e të nxënit për shkallë

1. Kurrikula Bërthamë

Kurrikula Bërthamë për arsimin e mesëm të lartë (gjimnazet dhe shkollat profesionale), është dokument bazë, i cili rregullon ecurinë e mësimdhënies, të mësimnxënies, të metodologjisë, të vlerësimit etj. në nivelin e tretë të arsimit të Kosovës. Ky dokument, dispozitat e të cilës vendosen nga MASHT-i, është obligues për të gjitha institucionet edukative arsimore në Republikën e Kosovës. Kurrikula Bërthamë është hartuar duke u bazuar në Kornizën e Kurrikulës së Kosovës.

Ky dokument u shërben mësimdhënësve, nxënësve, prindërve, drejtorëve të shkollave dhe komunitetit në përgjithësi.

Në Kornizën e Kurrikulës së Kosovës, shkolla e mesme e lartë është ndarë dhe është profilizuar në dy degë, si më poshtë:

Gjimnazi i përgjithshëm: Profilizimi i gjimnazeve

Në nivelin e arsimit të mesëm të lartë, do të ketë tri lloje të gjimnazeve

1. Gjimnazi i shkencave shoqërore dhe gjuhësore
2. Gjimnazi i shkencave natyrore
3. Gjimnazi i specializuar (artistik, matematikor, gjuhësor, teknik etj.)

Shkollat profesionale

1. Shkollat bujqësore
2. Shkollat teknike (elektroteknikë, makineri, ndërtimtari, grafikë, komunikacion)
3. Shkollat mjekësore
4. Shkolla ekonomi dhe administratë
5. Kimi teknologji
6. Shkolla artistike

Kompetencat reflektohen nëpërmjet rezultateve të të nxënësve, të cilat janë të përgjithshme e të cilat shprehin atë se çfarë duhet të arrijnë nxënësit në mënyrë progresive dhe të vazhdueshme deri në fund të arsimit të deturueshëm. Kompetencat përfshijnë një sistem të integruar dhe koherent të dijeve, të shkathtësive dhe të qëndrimeve të aplikuueshme dhe të transferueshme, të cilat do t'u ndihmojnë nxënësve të ballafaqohen me sfida të epokës digjitale, të ekonomisë së tregut të lirë dhe të bazuar në dije, në një botë të marrëdhënieve të ndërvarura. Kompetencat e parapara me Kornizën e Kurrikulës rrjedhin nga qëllimet e përgjithshme të arsimit parauniversitar dhe përcaktojnë rezultatet kryesore të të nxënësve, të cilat duhet t'i arrijnë nxënësit në mënyrë progresive dhe të qëndrueshme gjatë sistemit të arsimit parauniversitar. Kompetencat kryesore të parapara për sistemin e arsimit parauniversitar në Republikën e Kosovës janë:

1. Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit
2. Kompetenca e të menduarit
3. Kompetenca e të mësuarit
4. Kompetenca për jetë, për punë dhe për mjedis
5. Kompetenca personale
6. Kompetenca qytetare

Shkollat e përgjithshme (Gjimnazet)

Në Shkallën kurrikulare 5 dhe Shkallën kurrikulare 6, fushat kurrikulare:

Shkencat natyrore zhvillohen në lëndë të veçanta (fizikë, kimi, biologji dhe astronomi vetëm në ShK6). Në këtë nivel, në raste të veçanta, lënda e gjeografisë do të mësohet si shkencë natyrore.

Shoqëria dhe mjedisi në shkollat e përgjithshme (gjimnaze), realizohet nëpërmjet lëndëve të veçanta: histori, gjeografi, edukatë qytetare, sociologji, psikologji, logjikë dhe filozofi, duke vënë theksin në zhvillimin e kompetencave përkatëse kryesore në mënyrë të baraspeshuar.

Përvojat mësimore, që kjo fushë ofron në ShK5 dhe ShK6, për nxënësit e shkollave profesionale, përsëri merren nëpërmjet lëndëve shoqërore të integruara, përfshirë aspekte të edukatës qytetare, historisë dhe gjeografisë, të mbështetura në qasje tematike.

Nëpërmjet këtij lëmi të Kurrikulës, nxënësit do të njihen me vlerat dhe me normat e jetës shoqërore në një shoqëri demokratike. Ata dukurive shoqërore gjithashtu do t'u qasen nga pikëpamja historike, sociologjike, ekonomike, psikologjike dhe ndërkulturore.

Shkollat profesionale do të përfitojnë nga pjesa zgjedhore e orëve, duke ia dedikuar fondin prej 10% të orëve arsimit profesional. Ky fond, së bashku me 50% të fushës Jeta dhe puna, do të përbëjnë 60% të kohës së mësimi të profesionit. Ndërkaq, përqindja e kohë së mbetur është dedikuar për fushat e tjera kurrikulare të cilat do të jenë të zbatuara në profesion.

Në shkollat profesionale mësimi përmes fushave kurrikulare, Shkencat natyrore dhe Shoqëria dhe mjedisit, bëhet nëpërmjet lëndëve të integruara, në funksion të zbatimit në profesione të caktuara.

Kompetencat e komunikimit dhe e të shprehurit, kompetencat e të menduarit dhe kompetencat për të mësuar janë të natyrës instrumentale: ato janë bazë për kompetencat e tjera, që më tepër janë të lidhura me rrethanat dhe me përmbajtjen e caktuar, siç janë kompetencat e nevojshme në jetën private, publike dhe profesionale.

Fushat e Kurrikulës	Lëndët mësimore përgjatë shkallëve të Kurrikulës Niveli III (Klasa X - XII)			
	ShK5		ShK6	
	Klasat X dhe XI (Arsimi i përgjithshëm)	Klasa X dhe XII (Arsimi dhe aftësimi profesional AAP)	Klasa XII (Arsimi i përgjithshëm)	Klasa XII (Arsimi dhe aftësimi profesional - AAP)
Gjuhët dhe komunikimi	Gjuhë amtare Gjuhë angleze Gjuha e dytë Gjuhë të tjera	Gjuhë amtare Gjuhë angleze Gjuhë të tjera	Gjuhë amtare Gjuhë angleze Gjuha e dytë Gjuhë të tjera	Gjuhë amtare Gjuhë angleze Gjuhë të tjera
Artet	Edukatë figurative Edukatë muzikore	Arte aplikative	Edukatë figurative Edukatë muzikore	Arte aplikative
Matematika	Matematikë	Matematikë	Matematikë	Matematikë
Shkencat natyrore	Biologji Fizikë Kimi	Shkencat natyrore	Biologji Fizikë Kimi Astronomi	Shkencat natyrore
Shoqëria dhe mjedisi	Histori Gjeografi Edukatë qytetare Sociologji Psikologji Filozofi	Shoqëria dhe mjedisi	Histori Gjeografi Sociologji Psikologji Filozofi	Shoqëria dhe mjedisi
Shëndeti dhe mirëqenia	Shëndeti dhe mirëqenia Edukata fizike	Shëndeti dhe mirëqenia Edukata fizike	Shëndeti dhe mirëqenia Edukata fizike	Shëndeti dhe mirëqenia Edukata fizike
Jeta dhe puna	Jeta dhe puna	Jeta dhe puna	Jeta dhe puna	Jeta dhe puna

2.Struktura e Kurrikulës Bërthamë

Në Kurrikulën Bërthamë për gjimnazet, përshkruhen në hollësi:

- lloji i gjimnazit;
- kompetencat e të nxënit për këtë nivel;
- shkallët e Kurrikulës;
- rezultatet e të nxënit sipas shkallëve;
- fushat e kurrikulës.

3.Veçoritë e arsimit të mesëm të lartë, klasa X,XI,XII

Arsimi i mesëm i lartë bazohet në një proces më të gjerë, më të thellë dhe më të specializuar të të nxënit, duke pasur parasysh:

- orientimin e ardhshëm të nxënësve:
 - drejt studimeve akademike,
 - drejt kualifikimeve profesionale (përfshirë arsimin postsekondar jouniversitar) dhe/apo inkadrimin në tregun e punës si punëtorë të kualifikuar dhe
 - nevojën për t'i pajisur ata me shkathtësi për të nxënë gjatë gjithë jetës.

Në këtë nivel, si në shkollat e përgjithshme (gjimnazet), ashtu edhe në shkolla profesionale, procesi i përvetësimit të dijeve dhe zhvillimit të shkathtësive, vlerave dhe qëndrimeve bazohet në nevojën e të rinjve për të marrë përgjegjësinë për jetën e tyre, për të marrë pjesë si qytetarë aktivë dhe kompetentë në zhvillimet shoqërore dhe për t'u inkadruar me sukses në tregun e punës. Prandaj, nxënësit i nënshtrohen një procesi më sfidues të përvetësimit të dijeve, zhvillimit të potencialit të tyre intelektual, emocional dhe fizik

4.Kompetencat e të nxënit

Kompetencat reflektohen nëpërmjet rezultateve të të nxënit, që janë të përgjithshme e të cilat shprehin atë se çfarë duhet të arrijnë nxënësit në mënyrë progresive dhe të vazhdueshme deri në fund të arsimit të detyrueshëm. Kompetencat përfshijnë një sistem të integruar dhe koherent të dijeve, të shkathtësive dhe të qëndrimeve të aplikueshme e të transferueshme, të cilat do t'u ndihmojnë nxënësve të ballafaqohen me sfidat e epokës digjitale të ekonomisë së tregut të lirë dhe të bazuar në dije, në një botë të marrëdhënieve të ndërvarura. Kompetencat e parapara me Kornizën e Kurrikulës rrjedhin nga qëllimet e përgjithshme të arsimit parauniversitar dhe përcaktojnë rezultatet kryesore të të nxënit, të cilat duhet t'i arrijnë nxënësit në mënyrë progresive dhe të qëndrueshme gjatë sistemit të arsimit parauniversitar. Kompetencat kryesore të parapara për sistemin e arsimit parauniversitar në Republikën e Kosovës janë:

- 1.Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit
- 2.Kompetenca e të menduarit
- 3.Kompetenca e të mësuarit
- 4.Kompetenca për jetë, për punë dhe për mjedis
- 5.Kompetenca personale
- 6.Kompetenca qytetare

Kompetencat e komunikimit dhe të shprehurit, kompetencat e të menduarit dhe kompetencat për të mësuar janë të natyrës instrumentale: ato paraqesin bazën për kompetencat e tjera, që më tepër lidhen me rrethanat dhe me përmbajtjen e caktuar, siç janë kompetencat e nevojshme në jetën private, publike dhe profesionale.

Kompetencat e komunikimit dhe të të shprehurit ("Komunikues efektiv")

Me qëllim që nxënësit dhe të rinjtë të zhvillohen si personalitete, të mësojnë dhe të marrin pjesë aktive në shoqëri, është me rëndësi që t'i kuptojnë porositë që u drejtohen dhe të shprehen në mënyrë adekuate nëpërmjet gjuhëve, simboleve, shenjave, kodeve dhe formave artistike. Për të komunikuar në mënyrë efektive, nxënësit përkrahen që të shfrytëzojnë në mënyrë të pavarur, kritike dhe kreative mjetet dhe mundësitë e komunikimit dhe të të shprehurit.

Kompetencat e të menduarit ("Mendimtar kreativ")

Qasja dhe përpunimi i njohurisë në mënyrë të pavarur, efektive dhe me përgjegjësi është shumë e rëndësishme për të nxënë, por edhe për të marrë vendime dhe për të zgjidhur probleme me vetëdije të plotë për ndikimin dhe pasojat e vendimit dhe të veprimit të caktuar. Duke mbajtur parasysh kompleksitetin e shoqërisë dhe të ekonomisë së sotme, të bazuar në dije, menaxhimi i dijes është bërë kompetencë esenciale për shekullin XXI. Megjithatë, përveç aftësisë për të identifikuar dhe për t'iu qasur informatës/burimit të njohurisë së caktuar, nxënësit kanë nevojë të zhvillojnë edhe kapacitete për t'iu qasur njohurive në mënyrë kritike, kreative dhe ndërvepruese.

Kompetencat e të mësuarit tërëjetësor ("Nxënës i suksesshëm")

Në trendët aktualë të zhvillimit në shoqëri, në shkencë, në teknologji e në ekonomi nuk mund të pretendohet që të gjitha njohuritë, shkathhtësitë e aftësitë e nevojshme të arrihen nëpërmjet shkollimit. Prandaj, nga shkolla pritet që të japë një bazë të mirë të arsimimit dhe të përgatisë nxënësit për një proces të mësimi tërëjetësor. Për një "nxënës të suksesshëm", shkolla angazhohet të kultivojë vazhdimisht kërkshërinë e natyrshme të fëmijëve/të të rinjve dhe interesimin për të nxënë si dhe të zhvillojë kompetencat për të mësuar. Shkolla po ashtu duhet të vetëdijesohet për stilet dhe strategjitë efektive mësimore.

Kompetencat për jetë, për punë dhe për mjedis ("Kontribuues produktiv")

Shkollat duhet të përgatisin nxënësit për të jetuar dhe për të punuar në një botë shumë të ndërvarur dhe për t'iu ballafaquar me ekonominë konkurruese globale. Jeta dhe puna në shekullin XXI kërkon kompetenca për të përballur rrethana dhe sfida të paparashikuara, si dhe kapacitet për të shfrytëzuar mundësitë që ofrohen për përparim personal dhe përparim të shoqërisë e mjedisit.

Për të zhvilluar këto kompetenca, shkolla përkrah nxënësit që në mënyrë të plotë të kuptojnë ndërvarësinë e fenomeneve ekonomike, politike dhe kulturore të shoqërisë lokale dhe globale. Ajo të nxënësit kultivon orientimin drejt së ardhmes, ndërmarrësinë dhe motivimin e qëndrueshëm për të përmbushur objektivat. Njëkohësisht, shkolla angazhohet që t'i ballafaqojë nxënësit me preokupime ekologjike, duke i vetëdijesuar për rolin e secilit në mbrojtjen, përgjegjshmërinë dhe përmirësimin e mjedisit.

Kompetencat personale ("Individ i shëndetshëm")

Shkollat përgatisin nxënës, që në mënyrë efektive dhe konstruktive të inkuadrohen në jetën familjare, shoqërore dhe të punës. Në këtë kontekst, nxënësit përkrahen që të vetëdijesohen për veten dhe të kenë vetëbesim, por njëkohësisht të jenë të hapur dhe të kenë besim te të tjerët.

Kompetencat qytetare ("Qytetar i përgjegjshëm")

Të mësuarit për të jetuar së bashku trajtohet si sfida kryesore e botës së sotme dhe së nesërme. Kjo kompetencë siguron që nxënësit të jenë në gjendje të veprojnë si qytetarë të përgjegjshëm, duke marrë parasysh kontekstin e ngushtë dhe të gjerë.

5. Shkallët e Kurrikulës

Korniza e Kurrikulës e Arsimit Parauniversitar e Republikës së Kosovës përkufizon konceptin e shkallëve të Kurrikulës në saje të numrit të veçorive të përbashkëta që kanë të bëjnë me zhvillimin sociopsikologjik të nxënësve.

Shkallët e Kurrikulës kanë të përbashkëta:

- Kompetencat që duhet të arrihen
- Kërkesat për progres
- Mekanizmin për organizimin e procesit mësimor
- Kriteret e vlerësimit

5.1. Shkallët e Kurrikulës për arsimin e mesëm të lartë

Korniza e Kurrikulës është e strukturuar sipas shkallëve të Kurrikulës, të cilat paraqesin periudha të përbashkëta karakteristika për sa i përket zhvillimit të fëmijëve dhe kërkesave të Kurrikulës. Ato paraqesin pikën referuese për përcaktimin e kompetencave kryesore që duhen zotëruar, kërkesat e progresit të nxënies, organizimin e përvojave mësimore, qasjen dhe kriteret e vlerësimit si dhe institucionin përgjegjës për arritjen e tyre. Kurrikula Bërthamë për nivelin e tretë ka dy shkallë: shkallën e pestë (klasa X dhe klasa XI), shkallën e gjashtë (klasa XII).

Shkalla e Kurrikulës 5 - Arsim i përgjithshëm dhe arsim profesional

Përfshin klasat X dhe XI. Kjo shkallë synon t'i ballafaqojë nxënësit me studime më të thella dhe më të specializuara të nxënies, në kuptim të përgatitjes akademike për arsim të lartë dhe/apo për të hyrë në tregun e punës. Nxënësit ballafaqohen me sfida që u mundësojnë:

- zhvillimin e vetëbesimit;
- studimin më të thellë dhe më të specializuar, duke angazhuar aftësitë për shfrytëzim të burimeve të ndryshme, me një qasje kritike të të dhënave të ndryshme në dispozicion;
- zhvillimin e dëshirës për përkushtim dhe qëndrueshmëri për arritje më të larta, në kuptim të mësimin dhe përgatitjes për karrierë si dhe për jetë personale, profesionale dhe publike;
- përgatitjen për të marrë përgjegjësinë për jetën e tyre, për të marrë pjesë aktive në jetën shoqërore si qytetarë të përgjegjshëm dhe kompetentë dhe për të garuar me sukses në tregun e punës.
- zhvillimin si individë dhe si anëtarë të shoqërisë, të aftë dhe me kapacitete të nevojshme për jetë dhe për punë që të përballin ndryshimet e ekonomisë lokale dhe globale dhe që të mësojnë se si të bëjnë zgjidhjen e problemeve në situata të ndryshme në jetën personale dhe profesionale;
- përgatitjen për jetë, që të jetojnë të pavarur dhe të punojnë në përballimin e sfidave dhe shfrytëzimin e mundësive që ofron shoqëria bashkëkohore dhe të marrin veprime e vendime të përgjegjshme për situata, duke qenë të informuar mirë gjatë gjithë jetës së tyre.

Shkalla e Kurrikulës 6 – Konsolidim dhe specializim

Kjo shkallë përfshin klasën XII. Kjo është fazë e kalimit nga adoleshenca në fazë të pjekurisë, gjatë së cilës nxënësit duhet të konsolidojnë përvojën e përgjithshme të shkollimit të detyrueshëm dhe të përgatiten për kërkesat e një faze të re të jetës dhe arsimimit të lartë. Nxënësit nëpërmjet programeve të shkollave të mesme do të përgatiten për t'u inkuadruar në tregun e punës si punëtorë të shkathët. Nxënësit do t'u ekspozohen sfidave për:

- demonstrimin e aftësive për identifikimin e burimeve të domosdoshme dhe për qasjen kritike të dhënave të ndryshme;
- demonstrimin e aftësisë për vendimmarrje të pavarur dhe për marrje të përgjegjësisë për zgjedhjet dhe veprimet personale;
- demonstrimin e përkushtimit të tyre për angazhim të vazhdueshëm për të nxënë, për studim të më tutjeshëm dhe/apo për zhvillim profesional;
- demonstrimin e shkathtësisë për të zhvilluar dhe për të promovuar strategji për planifikimin e karrierës nëpërmjet kërkimit të shembujve dhe inovacioneve, të cilat ndihmojnë në zhvillimin e idesë së ndërmarrësisë;

- demonstrimin e shkathtësive për ndryshimin e konceptit të karrierës, nëpërmjet kërkimit të një spektri më të gjerë të punëve, duke pasur parasysh rëndësinë e zhvillimit të shkathtësive të transferueshme për mundësitë e karrierës në të ardhmen;
- angazhimin në procesin e planifikimit të karrierës personale nëpërmjet hulumtimit lidhur me mundësitë e kualifikimit postsekondar, duke mbajtur parasysh se qëndrimet dhe nevojat për punë dhe vendim marrje do të ndryshojnë në mënyrë të vazhdueshme.

Tabela për strukturën e nivelit të tretë:

Sistemi Ndërkombëtar i Klasifikimit të Arsimit	Nivelet e sistemit formal të arsimit	Shkallët e Kurrikulës	Klasat	Mosha
SNKA 3	Arsimi i mesëm i lartë (klasat X-XII)	Shkalla e Kurrikulës 6: Konsolidim dhe specializim	XII	17
		Shkalla e Kurrikulës 5: Zhvillim themelor i përgjithshëm dhe profesional	XI	16
			X	15

Deri në fund të shkallës së tretë (klasat X, XI dhe XII) pritet që nxënësit të kenë zotëruar kompetencat e bazuara në Rezultatet e të nxënësve (RN) për shkallët dhe nivelin.

6. Rezultatet e të nxënësve për shkallë (RNSH)

Rezultatet e të nxënësve për shkallë përshkruajnë atë se çfarë duhet të dijë, të besoj, të vlerësojë dhe të jetë i aftë nxënësi për të bërë në fund të një shkalle të Kurrikulës. Rezultatet përfshijnë një varg domenesh, si: njohuritë, të kuptuarit, shkathtësitë, qëndrimet dhe vlerat. Rezultatet e të nxënësve parashihen të pasqyrojnë përvetësimet nga të gjithë nxënësit me rastin e përfundimit të një shkalle të Kurrikulës, por ato nuk mbulojnë gjithçka që nxënësit kanë mësuar apo është dashur të mësojnë gjatë një shkalle të caktuar. Ato shprehin kërkesat esenciale të arritshmërisë së kompetencave kryesore me rastin e përfundimit të një shkalle të caktuar të Kurrikulës. Rezultatet e të nxënësve për shkallë promovojnë integritet të mëtejshëm të fushave të Kurrikulës në funksion të zhvillimit të kompetencave kryesore të përcaktuara me kornizën e Kurrikulës. Ato shprehin pritjet e mësimdhënësve, të autoriteteve arsimore, të prindërve dhe të shoqërisë në raport me arritjet konkrete, të matshme, të nxënësve në fund të çdo shkalle të Kurrikulës. Rezultatet e të nxënësve paraqesin kushtin për kalim nga një shkallë në tjetrën.

Deri në fund të Shkallës së 5-të të Kurrikulës (klasa X dhe XI), pritet që nxënësit të kenë zotëruar kompetencat e shprehura në RNSH dhe nivelet korresponduese të arritshmërisë, si në vijim:

Nr.	Rezultatet e të Nxënit për Shkallën 5 dhe Kompetencat Kryesore	Niveli i ARRITJES së nxënësit					Llojet e përkrahjes për nxënësit			
		1	2	3	4	5	Përkrahje përmirësuese	Mënyrat	Përkrahje për të talentuarit	Mënyrat
I	Kompetenca e komunikimit dhe të të shprehurit – Komunikues efektiv									
1.	Shprehet përmes një forme të komunikimit, për një temë të caktuar në një material (prezantim) prej 200 fjalësh dhe veçon çështjet kryesore të ngritura në material (prezantim).									
2.	Lexon rrjedhshëm një tekst në gjuhën amtare, të përbërë prej 3-5 paragrafëve, u përgjigjet pyetjeve të shtruara për llojin e tekstit, stilet e të shkruarit, tregon qëllimin dhe lidhjen ndërmjet përmbajtjes së paragrafëve.									
3.	Diskuton në grup në mënyrë konstruktive, një diskutim në gjuhë amtare, apo në gjuhë angleze, në kohëzgjatje jo më shumë se 10 minuta, duke dhënë dhe duke marrë informata kthyesë për një temë të caktuar nga ndonjë fushë mësimore ose nga jeta e përditshme.									
4.	Përdor drejt strukturën dhe rregullat standarde të drejtshkrimit të gjuhës amtare në kontekste dhe forma të ndryshme të shkrimit, si: ese, e-mail (postë elektronike), letër formale dhe joformale etj.									
5.	Lexon rrjedhshëm një tekst të njohur në gjuhë të huaj ose në një gjuhë joamtare të përbërë prej disa paragrafëve, tregon me shembuj konkretë disa nga ngjashmëritë ndërmjet strukturës së fjalisë së asaj gjuhe me gjuhën amtare.									
6.	Shkruan një tekst në gjuhën amtare, angleze ose në një gjuhë tjetër të huaj për një temë nga jeta e përditshme, me tre-pesë paragrafë, me strukturë të drejtshkrimit dhe të elementeve të tjera, pastaj e prezanton para të tjerëve me shqiptim të drejtë.									
7.	Shkruan një ese, jo më shumë se dy faqe, për vlerat estetike të pjesëve të caktuara artistike (poezi, prozë, pjesë muzikore, pjesë arti, vallëzim etj.), duke respektuar organizimin dhe hapat e shkrimit të një eseje.									
8.	Prezanton një projekt artistik, humanitar, eksperimentues etj.) nga fusha të ndryshme mësimore, të hartuar individualisht dhe në grup për një temë të caktuar, duke përdorur në mënyrë efektive teknologjinë informative dhe teknologji të tjera.									
9.	Përdorë TIK-un në mënyrë efektive gjatë komunikimit dhe ndërveprimit me të tjerët në jetën e përditshme, duke përfshirë edhe të nxënit e informatave të reja dhe kryerjen e detyrave shkollore.									

II Kompetenca e të menduarit – Mendimtar kreativ

1.	Në forma të ndryshme të të shprehurit prezanton mënyrën e grumbullimit, të zgjedhjes dhe të klasifikimit të informatave për fusha të ndryshme mësimore apo për një temë të caktuar, ofron argumente për zhvillimet aktuale lidhur me temën përkatëse (p.sh., temë nga shkencë, nga kultura, nga arti, nga sporti, nga shëndetësia, nga shoqëria, nga mjedisi etj.).								
2.	Krahason të paktën tri burime të ndryshme të informimit për trajtimin e temës së njëjtë, argumenton saktësinë, rrethanat, gjen ngjashmëritë dhe dallimet, duke u bazuar në kriteret e përcaktuara më parë, i prezanton gjetjet kryesore para të tjerëve në forma të ndryshme shprehëse, duke përdorur teknologjinë informative.								
3.	Harton një detyrë me tekst, apo krijon një situatë logjike nga jeta e përditshme, e cila përmban një mesazh që kërkon zgjidhje matematike apo një problem shkencor, duke u bazuar në njohuritë paraprake, prezanton mënyrën/procedurën e zgjidhjes së problemit para të tjerëve.								
4.	Modelon zgjidhjen e një problemi të dhënë (në klasë, apo jashtë saj) për një temë të caktuar nga një fushë mësimore, duke e zbërthyer në hapa të vegjël dhe jep sqarime të nevojshme për hapat e ndjekur në zgjidhjen e problemit duke përdorur forma të ndryshme të të shprehurit.								
5.	Llogarit me saktësi koston e buxhetit të planifikuar për një aktivitet të caktuar (p.sh., ekskursioni, kremtimi i ditës së shkollës, një konkurs i diturisë, një program arsimor për TV etj.), e prezanton atë me gojë dhe me shkrim para klasës, duke përdorur arsyetimin matematikor.								
6.	Gjykon vërtetësinë e një rezultati të dhënë (p.sh. rezultatin e një detyre nga matematika, shkencat, shoqëria, mjedisi etj.) i cili mund të jetë gjetur me zbatimin e formulave të njohura ose me përdorimin e procedurave të caktuara dhe nxjerr përfundime për vërtetësinë e gjykimit të dhënë.								
7.	Prezanton me sukses rezultatet e punës së një detyre eksperimentale për një temë të caktuar nga ndonjë fushë mësimore (p.sh., nga shkencat, teknologjia etj.) të realizuar në laborator ose në punëtori të shkollës apo diku tjetër, përmes përdorimit të teknologjisë informative, jep argumente që lidhin rezultatet e punës eksperimentale me udhëzimet teorike.								
8.	Krijon një vepër artistike me pamje dy dhe tredimensionale me mesazhe nga një fushë mësimore dhe shpjegon para moshatarëve hapat e ndjekur për krijimin e veprës.								
9.	Me një grup të nxënësve/moshatarëve dizajnon një faqe të Internetit për përdorim interaktiv nga ana e nxënësve lidhur me tema nga fusha të ndryshme mësimore, e mirëmban atë sipas rregullit dhe paraqet një model të nxitjes së moshatarëve që t'i përdorin informatat në mënyrë të përgjegjshme.								
10.	Simulon një situatë për marrjen e një vendimi për jetën e vet ose zgjidhjen e një problemi me interes shoqëror, lidh vendimin me pasojat në mënyrë të përgjegjshme, e prezanton gjatë një debati me moshatarë në një kohëzgjatje të caktuar, duke u bazuar në këtë përvojë merr vendime dhe iniciativa të dobishme për vete, për shkollën dhe më gjerë.								

III	Kompetenca e të nxënës - Nxënësi i suksesshëm													
1.	Demonstron shkathtësi funksionale në lexim-shkrim, në matematikë, në jetën e përditshme, në përmbushjen e kërkesave të ndryshme për kryerjen e një detyre apo aktiviteti dhe gjatë të nxënës të dijeve të reja në ndonjë fushë të caktuar mësimore.													
2.	Në mënyrë efektive shfrytëzon përvojat paraprake gjatë zgjidhjes së situatave të ndryshme në jetën e përditshme apo gjatë kryerjes së ndonjë detyre, aktiviteti në ndonjë fushë të caktuar mësimore, diskuton dhe ndan përvojat me të tjerët për mënyrat më praktike të shfrytëzimit të përvojave paraprake në arritjen e dijeve të reja.													
3.	Parashtron pyetje dhe shfaq mendime të strukturuar për zgjidhjen e një problemi apo detyre të një teme të caktuar, bën përmbledhjen e së paku dy veprimeve të përdorura të cilat përcaktojnë drejtimin e mëtejshëm të të nxënës të vet për temën apo problemin e caktuar.													
4.	Zgjidh një problem të caktuar mësimor ose një situatë nga jeta e përditshme. Në bazë të një planifikimi të dhënë dhe në bazë të rezultatit të fituar vërteton saktësinë e planifikimit dhe tregon me shembuj se si do të zbatojë strategjinë e ndjekur edhe në situata dhe kontekste të tjera gjatë të nxënës.													
5.	Përgatit me sukses një përmbledhje të dosjes personale (portfolios), me jo më pak se 900 fjalë, me qëllim të vetëvlerësimit të përparimit të vet në një fushë mësimore të caktuar, veçon në fund të përmbledhjes disa çështje që vërtetojnë përparimin e vet dhe disa nevoja të domosdoshme për përmirësimin e avancimit të mëtejshëm.													
6.	Në mënyrë të pavarur dhe efektive shfrytëzon teknologjinë informative dhe burime të tjera të informimit për të mbledhur materiale për zgjidhjen e një problemi apo detyre të caktuar, të cilat më pas i analizon, i klasifikon dhe i paraqet para të tjerëve përmes TIK-ut dhe ndonjë forme tjetër të shprehjes.													
7.	Kërkon dhe shfrytëzon në mënyrë të duhur këshilla dhe informata për kapërcimin e vështirësive në të nxënë në një fushë të caktuar dhe më pas prezanton rezultatet e arritura.													
8.	Paraqet idetë personale para të tjerëve për mënyrën e zhvillimit të një aktiviteti të caktuar duke dhënë mendime të argumentuara për rezultatet e pritura (në formë skice, grafiku, vizatimi, shkrimi, vepra artistike etj.).													
9.	Në mënyrë të pavarur shfrytëzon udhëzimet e dhëna në ndonjë burim të informatave për të kryer një veprim, aktivitet, detyrë ose për të zgjidhur një problem që kërkohet prej tij, vlerëson vetë përformancën dhe rezultatit e arritur duke iu referuar qëllimeve fillestare (p.sh., burime të informatave në libër, revistë, enciklopedi, internet, hartë, grafik, skicë, partiturë muzikore, skenar etj.).													
IV	Kompetenca për jetë, për punë dhe për mjedis - Kontribuues produktiv													
1.	Përgatit biografinë personale (CV) sipas formatit dhe udhëzimeve të kërkuara dhe e prezanton veten me shkrim ose me gojë para të tjerëve, duke vënë theksin në mundësitë, aftësitë dhe cilësitë personale të angazhimit në një program apo projekt të caktuar.													

2.	Merr pjesë ose udhëheq një fushatë të informimit të qytetarëve për një fushë apo temë të caktuar, për përgatitjen e saj mbështetet në idetë progresive dhe në shembujt pozitivë, përgatitjet i prezanton para klasës duke vënë theksin mbi qëllimet dhe rezultatet e pritura nga ky organizim (p.sh., fushatë informimi për mbrojtjen e mjedisit natyror dhe shoqëror, ose për mënyrat e jetës së shëndetshme etj.).								
3.	Hulumton dhe shfrytëzon mundësitë relevante në dispozicion për zgjedhje të suksesshme të shkollimit të mëtejshëm apo për përgatitje profesionale dhe për këshillim në karrierë, duke përdorur me sukses njohuritë dhe shkathtësitë që i zotëron.								
4.	Demonstron shkathtësi organizative për punë ekipore në situata ku kërkohet të kontribuojnë si ekip në realizimin e detyrave të veçanta mësimore, apo në kryerjen e ndonjë hulumtimi që kontribuon për jetë, për punë dhe për mjedis (p.sh., organizimin e punës ekipore për hulumtimin e shkaktarëve që e dëmtojnë biodiversitetin e bimëve dhe të shtazëve, për dhënien e propozimeve lidhur me mbrojtjen e tyre dhe prezantimin para të tjerëve etj).								
5.	Merr pjesë ose udhëheq një grup punues për organizimin e ndonjë aktiviteti në shkollë ose në komunitet (p.sh., organizimin e një panairi, konference etj.), në të cilin do të prezantohen arritjet e nxënësve dhe të shkollës apo të komunitetit, harton raportin duke vlerësuar rezultatet e arritura me rezultatet e pritura, pjesëmarrjen e audiencës dhe mënyrën e prezantimit.								
6.	Harton një projekt (individualisht ose në grup) për organizimin e një aktiviteti me karakter edukativ brenda ose jashtë shkollës, në të cilin identifikon dhe vlerëson resurset e nevojshme njerëzore dhe materiale që mundësojnë arritjen e objektivave të caktuara.								
7.	Harton një plan (individualisht ose në grup) për zhvillimin e biznesit në rrethin ku jeton, duke u mbështetur në analizën e shanseve/mundësive, rreziqeve, e prezanton para të tjerëve, duke dhënë argumente të ndikimit të planit të zbatuar në zhvillimin ekonomik dhe mirëqenien e qytetarëve.								
8.	Analizon gjendjen e mjedisit (në klasë, në shkollë, në komunitet apo më gjerë), pasojat e ndotjes, propozon alternativa për mbikëqyrje dhe menaxhim të drejtë të gjendjes së vlerësuar më të ndjeshme dhe inicicion zgjidhje konkrete.								
9.	Merr pjesë në aktivitete të ndryshme në nivel klase, shkolle, komunë dhe më gjerë (p.sh., gara të diturisë, gara sportive, aktivitete kulturore, muzikore etj.), diskuton me të tjerët për rezultatet e arritura, procesin e organizimit dhe jep argumente në forma të ndryshme shprehëse si të rritet pjesëmarrja në aktivitete dhe si të përmirësohet procesi i organizimit të tyre.								
V	Kompetenca personale – Individ i shëndoshë								
1.	Analizon përparësitë dhe dobësitë personale, duke i evidentuar masat përmes të cilave synon të mbështesë avancimin personal në përparësitë që ka dhe masat përmes të cilave synon të përmirësojë dobësitë personale.								
2.	Merr pjesë aktivisht në lojëra, në gara sportive apo në aktivitete të tjera kulturore dhe në mënyrë konstruktive menaxhon emocionet e veta.								

3.	Merr pjesë ose udhëheq një grup punues që bashkëpunon me përfaqësues të komunitetit për të ndihmuar moshatarët dhe anëtarët e tjerë të komunitetit të cilët kanë probleme shëndetësore, sociale, ekonomike etj., më pas raporton me gojë ose me shkrim për përvojat personale.									
4.	Me shembuj para të tjerëve ilustron modelet/praktikat e sjelljeve që reflektojnë mënyrat e mbrojtjes dhe të kultivimit të kulturës së vet, vlerave, besimeve dhe kulturave të të tjerëve në mjedisin ku jeton dhe me gjerë.									
5.	Inicion aktivitete për shmangien e paragjytimeve, stereotipave në shkollë dhe në shoqëri dhe për promovimin e vlerave të qëndrueshme shoqërore, duke ilustruar ato me shembuj pozitivë nga ngjarje e individë të njohur.									
6.	Gjykon mënyrën e komunikimit, të sjelljeve dhe të qëndrimeve që nxisin konflikte ndërpersonale në klasë, në shkollë apo në shoqëri, duke vënë theksin në faktorët që kanë ndikuar në shfaqjen e saj dhe jep shembuj të menaxhimit dhe të zgjidhjes së konflikteve ndërpersonale në mënyrë konstruktive.									
7.	Analizon veprimet e veta dhe të kolegëve gjatë një situatë konflikti, duke propozuar alternativa për kapërcimin e tyre ose shmangien në situata të ngjashme.									
8.	Bën zgjidhje të bazuara në informata dhe në përvoja të drejta për të mbrojtur shëndetin dhe mirëqenien nga rreziqet e ndryshme në jetën e përditshme (p.sh., nga përdorimi i duhanit, i alkoolit, i drogave, nga marrëdhëniet e hershme seksuale, zgjedhjet e gabuara ushqimore, ekspozimit të tepruar rrezeve të diellit etj.).									
9.	Në jetën e përditshme vepron në mënyrë të pavarur dhe të përgjegjshme, duke përzgjedhur mënyra të shëndetshme jetese, dieta të lejuara nga mjeku, ushtrime të koordinuara drejt, apo duke iu përgjigjur në mënyrë të duhur situatave të rrezikshme me të cilat mund të ndeshet në jetën e përditshme.									
VI	Kompetenca qytetare – Qytetar i përgjegjshëm									
1.	Përshkruan dhe shpjegon të drejtat, detyrat dhe përgjegjësitë e individit në raste të ndryshme, si: në shtëpi, në klasë, në shkollë, në shoqëri, dallon rastet kur hyjnë në konflikt me njëri-tjetrin dhe paraqet alternativa të zgjidhjes së tyre.									
2.	Në forma të ndryshme të të shprehurit paraqet mënyrën e funksionimit të mjedisit të vet shoqëror në nivel lokal dhe me gjerë, duke dhënë shembuj konkretë se si mund të përmirësohet funksionimi i tij, p.sh. në strukturën organizative, në rregullat e veprimit, në publikimin e pritshmërive, në bashkëpunimin me qytetarë etj.									
3.	Demonstron shembuj të pjesëmarrjes demokratike dhe drejton forma të ndryshme të diskutimit për pjesëmarrjen e qytetarëve në proceset e vendimmarrjes demokratike në nivele të ndryshme (p.sh.: në familje, në shkollë, në komunitet, lokal dhe shtetëror), gjatë diskutimit tregon tolerancë dhe respekt për pyetjet dhe komentet e të tjerëve.									
4.	Merr pjesë në aktivitete të organizuara në shkollë dhe në komunitet për promovimin e vlerave dhe parimeve të të drejtave të njeriut në jetën e përditshme, si, p.sh., në promovimin e barazisë gjinore, diversitetit kulturor, apo në luftimin e varfërisë në nivele të ndryshme dhe luftimin e marginalizimit, duke veçuar përgjegjësitë që do t'i marrë vetë në përkrahje të aktiviteteve.									

5.	Demonstron shembuj konkretë të mbrojtjes së mjedisit natyror dhe atij të krijuar nga njeriu në aktivitete të jetës së përditshme në shtëpi; në klasë, në shkollë dhe në komunitet, propozon alternativa se si të gjithë qytetarët mund të kontribuojnë në mënyra të ndryshme për këtë proces.								
6.	Demonstron veprime të ndryshme që shprehin tolerancë, respekt dhe qëndrim të hapur ndaj dallimeve në komunitetin ku jeton (në klasë, në shkollë, në lagje dhe me gjerë) dhe i shpjegon ato në një debat me të tjerët.								
7.	Diskuton me të tjerët apo në një formë tjetër të shprehurit paraqet interesin personal për çështje publike, shoqërore, historike, natyrore etj., dhe jep propozime për zgjidhjen e ndonjë problemi në komunitet e më gjerë në një fushë të caktuar.								
8.	Menaxhon dhe zgjidh një konflikt në mënyrë konstruktive në kohë dhe në nivel të caktuar duke shfrytëzuar instrumente dhe teknika të ndryshme, p.sh. listën kontrolluese për zgjidhje të konflikteve etj.								
9.	Në formë verbale ose të shkruar përshkruan mundësinë e përdorimit të internetit dhe të informatave në mënyrë të përgjegjshme për tema të caktuara dhe argumenton domosdoshmërinë e përdorimit të drejtë.								

Rezultatet e të Nxënit për Shkallën 6 të Nivelit/SNKA 3 të Kurrikulës

Shkalla e Kurrikulës 6 - Konsolidimi dhe specializimi

Kjo shkallë përfshin klasën XII. Është kjo fazë e kalimit nga adoleshenca në atë të pjekurisë, gjatë së cilës nxënësit duhet të konsolidojnë përvojën e përgjithshme të shkollimit të detyrueshëm dhe të përgatiten për kërkesat e një faze të re të jetës dhe arsimimit të lartë. Nxënësit në programet e shkollave të mesme do të përgatiten për t'u inkuadruar në tregun e punës si punëtorë të shkathët. Ata do t'u ekspozohen sfidave për:

- demonstrimin e aftësive për identifikimin e burimeve të domosdoshme dhe për qasjen kritike të dhënave të ndryshme;
- demonstrimin e aftësisë për vendimmarrje të pavarur dhe për marrjen e përgjegjësive për zgjedhjet dhe veprimet personale;
- demonstrimin e përkushtimit të tyre për angazhim të vazhdueshëm për të nxënë, për studim të mëtutjeshëm dhe/apo për zhvillim profesional;
- demonstrimin e shkathtësive për të zhvilluar dhe për të promovuar strategji për planifikimin e karrierës nëpërmjet kërkimit të shembujve dhe inovacioneve, të cilat ndihmojnë zhvillimin e idesë së ndërmarrësisë;
- demonstrimin e shkathtësive për ndryshimin e konceptit të karrierës, nëpërmjet kërkimit në një spektër më të gjerë të punëve, duke pasur parasysh rëndësinë e zhvillimit të shkathtësive të transferueshme për mundësitë e karrierës në të ardhmen;
- angazhimin në procesin e planifikimit të karrierës personale nëpërmjet hulumtimit lidhur me mundësitë e kualifikimit postsekondar, duke pranuar se qëndrimet dhe nevojat për punë dhe vendimmarrje do të ndryshojnë në mënyrë të vazhdueshme.

Deri në fund të Shkallës së 6-të të Kurrikulës - klasa XII, pritet që nxënësit të kenë zotëruar kompetencat e shprehura në REN dhe nivelet korresponduese të arritshmërisë, si në vijim:

Nr.	Rezultatet e të Nxënit për Shkallën 6 dhe Kompetencat Kryesore	Niveli i ARRITJES së nxënësit					Llojet e përkrahjes për nxënësit			
		1	2	3	4	5	Përkrahje përmfresuese	Mënyrat	Përkrahje për të talentuarit	Mënyrat
1	Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit – Komunikues efektiv									
1.	Përmes së paku një forme të komunikimit (gjuhës, simboleve, shenjave, kodeve, performancës artistike etj.) para një audience të caktuar shpreh çështjet thelbësore të ngritura në një fjalim, interpretim ose ekspozë të dëgjuar për një temë të caktuar nga fusha të ndryshme mësimore.									
2.	Në grup, diskuton në mënyrë konstruktive duke dhënë informata, argumente dhe duke shtruar pyetje në një dialog në kohëzgjatje prej disa minutash, për një temë të caktuar në gjuhën amtare, apo në gjuhën angleze (ose në gjuhën tjetër joamtare apo të huaj).									
3.	Lexon rrjedhshëm një tekst të panjohur në gjuhën angleze (ose në një gjuhë tjetër të huaj), i cili përmban 2-3 faqe (p.sh., tregim letrar, tekst argëtues, artikull gazete ose reviste etj.), identifikon ngjashmëritë dhe dallimet kryesore në strukturën e fjalive në gjuhën angleze dhe asaj në gjuhën amtare, duke nënvizuar dhe duke ilustruar shembuj konkretë.									
4.	Përdor drejt strukturën dhe rregullat standarde të drejtshkrimit të gjuhës angleze, gjuhës joamtare dhe gjuhës së dytë të huaj, në një numër të caktuar të konteksteve, si: ese, e-mail, letër formale dhe joformale etj.									
5.	Lexon rrjedhshëm një tekst të përbërë prej disa paragrafëve dhe shprehet në forma të ndryshme të komunikimit për organizimin, qëllimin, leksikun e përdorur dhe argumenton mesazhin që bart secili paragraf (teksti mund të jetë: narrativ, përshkrues, artistik, imagjinar, administrativ, shkencor, publicistik etj.).									
6.	Prezanton një temë të caktuar nga arti, nga shkenca, nga jeta e përditshme dhe në mënyrë efektive komunikon me audiencën duke përdorur TI dhe mediet e tjera të shkruara dhe elektronike.									
7.	Shpreh mendimin e lirë, opinionin dhe qëndrimin për një temë të caktuar nga jeta, nga shkenca, nga profesioni, nga shoqëria, nga mjedisi duke përdorur forma të ndryshme të komunikimi me gojë, me shkrim, të artit vizual, muzikor, skenik, krijimin letrar etj.									
8.	Angazhohet dhe kontribuon në një diskutim me të tjerët për një temë të caktuar, p.sh. për edukimin medial, duke paraqitur argumente të bazuara në fakte për rolin dhe ndikimin e televizionit, radios, shtypit dhe mjeteve të tjera të informimit në shoqëri, në procesin e përgatitjes së të rinjve për jetë të pavarur dhe orientim në karrierë.									
9.	Në mënyrë efektive përdor programet e TIK-ut gjatë procesit të nxënies (duke përfshirë edhe të nxënët në distancë) dhe kryerjes së detyrave në një fushë të caktuar mësimore.									

II		Kompetenca e të mënduarit – Mendimtar kreativ							
1.	Sqaron ecurinë e zgjidhjes së një problemi në klasë apo jashtë saj, duke e vërtetuar zgjidhjen e problemit përmes metodës së analizës dhe e prezanton para moshatarëve apo para të tjerëve.								
2.	Në mënyrë të pavarur analizon informatat e marra nga burimet e ndryshme për një temë ose detyrë të dhënë, vlerëson cilësinë e tyre dhe i radhit ato sipas rëndësisë dhe qëllimit që kanë (temat mund të jenë, p.sh., Orientimi në karrierë, Integrimet evropiane, Ndryshimet klimatike, Rreziqet nga armët konvencionale, Armatimi bërthamor, Zhvillimi kulturor-artistik në vend etj.).								
3.	Gjykon rezultatet e arritura, nga analiza e të dhënave të një projekti apo programi të realizuar dhe i interpreton ato me gjuhën e matematikës dhe të fushës përkatëse, i paraqet grafikisht, në formë tabelore, duke nxjerrë përfundime të vërtetuara (p.sh., projekt me bazë shkolle, projekt i gjelbërimit, i hartuar nga komuniteti, koncert, ekspozitë tematike, orë letrare, punë laboratorike etj.).								
4.	Bën hulumtim në mënyrë të pavarur për një çështje të caktuar duke përcaktuar fazat dhe procedurat e hulumtimit, paraqet dhe interpreton rezultatet e fituara në tabela dhe grafikë duke përdorur teknologjinë informative.								
5.	Identifikon burimet e informacioneve të nevojshme dhe i shfrytëzon ato në mënyrë të duhur për të zgjidhur një problem në nivelin e caktuar të vështirësisë, duke dhënë shembuj konkretë.								
6.	Vlerëson cilësinë e informatave në një material të shkruar për një temë të caktuar (p.sh., për ngrohjen globale, për diversitetin kulturor dhe etnik etj.), identifikon elementet kryesore, i diskuton me moshatarë, duke dhënë propozime konkrete për shfrytëzimin e shembujve pozitivë në kontekstin lokal apo global, duke shprehur qëndrimin personal.								
7.	Në mënyrë kritike përpunon informatat e mbledhura nga burime të ndryshme për ndonjë temë të ndjeshme në shoqëri, formon qëndrim kritik dhe e paraqet atë gjatë një debati me moshatarë dhe me të tjerë për çështjen e ngritur, 'për' ose 'kundër' (si, p.sh., futja e edukimit fetar në shkollat publike, martesat mes anëtarëve të një gjinie, dënimi me vdekje etj.).								
8.	Argumenton rezultatet e arritura gjatë një eksperimentimi në shkollë apo diku tjetër, duke përshkruar qëllimin, hipotezën dhe mënyrën e vëzhgimit të dukurisë së manifestuar, rezultatet i paraqet në mënyrë tabelore dhe grafike.								
9.	Zbaton njohuritë dhe përvojën në kontekst të zgjidhjes së një problemi nëpërmjet veprimeve të përshtatshme, p.sh. përfshin të rinjtë në një debat për tema me interes shkencor, shoqëror, historik, kombëtar etj., vetëm pasi të jenë bërë përgatitjet e duhura dhe të jetë bërë informimi i të gjithëve.								
III		Kompetenca e të nxënësit – Nxënësi i suksesshëm							
1.	Demonstron shkathtësi të përdorimit të TIK-ut në situata të përditshme dhe në përmbushjen e kërkesave të ndryshme gjatë të nxënësit (p.sh., për ndërtimin e tabelave, grafikëve apo diagrameve, për vizatimin e një plani të shtëpisë, apo për përgatitjen e shkresave dhe prezantimeve etj.).								

2.	Diskuton në grup për mënyrat e bashkëpunimit me të tjerët për të zgjidhur një situatë të re mësimore (ose një problem nga jeta e përditshme, ose për të menaxhuar konfliktet me bashkëmoshatarë), tregon mënyrën e shfrytëzimit të përvojave paraprake për të zhvilluar njohuritë dhe shkathhtësitë e reja në zgjidhjen e situatave dhe problemeve të tilla.																		
3.	Në mënyrë të duhur shfrytëzon këshillat dhe informatat e marra për përkrahje në zgjidhjen e një detyre apo problemi të caktuar, pastaj rezultatet i paraqet para të tjerëve.																		
4.	Bën përpunimin e informacioneve për një temë të caktuar në mënyrë të pavarur dhe efektive, rezultatet e punës i prezanton me shkrim ose me gojë para të tjerëve duke dhënë shpjegime për mënyrën e zgjedhjes dhe të shfrytëzimit të burimeve të informatave.																		
5.	Paraqet një plan studimi (në formë skice, vizatimi, shkrimi etj.) për ndonjë çështje të caktuar (p.sh., vlerat kulturore të rajonit të vet, vlerat e edukimit në shoqëri etj.) duke respektuar të gjithë hapat e një plani të studimit dhe e paraqet para të tjerëve.																		
6.	Shkruan një letër motivuese në të cilën arsyeton angazhimin e vet për pjesëmarrje në një prezantim, promovim ose konkurs diturie nga një fushë e caktuar mësimore, duke vënë theksin në aftësitë dhe cilësitë personale në raport me angazhimin e synuar.																		
7.	Përzgjedh punimet kryesore të dosjes së vet për të shpjeguar para një audience të caktuar strategjitë që ka zbatuar për të ndjekur avancimin e vet dhe masat e aplikuar për të përmirësuar përparimin në mënyrë të vazhdueshme.																		
8.	Në mënyrë kritike vlerëson punën e vet duke iu referuar qëllimeve fillestare të punës, p.sh., në mënyrë të pavarur redakton një dorëshkrim të vet me qëllim të përmirësimit të organizimit të shkrimit, qartësisë së mendimit etj.																		
9.	Në mënyrë produktive menaxhon burimet që i ka në dispozicion (kohën, njerëzit, mjetet e konkretizimit/punës etj.) gjatë kryerjes së një aktiviteti ose detyre të caktuar në një fushë mësimore apo në situata të jetës së përditshme.																		
IV	Kompetenca për jetë, për punë dhe mjedis – Kontribuues produktiv																		
1.	Diskuton në grup të dhënat e grumbulluara për resurset natyrore dhe shoqërore të cilat i shfrytëzon komuniteti ku jeton, mënyrat e përdorimit të tyre dhe nxjerr konkludime të arsyeshme për përkrahje të nevojshme apo ndryshim të shprehive negative të përdorimit të resurseve.																		
2.	Merr vetiniciativë në aktivitete të ndryshme me interes për lëndën/fushën mësimore, për klasën, për shkollën dhe për mjedisin ku jeton, si dhe tregohet i përgjegjshëm në realizimin e vetiniciativave dhe detyrave e aktiviteteve të caktuara.																		
3.	Me shembuj argumenton ndërlidhjet midis punës, profesionit dhe karrierës, në një punim/prezantim me shkrim prej jo më pak se 1000 fjalësh, në përmbledhje të punimit/prezantimit ofron shembuj të shfrytëzimit të mundësive në dispozicion për arsimim dhe përgatitje profesionale ose këshillim në karrierë.																		

4.	Planifikon dhe menaxhon me sukses një projekt me objektiva të caktuara, p.sh. një projekt për organizimin e ndërmarrjeve të vogla që ofrojnë produkte dhe shërbime për qytetarë, duke u mbështetur në kërkesat aktuale të tregut të punës.								
5.	Nëpërmjet njërës nga format e shprehjes paraqet modelin e një udhëheqësi të një ndërmarrjeje ose organizate, sipas imagjinatës personale, duke i potencuar karakteristikat kryesore të një udhëheqësi të suksesshëm.								
6.	Përdor programe softuerike për llogaritjen, shqyrtimin, interpretimin dhe paraqitjen e të dhënave me informata të nevojshme (p.sh., të një mjedisi të biznesit) duke bërë një rangim sipas nevojave dhe prioriteteve të ndërmarrjes ose organizatës.								
7.	Zbaton udhëzimet dhe rregullat e shkruara në udhëzues, katalog, apo skicë për përdorimin e drejtë të mjeteve laboratorike, makinave dhe pajisjeve teknike, gjatë një ushtrimi ose aktiviteti (në klasë, në laborator ose në punëtori), tregon për të tjerët mënyrën e zgjedhjes dhe përdorimit të tyre.								
8.	Nëpërmjet njërës nga format e shprehjes paraqet kompetencat e nevojshme për t'u gjendur me sukses në situata të ndryshme jetësore apo për zhvillim të karrierës në një fushë të caktuar.								
9.	Merr iniciativa të suksesshme për organizimin e aktiviteteve të ndryshme që nxisin bashkëpunimin e ndërmarrjeve me komunitetin, duke promovuar interesin e dyanshëm.								
V	Kompetenca personale – Individ i shëndoshë								
1.	Demonstron vetëbesim dhe shkathtësi personale e ndërpersonale në jetën e përditshme, duke dalluar me kohë aspektet pozitive për veten dhe duke ndërmarrë veprime konkrete për arritjen e rezultateve të synuara personale.								
2.	Tregon shkathtësi në organizimin e lojës me të tjerët, garave sportive, apo aktiviteteve kulturore dhe menaxhon me sukses emocionet e veta në situata të ndryshme gjatë aktiviteteve dhe gjatë jetës së përditshme.								
3.	Në forma të ndryshme shfaq bashkëndjesi për të tjerët, p.sh. merr pjesë në aktivitete bamirësie, ndihmon të moshuarit, të sëmurët etj. dhe përvojat e tilla i prezanton para të tjerëve.								
4.	Nëpërmjet njërës nga format shprehëse paraqet përparësitë e aktiviteteve fizike në baza ditore për individin e shëndoshë dhe prezanton para të tjerëve qëllimet e vendosura për veten në këtë fushë (për marrje me aktiviteteve fizike në baza ditore) dhe nivelin e arritjes së tyre.								
5.	Zgjidh konfliktet ndërpersonale në mënyrë konstruktive, duke shqyrtuar alternativat, duke marrë vendime dhe duke shpjeguar zgjedhjet e bëra.								
6.	Bën zgjedhje dhe merr vendime të duhura lidhur me shëndetin, dietat dhe ushtrimet në jetën e përditshme, apo në situata të paraqitura në formë të detyrave dhe aktiviteteve mësimore, kur duhet të veprojë në mënyrë të pavarur për jetësimin në praktikë të këtyre aspekte.								
7.	Në forma të ndryshme shfaq ndërgjegjësim për menaxhimin e emocioneve, stresit dhe konflikteve në situata të jetës së përditshme apo në situata të improvizuara me karaktere të ndryshme historike, aktuale, sociale etj.								

8.	Në forma të ndryshme shprehëse prezanton mënyrën e zbatimit të planeve personale të jetës (p.sh., në shkollim, në karrierë, në sport, në shoqëri, në biznes etj.), vlerëson nivelin e arritjeve të qëllimeve të synuara dhe ilustron shembuj të veçantë të planeve personale për të ardhmen.																			
9.	Në forma të ndryshme shpreh qëndrimin e vet të pavarur për përgjegjësinë e të qenit prind/kujdestar, planifikimin e familjes dhe merr vendime të drejta për të ardhmen e vet.																			
VI	Kompetenca qytetare - Qytetar i përgjegjshëm																			
1.	Nëpërmjet njëres nga format e shprehjes prezanton mënyrën e funksionimit të mjedisit shoqëror në nivel lokal dhe me gjerë, si dhe me shembuj konkretë tregon kontributin e vet në ruajtjen dhe kultivimin e vlerave të mjedisit.																			
2.	Harton një listë të propozimeve për zbatimin e të drejtave themelore të njeriut në një situatë të caktuar, i kategorizon propozimet sipas rëndësisë dhe urgjencës, duke veçuar argumentet kryesore që mbështesin qëndrimin e vet.																			
3.	Në forma të ndryshme prezanton se si i ushtron të drejtat e veta në shkollë dhe në jetën e përditshme dhe si i njeh e i respekton të drejtat e të tjerëve, duke dhënë shembuj konkretë.																			
4.	Në forma të ndryshme të të shprehurit paraqet vlerat kryesore të diversitetit në shoqëri apo në mjedisin ku jeton, i diskuton ato me të tjerët, duke i krahasuar me shembuj nga jeta e përditshme që tregojnë tolerancë, respekt dhe qëndrim të hapur ndaj dallimeve.																			
5.	Me shembuj nga jeta e përditshme ilustron praktikat e menaxhimit dhe të zgjidhjes së konflikteve në mënyrë konstruktive, duke ndarë me të tjerët përvojat, mendimet dhe ndjenjat e veta gjatë diskutimeve të shembujve ilustrues në këtë fushë.																			
6.	Merr pjesë në proceset demokratike të vendimmarrjes në nivele të ndryshme (në familje, në shkollë, në komunitet etj.), i diskuton me të tjerët përvojat personale dhe paraqet propozime të argumentuara se si të përmirësohet pjesëmarrja demokratike dhe vendimmarrja në shoqëri.																			
7.	Në një debat me të tjerët ose në një formë tjetër të të shprehurit prezanton masat për mbrojtjen dhe avancimin e vlerave dhe parimeve të të drejtave të njeriut në jetën e përditshme, duke veçuar shembuj konkretë të ndonjë aktiviteti (p.sh., aktivitete për promovimin e barazisë gjinore, luftimit të paragjyqimeve dhe diskriminimit, luftimit të varfërisë etj.).																			
8.	Me shembuj ilustron zgjidhjen e problemeve të caktuara në nivel shkolle ose në nivel të komunitetit dhe format e përkrahjes, si dhe e arsyeton atë me argumente para një audience të caktuar (p.sh., demonstroi mënyrën e ofrimit të ndihmës së parë në rastet e fatkeqësive natyrore ose njerëzore).																			

9. Merr pjesë në përgatitjen dhe organizimin e një aktiviteti (në shkollë apo në komunitet) për mbrojtjen e mjedisit natyror dhe atij të krijuar nga njeriu dhe në mënyra të ndryshme kontribuon për zhvillim të qëndrueshëm të tij.

10. Ndërmerr apo udhëheq një aktivitet për vlerësimin e cilësisë dhe të saktësisë së informatave në një ueb faqe që më së shumti shfrytëzohet nga moshatarët, arsyeton aktivitetin dhe vlerësimin e bërë, ofron këshilla të mbështetura në etikë morale dhe profesionale për shfrytëzim të përgjegjshëm të internetit.

FUSHAT E KURRIKULES NE ARSIMIN E MËSËM TË LARTË

- 1. Shkollë
- 2. Komunitet
- 3. Mbrojtja e mjedisit natyror
- 4. Mbrojtja e mjedisit krijuar nga njeriu
- 5. Zhvillim i qëndrueshëm
- 6. Etikë profesionale



III.

FUSHAT E KURRIKULËS NË ARSIMIN E MESËM TË LARTË

Gjuhët dhe komunikimi

Artet

Matematika

Shkencat natyrore

Shoqëria dhe mjedisi

Shëndeti dhe mirëqenia

Jeta dhe puna

Fushat e Kurrikulës

Kurrikula e Kosovës është strukturuar në shtatë fusha, të përkufizuara si fusha të Kurrikulës. Fushat e Kurrikulës përbëjnë bazën për zhvillimin e kompetencave kryesore të përcaktuara me dokumentin e Kornizës së Kurrikulës, nga fëmijëria e hershme deri në arsimin e mesëm të lartë. Këto vlejné si për arsimin e mesëm të lartë të përgjithshëm ashtu edhe për arsimin profesional. Lidhjet ndërmjet fushave, lëndëve dhe moduleve të Kurrikulës duhet të jenë në funksion të zhvillimit të kompetencave kryesore.

Fushat e Kurrikulës përbëjnë bazën për organizimin e procesit edukativo-arsimor në shkollë në nivele dhe shkallë përkatëse të Kurrikulës. Fushat e Kurrikulës janë:

- Gjuhët dhe komunikimi
- Artet
- Matematika
- Shkencat natyrore
- Shoqëria dhe mjedisi
- Shëndeti dhe mirëqenia
- Jeta dhe puna

Për secilën fushë kurrikulare janë përcaktuar rezultatet e të nxëniet, të cilat do të mundësojnë arritjen e kompetencave kryesore.

Fushat mësimore përfshijnë një ose disa lëndë apo module mësimore. Lëndët dhe modulet mbështeten në qëllimet dhe rezultatet mësimore të përcaktuara për fushën përkatëse kurrikulare. Disa lëndë të një fushe kurrikulare mund të paraqiten si të integruara në shkallë të ndryshme të Kurrikulës.

Fusha kurrikulare - Gjuhët dhe Komunikimi

Hyrje

Arsyeshmëria dhe përshkrimi

Konceptet dhe përshkrimi

Qasja e bazuar në kompetenca

Rezultatet e të nxënit të fushës

Çështjet ndërkurrikulare

Ndarja e kohës – përshkrimi

Udhëzime metodologjike

Udhëzime për vlerësim

Materialet dhe burimet mësimore

1. Hyrje

Bazuar në Kornizën e Kurrikulës, fusha Gjuhët dhe komunikimi, përfshin këto lëndë: gjuhën amtare, gjuhën e parë të huaj (gjuhën angleze), gjuhën e mjedisit, si dhe gjuhët e tjera të huaja. Kjo fushë u mundëson nxënësve që të zhvillojnë dhe të kultivojnë përdorimin e gjuhës si mjet komunikimi në shkollë, në jetën e përditshme, në jetën profesionale dhe në jetën publike. Nëpërmjet kësaj fushe kurrikulare, në secilën lëndë duhen arritur të gjitha kompetencat e përcaktuara në Kornizën e Kurrikulës.

Qëllimi kryesor i Kurrikulës Bërthamë për fushën Gjuhët dhe komunikimi është që nxënësve t'u mundësojë të zhvillojnë shkathtësitë e komunikimit në lëndët e përfshira në këtë fushë. Kjo mundëson që nxënësit, në çdo shkallë a nivel, të aplikojnë shkathtësitë e komunikimit, duke u mbështetur në zhvillimin e sistemit gjuhësor: të dëgjuarit, të folurit, të lexuarit dhe të shkruarit.

Prandaj, fusha Gjuhët dhe komunikimi mundëson komunikimin e realizuar nëpërmjet: të dëgjuarit, të folurit, të lexuarit e të shkruarit, të cilat janë të ndërvarura njera me tjetrën.

Qëllimi i fushës Gjuhët dhe komunikimi është:

- zhvillimi i shkathtësive të komunikimit,
- të kuptuarit përmes dëgjimit,
- të folurit në funksion të dhënies dhe marrjes së informacionit,
- të lexuarit, lexim-kuptimi,
- të kuptuarit e teksteve të shkruara,
- të shkruarit e teksteve letrare dhe joletrare,

- dallimi i teksteve letrare dhe joletrare,
- analiza dhe interpretimi i teksteve letrare dhe joletrare,
- njohja e sistemit gjuhësor: fonetikë, morfologji, sintaksë, leksik;
- zhvillimi i aftësive për të reaguar me shkrim dhe me gojë në situata të ndryshme,
- zhvillimi i shkathtësive të të shprehurit nëpërmjet mjeteve të ndryshme, auditive, vizuale dhe informative,
- zhvillimi i shkathtësive të komunikimit nëpërmjet përdorimit të TIK-ut,
- formimi i përgjithshëm gjuhësor, letrar, kulturor dhe jetësor.

Gjuha amtare mësohet nëpër të gjitha shkallët e kurrikulës, që nga klasa parafillore deri te klasa e dymbëdhjetë. Gjuha angleze fillon nga shkalla e parë dhe mësohet deri në klasën e fundit të shkollës së mesme të lartë. Gjuha shqipe për nxënësit e komunitetit joshqiptar mësohet nga shkalla e dytë (klasa e tretë) e Kurrikulës.

2. Arsyeshmëria dhe përshkrimi

Fusha Gjuhët dhe komunikimi të gjithë nxënësve u mundëson mësimin e lëndëve brenda fushës përkatëse. Kurrikula Bërthamë për nivelin e tretë përcakton kompetencat dhe rrugën se si duhet të arrihen këto kompetenca të shprehura përmes rezultateve themelore të fushës sipas shkallëve kryesore të Kurrikulës.

Kurrikula Bërthamë përfshin qëllimin, rezultatet e të nxënësve, udhëzime metodologjike të mësimdhënies dhe të nxënësve, kriteret e vlerësimit për fushë dhe për shkallë kurrikulare. Kurrikula, gjithashtu, paraqet një pasqyrë të qartë për njohuritë, shkathtësitë, qëndrimet dhe vlerat që nxënësit duhet t'i zhvillojnë, t'i përvetësojnë dhe t'i arrijnë nëpër shkallë dhe nivele.

Kjo Kurrikulë u dedikohet nxënësve, mësimdhënësve, prindërve dhe komunitetit të gjerë dhe shkollave u mundëson që të plotësojnë nevojat individuale të nxënësve. Kurrikula ofron mundësi të njëjta për të gjithë nxënësit dhe siguron gjithëpërfshirjen dhe mundësitë për sukses, pa marrë parasysh vështirësitë e tyre. Ajo u mundëson nxënësve zhvillimin e të kuptuarit të thellë të roleve dhe të përgjegjësive të tyre si qytetarë; u ndihmon nxënësve që të ballafaqohen me çështje dhe rrethana të ndryshme morale dhe shoqërore të cilat ata i ndeshin në jetën e tyre.

Kurrikula Bërthamë është strukturuar sipas parimeve të përcaktuara në Kornizën e Kurrikulës (shkallët dhe nivelet kryesore). Kurrikula Bërthamë paraqet ato se çfarë nxënësit duhet të mësojnë nga lëndët e përfshira në fushën: Gjuhët dhe komunikimi për shkallët kryesore 1-6.

3. Konceptet dhe përshkrimi :

- Tekstet letrare dhe joletrare;
- Gjuha figurative dhe jofigurative;
- Pjesët skenike, teatri, dramatizimi etj.;
- Historia, teoria, kritika, romantizmi, realizmi, letërsia antike, letërsia moderne;
- Sistemi i gjuhës (gramatikë, leksik, fonetikë, sintaksë, drejtshkrim).

4. Qasja e bazuar në kompetenca

Fusha Gjuhët dhe komunikimi, me lëndët e saj, nëpërmjet rezultateve të të nxënësve, duhet t'i arrijë gjashtë kompetencat e përcaktuara në Kurrikulë, të cilat janë: komunikues efektiv, mendimtar kreativ, nxënës i suksesshëm, kontribuues produktiv, individ i shëndoshë, qytetar i përgjegjshëm. Këto duhet të arrihen nëpër shkallët kryesore të Kurrikulës, gjatë tërë procesit mësimor si dhe gjatë përzgjedhjes dhe organizimit të përvojave mësimore. Kompetencat integrohen në mënyrë të balancuar dhe përfshijnë njohuritë, shkathtësitë qëndrimet dhe vlerat.

Në fushën Gjuhët dhe komunikimi nxënësi duhet të arrijë këto kompetenca:

- të komunikojë dhe të shprehet nëpërmjet gjuhëve, simboleve, shenjave dhe kodeve;
- të flasë, të dëgjojë, të lexojë e të shkruajë dhe të shprehet në gjuhën amtare dhe (së paku) në një gjuhë tjetër të huaj;
- të angazhohet dhe të kontribuojë në dialog të respektueshëm dhe produktiv;
- të japë dhe të pranojë informata kthyesë në mënyrë konstruktive dhe kreative;
- të respektojë rregullat e përgjithshme të komunikimit, ndërveprimet dhe njëkohësisht të jetë kreativ;
- të manifestojë njohuri kulturore, gjuhësore, letrare e jetësore në jetën individuale dhe publike;
- të përdorë TIK-un dhe mediet në mënyrë efektive dhe të përgjegjshme si mjete të rëndësishme të in formimit, të mësim, të komunikimit dhe të ndërveprim.

5. Rezultatet e të nxënit të fushës

Rezultatet e të nxënit janë hartuar mbi bazën e koncepteve themelore të fushës. RN për fushën Gjuhët dhe komunikimi përmbajnë në vete kërkesat që nxënësi duhet t'i arrijë pas përfundimit të çdo shkalle.

Organizimi i RN-së përmban njohuritë, shkathtësitë, qëndrimet dhe vlerat të cilat zhvillohen dhe thellohen gradualisht nëpër shkallë, duke pasur parasysh zhvillimin fizik dhe psikomotorik të nxënësve. Këto rezultate mundësojnë arritjen e gjashtë kompetencave të përfshira në Kornizën e Kurrikulës. RN ofrojnë zhvillimin dhe arritjen e vlerave për fushën Gjuhët dhe Komunikimi: demonstrimin e shkathtësive të komunikimit (te dëgjuarit, të folurit, të lexuarit, të shkruarit), demonstrimin e shkathtësive të komunikimit ndërpersonal, vlerësimin e zgjidhjeve për një problem, zbatimin e ideve abstrakte për situata konkrete, shfrytëzimin e teknologjisë së përshtatshme, aplikimin e parimeve etike për vendimmarrje, punën si një anëtar i ekipit për të arritur qëllimet e përbashkëta, diskutimin, krahasimin e karakteristikave të një kulture dhe të kulturave të ndryshme.

Rezultatet e të nxënit për fushën Gjuhët dhe komunikimi mundësojnë integrimin dhe qasjen e tërësishme në mësimdhënien e lëndëve të veçanta brenda një fushe. Rezultatet e të nxënit për fushën sigurojnë:

Lidhshmërinë ndërmjet lëndëve dhe aktiviteteve mësimore, që realizohen në kuadër të fushës Gjuhët dhe komunikimi ka për qëllim integrimin e njohurive përkatëse, shkathtësive, qëndrimeve dhe vlerave të ofruara nëpërmjet lëndëve dhe, në përgjithësi, inkurajimin e mësim të integruar;

Promovojnë qasjen e bazuar në kompetenca, duke mundësuar zhvillimin e një sistemi të përbashkët të përvojave mësimore të ndërlydhura, si dhe sigurojnë një platformë për zhvillimin e planeve dhe programeve lëndore; Mundësojnë zbatimin e praktikave të reja të mësimdhënies, duke inkurajuar zhvillimin e planeve dhe programeve në bazë shkolle.

Për secilën fushë kurrikulare përcaktohen rezultatet e të nxënit, të cilat do të mundësojnë arritjen e kompetencave kryesore. Fushat mësimore përfshijnë një ose disa lëndë apo module mësimore. Lëndët dhe modulet mbështeten në qëllimet dhe rezultatet mësimore të përcaktuara për fushën përkatëse kurrikulare. Disa lëndë të një fushe kurrikulare mund të paraqiten si të integruara në shkallë të ndryshme të Kurrikulës.

REZULTATET E TË NXËNIT PËR SHKALLËT 5 DHE 6

Shkalla 5 Klasa X, XI	Shkalla 6 Klasa XII
SHKATHTËSITË E KOMUNIKIMIT	
<p>Të dëgjuarit dhe të folurit</p> <ul style="list-style-type: none"> Përdor gjuhën për të arritur efekte të veçanta duke shqyrtuar tekste letrare dhe joletrare dhe paraqet vështrim të përgjithshëm përmes ideve dhe pikëpamjeve të veta, për mënyrën se si janë krijuar ato dhe se si krijimet artistike ndikojnë në interesat, idetë, qëndrimet dhe vlerat e tyre Njohin mënyrat e të folurit, që ndryshojnë sipas qëllimit, përmbajtjes, publikut. 	<p>Të dëgjuarit dhe të folurit</p> <ul style="list-style-type: none"> Vlerëson informatat, mendimet, emocionet, pikat e forta dhe të metat e pikëpamjeve të ndryshme gjatë diskutimeve të paraqitura për tekstet letrare dhe joletrare dhe gjykon se si idetë ndërlihen. Përgjigjet me gojë për tregimet e lexuar me zë, duke dhënë mendimet e veta për pyetjet faktike të të kuptuarit (kush, çfarë, kur, ku, dhe si?).
<p>Të lexuarit</p> <ul style="list-style-type: none"> Kupton dhe analizon karakteristikat e gjinive, llojeve, zhanreve të letërsisë (tregim, novelë, roman, poezi, tekste informative) si dhe analizon stilin, gjuhën dhe qëllimin e tyre, duke vlerësuar vlerat e paraqitura në to. Lexon dhe përgjigjet për përmbajtjen e tregimeve, teksteve dhe rithekson faktet e gjetura në to. 	<p>Të lexuarit</p> <ul style="list-style-type: none"> Analizon dhe vlerëson informatat e nxjerra nga tekste komplekse (tekste letrare dhe joletrare) dhe nxjerr konkluzione të argumentuara për të zgjeruar interpretimet e tyre. Lexon dhe kupton përmbajtjen e tregimeve dhe teksteve, rithekson fakte dhe detaje për të qartësuar idetë
<p>Të shkruarit</p> <ul style="list-style-type: none"> Vlerëson përdorimin e duhur të gjuhës, të përmbajtjes (se a është e qartë, koherente dhe e lexueshme), organizon idetë dhe përdor informatën për të krijuar forma të të shprehurit me shkrim (p.sh., ese, ditar, biografi, tekste humoristike, prezantime etj.). Shkruan tekste me qëllim dhe me temë të caktuar duke përdorur rregullat e drejtshkrimit. 	<p>Të shkruarit</p> <ul style="list-style-type: none"> Analizon dhe vlerëson tekste të zhanreve të ndryshme për të paraqitur interpretime me shkrim, përshtat strategjitë dhe modelet e organizimit të shkrimit, bën aluzione dhe nxjerr përfundime për to. Përdor forma të caktuara të shkrimit për qëllim dhe publik të caktuar, duke përdorur rregullat e drejtshkrimit.
II. KUPTIMI DHE ANALIZA E TEKSTEVE	
<ul style="list-style-type: none"> Analizon dhe argumenton për format dhe gjinitë letrare dhe artistike tradicionale, shqyrton stilet dhe metodat artistike (lidhjet dhe ndikimet midis tyre) në periudha të caktuara të zhvillimit të historisë së shoqërisë. Kupton gjuhën e thjeshtë figurative dhe shprehjet letrare. 	<ul style="list-style-type: none"> Analizon dhe vlerëson veprat letrare, artistike bashkohore në raport me veprat tradicionale, i interpreton duke i krahasuar stilet dhe format e të shprehurit dhe jep mendim kritik për to duke sintetizuar dhe duke konkluduar për funksionin dhe vlerat e tyre. Analizon dhe kupton qëllimin e teksteve të lexuara.
III. ZHVILLIMI I KREATIVITETIT	
<ul style="list-style-type: none"> Krijon punime të ndryshme letrare dhe joletrare duke krijuar modele për tema, ngjarje për të shprehur mendimet, idetë, emocionet, pikëpamjet dhe qëndrimet e veta për çështje të caktuara të shoqërisë. 	<ul style="list-style-type: none"> Krijon vepra më komplekse nëpërmjet gjuhës dhe shprehjeve artistike duke reflektuar kulturën, ndjenjat, emocionet, mendimet, idetë, pikëpamjet dhe përvojën për të shprehur qëndrimet e veta për tema globale dhe çështje të ndryshme të shoqërisë.
IV. IDENTITETI DHE KULTURA	
<ul style="list-style-type: none"> Identifikon materiale nga shumë kultura, që janë relevante për përvojën e tij, përfshirë mendimet, qëndrime, idetë dhe i paraqet në krijimet e veta kulturat e ndryshme, për një periudhë të caktuar të historisë së një vendi tjetër). 	<p>Paraqet idetë për kushtet shoqërore politike dhe kulturore, jep shembuj të punimeve që ngjallin emocione, ose që reflektojnë sfida për vlera të ndryshme si të drejtat, diskriminimi, racizmi etj.</p>
V. MEDIET	
<ul style="list-style-type: none"> Përdor rregulla më komplekse për shfaqje, prezantim multimedial dhe vendos për kohën e përshtatshme të organizimit në mënyrë që ngjarja të rrjedhë pa probleme (shkruan skenar, plan, komente etj.), krijon punime më komplekse; dramë, libër me vizatime një punim multimediatik. 	<ul style="list-style-type: none"> Përzgjedh format e paraqitjeve, shpjegon se punimet e ndryshme artistike dhe mediet përcjellin kuptimin e formave të ndryshme të artit komercial (përkthyer se si imazhet janë paraqitur në reklama për efekte specifike, shpjegon se si disa mesazhe janë transmetuar drejtpërdrejt dhe disa janë të nënkuptuara).

VI. PËRDORIMI I TIK-UT

- Përdor programe softuerike për të hulumtuar dhe për të krahasuar materiale, informacione nga burime të ndryshme, për të prodhuar krijime më komplekse, si: reportazhe, kronikë, intervistë etj.
- Përdor teknologjinë (programe softuerike konvencionale) për të prodhuar krijime më komplekse në artet e ndryshme, si: video, animacion, reportazh, film dokumentar etj.

VII. VLERAT DHE QËNDRIMET

- Komunikon mirë
- Merr pjesë në diskutim
- Bashkëpunon
- Kërkon dhe jep ndihme
- Respekton mendimin e të tjerëve
- Kushton vëmendje
- Zhvillon personalitetin dhe humanitetin
- Merr iniciativa dhe tregon interesim për qasje të ndryshme
- Motivohet për zhvillimin e shkathhtësive
- Zhvillon imagjinatën dhe kreativitetin për zgjidhjen e problemeve
- Përdor teknologjinë informative
- Dëshmon vullnet dhe gatishmëri për punë individuale dhe në grupe
- Respekton parimet e të tjerëve
- Tregon vetëbesim për punë të pavarur
- Përdor imagjinatën dhe kreativitetin
- Është i pavarur në vendimmarrje dhe në veprime
- Bën pyetje dhe përgjigjet në mënyrë të përgjegjshme
- Kritik duke u mbështetur mbi argumente
- Tregon kureshtje për hulumtimin
- Kujdeset për veten, për të tjerët dhe për ambientin

VIII. Njohuritë

Të Dëgjuarit

- Të dëgjuarit e teksteve informative
- Të dëgjuarit e efektshëm (shqiptimi i tingujve, pasurimi i fjalorit)
- Të dëgjuarit dhe pasurimi i leksikut

Të folurit

- Të folurit në funksion të marrësit dhe të dhënësit të informacionit
- Të folurit aktiv në grup
- Të folurit në funksion të pasurimit të leksikut
- Komunikimi verbal dhe joverbal

Të lexuarit

- Njohja e teksteve të ndryshme letrare dhe joletrare
- Lexim-kuptimi, leximi i teksteve prezantuese

Të shkruarit

- Kompetencat dhe njohuritë e dëshmuara në shkrim
- Aftësitë dhe të kuptuarit
- Shprehitë dhe shkathhtësitë

IX. Shkathhtësitë

- Të komunikuarit
- Të dëgjuarit
- Të folurit
- Të shkruarit
- Të lexuarit
- Të kuptuarit
- Përdorimi i teknologjisë informative
- Zgjidhja e problemeve
- Aftësitë e të menduarit
- Përpunimi i informacionit
- Të menduarit krijues

6. Çështjet ndërkurrikulare

Në fushën: Gjuhët dhe komunikimi duhet të trajtohen edhe çështjet ndërlëndore, ndërkurrikulare, të cilat duhet të arrihen nëpërmjet të nxëniet të lëndëve dhe temave të caktuara, si:

- të drejtat e njeriut,
- edukimi qytetar, edukimi ndërkulturor,
- edukimi medial,
- edukimi për paqe,
- edukimi për zhvillim të qëndrueshëm...

7. Ndarja e kohës - përshkrimi

Planifikimi i kohës bëhet në harmoni me rezultatet e të nxëniet, të parapara për shkallë dhe fushë. Koha shpërndahet dhe nxirret nga përqindja e paraqitur në tabelën e mëposhtme dhe pastaj ndahet për lëndë. Duhet pasur parasysh se pjesa më e madhe e kohës, kur të ndahet nga shkolla – mësimdhënësit, i dedikohet gjuhës amtare.

Shkolla e mesme e lartë (SNKA 3) Gjumnazi i shkencave natyrore						
Fushat kurrikulare	Shk.5				Shk.6	
	Klasa X	Klasa XI	Gjithsej orë		Klasa XII	
	Nr. orëve	Nr. orëve	Gj. Orë	%	Gj. Orë	%
Gjuhët dhe komunikimi - Gjuhë amtare - Gjuhë angleze -Gjuhë e dytë e huaj -Gjuhë tjera	8	8	16	26.67	8	25.00

Shkolla e mesme e lartë (SNKA 3) - Gjumnazi Shoqëror Gjuhësor						
Fushat kurrikulare	Shk.5				Shk.6	
	Klasa X	Klasa XI	Gjithsej orë		Klasa XII	
	Nr. orëve	Nr. orëve	Gj. Orë	%	Gj. Orë	%
Gjuhët dhe komunikimi - Gjuhë amtare - Gjuhë angleze -Gjuhë e dytë e huaj -Gjuhë e tretë e huaj - Gjuhë tjera	8	8	16	26.67	9	28.13

Shkolla vendosë për gjuhën e tretë si lëndë zgjedhore.

Shkolla e mesme e lartë (SNKA 3) Shkollat profesionale						
Fushat kurrikulare	Shk.5				Shk.6	
	Klasa X	Klasa XI	Gjithsej orë		Klasa XII	
	Nr. orëve	Nr. orëve	Gj. Orë	%	Gj. Orë	%
Gjuhët dhe komunikimi - Gjuhë amtare - Gjuhë angleze -Gjuhë e dytë e huaj	5	5	10	15.63	5	15.63

Varianti A1:

Shkolla e mesme e lartë (SNKA 3) - Gjinnazi i shkencave natyrore

Fushat kurrikulare	Lëndët mësimore	Shk.5				Shk.6		
		Klasa X		Klasa XI		Klasa XII		
		Nr. orëve	Nr. orëve	Gj. Orë	%	Nr. oreve	Gj. Orë	%
Gjuhët dhe komunikimi	Gjuha amtare	4	4	16	26.67	4		25.00
	Gjuha angleze	2	2			2		
	Gjuha e dytë e huaj	2	8	8		2	8	
	Gjuhët e tretë e huaj	-	-			-		
	Gjuhët tjera	-	-			-		

Shkolla e mesme e lartë (SNKA 3) - Gjinnazi Shoqëror Gjuhësor

Fushat kurrikulare	Lëndët mësimore	Shk.5				Shk.6		
		Klasa X		Klasa XI		Klasa XII		
		Nr. orëve	Nr. orëve	Gj. Orë	%	Nr. oreve	Gj. Orë	%
Gjuhët dhe komunikimi	Gjuhë amtare	4	4	16	26.67	4		28.13
	Gjuhë angleze	2	2			3		
	Gjuhë e dytë e huaj	2	8	8		2	9	
	Gjuhë e tretë e huaj	-	-			-		
	Gjuhë tjera	-	-			-		

8. Udhëzime metodologjike

Për realizimin dhe arritjen e rezultateve për fushë dhe shkallë kryesore, çelës është zbatimi i metodave, i teknikave dhe i formave për mësimdhënie dhe nxënie. Mësimdhënësi duhet të përdorë metodat e ndryshme të punës me qëllim të arritjen e rezultateve të fushës.

Zbatimi i metodologjisë së mësimdhënies me nxënësin në qendër, u mundëson nxënësve motivim për punë, zhvillim të kreativitetit, shkëmbim të ideve, debate, nxënie më të lehtë, bashkëpunim mes tyre, zgjidhje të problemeve, hulumtim të burimeve për marrjen e informacioneve të ndryshme etj.

Mësimdhënësi duhet të zgjedhë metodat dhe teknikat mësimore (si: Brainstorming, DRTA, DLTA etj.) në funksion të arritjes së rezultateve të të nxënësve, duke iu përshtatur aftësive dhe njohurive të nxënësve, kërkesave të tyre, vendit ku realizohet njësia mësimore, hapësirës dhe gjendjes materiale të shkollës (klasës).

9. Udhëzime për vlerësim

Zbatimi i Kurrikulës Bërthamë në vete përfshin edhe çështjen e vlerësimit të vazhdueshëm të nxënësve, që ndihmon mësimdhënësit për ndjekjen e zhvillimit gradual të shkathtësive, qëndrimeve dhe vlerave të nxënësve. Vlerësimi bëhet me qëllim që të verifikohet se në ç'skallë i kanë zotëruar nxënësit kompetencat dhe RN të fushës nëpër shkallët kryesore të Kurrikulës Bërthamë. Gjatë vlerësimit identifikohen vështirësitë me të cilat ballafaqohen nxënësit, përparësitë dhe pengesat, ai u ndihmon nxënësve për përmirësim të vazhdueshëm. Vlerësimi si proces nxjerr në pah arritjen e qëllimeve të fushës nëpërmjet matjes së RN të shtrira në shkallë dhe në fushë. Metodologjia e mësimdhënies dhe nxënies është e lidhur ngushtë me procesin e vlerësimit të nxënësve. Duhet t'i vlerësojmë kompetencat dhe RN, të cilat janë kërkesë e paraparë në Kurrikulën Bërthamë e të cilat nxënësi duhet t'i arrijë deri në fund të klasës, të shkollës apo të nivelit. Vlerësimi i nxënësve për fushën: Gjuhët dhe komunikimi për nivelin e tretë, ka për synim matjen e kompetencave të fushës, të paraqitura nëpërmjet rezultateve.

Vlerësimi mund të klasifikohet si vlerësim formues, diagnostikues, përmbledhës dhe motivues.

Gjatë vlerësimit përdoren forma të ndryshme, si:

- Vlerësimi i drejtpërdrejtë dhe i pandërprerë, ndjekja e vazhdueshme e arritjeve të nxënësve;
- Vlerësimi indirekt, me anë të testeve;
- Vlerësimi nga nxënësit, gjatë punës në grupe ose gjatë përgjigjeve që japin, kur nxënësit plotësojnë njëri-tjetrin dhe vlerësojnë mbi bazë të argumenteve;
- Vetëvlerësimi.

Theks të veçantë gjatë vlerësimit në vazhdimësi duhet t'i kushtohet komunikimit, të shprehurit gojor, përmes ndërveprimit si dhe të shprehurit me shkrim.

10. Materialet dhe burimet mësimore

Për arritjen e kompetencave në fushën mësimore Gjuhët dhe komunikimi është i rëndësishëm përdorimi i materialeve dhe i burimeve të ndryshme mësimore për mësimdhënie dhe nxënie. Për realizimin e rezultateve të fushës dhe për arritjen e suksesshme të rezultateve për shkallë të Kurrikulës, të gjitha mjetet dhe materialet mësimore duhet t'u përmbahen kërkesave të këtyre rezultateve për fushë dhe shkallë. Tekstet shkollore janë vetëm disa nga burimet për marrjen informacionit, por nuk duhet të ketë kufizime vetëm në përdorimin e teksteve si burim, duhet të shfrytëzohen edhe burime të tjera, si dhe teknologjia informative. Informacionet mund të merren nga çdo burim, i cili ndihmon arritjen e rezultateve për kompetenca.

Fusha kurrikulare - Artet

Hyrje

Arsyeshmëria dhe përshkrimi

Konceptet dhe përshkrimi

Qasja e bazuar në kompetenca

Rezultatet e të nxënit të fushës

Çështjet ndërkurrikulare

Ndarja e kohës – përshkrimi

Udhëzime metodologjike

Udhëzime për vlerësim

Materialet dhe burimet mësimore

1.Hyrje

Fusha e Kurrikulës Artet përfshin artin figurativ dhe artin muzikor, si fushë e obligueshme e Kurrikulës Bërthamë të nivelit të tretë të arsimit në Republikën e Kosovës, me emërtimin Art muzikor dhe Art figurativ. Edhe në këtë nivel, përmes Kurrikulës me zgjedhje mund të ofrohen përmbajtje nga artet performuese/skenike: dramë, vallëzim, arte aplikative (fotografi, dizajn etj.).

2.Arsyeshmëria dhe përshkrimi

Artet mundësojnë zhvillimin personal, intelektual dhe social të nxënësve duke inkurajuar kreativitetin, imagjinatën dhe duke zhvilluar aftësitë shprehëse artistike. Artet janë pjesë integrale e jetës dhe përfshijnë aspektet materiale, shpirtërore, intelektuale dhe emocionale të ndërveprimit mes kulturës dhe shoqërisë.

Kultura, si një veprimtari më e gjerë, përveç formave të tjera, përfshin edhe artin popullor dhe artin e krijuar dhe manifestohet përmes elementeve nga trashëgimia kulturore kombëtare; sjelljet, mënyra e jetesës, sistemi i vlerave shoqërore në kontekstin historik dhe në ndërveprim me kulturat e popujve të tjerë në rajon dhe më gjerë.

Edukimi përmes arteve mundëson zhvillimin e qytetarit aktiv dhe kreativ, që:

- Krijon, formëson dhe merr pjesë në mënyrë aktive në ngritjen e kualitetit të jetës së tij dhe mjedisit ku jeton.
- Merr pjesë në ndërveprimin social, kulturor dhe intelektual të grupeve të ndryshme etnike, kulturore, duke vënë në rend të parë aspektin njerëzor të këtij ndërveprimi.
- Posedon shkathhtësitë dhe aftësitë themelore teknike që janë të rëndësishme për punë dhe jetë.
- Kupton dhe ndikon në zhvillimet komplekse në ambientin jetësor.

Duke u nisur nga fakti se Artet kontribuojnë në të gjitha këto aspekte, ato zhvillojnë intuitën, imagjinatën, kreativitetin, guximin, shkathtësitë intelektuale të shkallës së lartë (siç janë aftësia për gjykim dhe vlerësim), ndjeshmërinë ndaj formave të ndryshme të shprehjes dhe komunikimit artistik, por edhe përdorimin vetjak të tyre. Artet po ashtu kontribuojnë në zhvillimin e vetëbesimit, durimit, përgjegjësisë ndaj punës së përbashkët bashkëpunimit, vetëdisiplinës, entuziazmit dhe një varg cilësish të rëndësishme të një personaliteti në formim që synon të jetë i edukuar, i arsimuar dhe i kulturuar.

3. Konceptet dhe përshkrimi

Fusha kurrikulare Artet kryesisht synon të përmbushë dy aspekte themelore:

- Zhvillimin e shkathtësive (praktike) artistike për forma të ndryshme të shprehurit artistik sipas prirjeve dhe dispozitave individuale.
- Edukimin estetik, kultivimin e shijes për të bukurën në forma, gjini dhe zhanre të ndryshme krijuese/artistike dhe për qëndrim pozitiv ndaj artit dhe së bukurës në art, përmes të kuptuarit të zhvillimit të artit, në kontekste të ndryshme shoqërore e historike.

I. VLERAT DHE QËNDRIMET QË PROMOVOHEN PËRMES ARTEVE

- | | |
|--|---|
| <ul style="list-style-type: none"> • Bashkëpunimi • Respektimi i mendimit të tjerëve • Vëmendja • Puna e pavarur • Vullneti dhe motivacioni • Iniciativa dhe interesi • Imagjinata dhe kreativiteti • Respektimi për veten dhe te tjerët • Qëndrimi pozitiv ndaj artit dhe së bukurës | <ul style="list-style-type: none"> • Qëndrimi pozitiv ndaj trashëgimisë kulturore kombëtare • Qëndrimi pozitiv dhe respekti ndaj kulturave të ndryshme • Bashkëpunimi dhe përgjegjësia • Përqendrimi dhe durimi • Motivacioni për komunikim artistik dhe prezantime publike • Përgjegjësia • Përdorimi i TIK-ut • Etika dhe sensi kritik • Formimi kulturo |
|--|---|

SHKATHTËSITË QË ZHVILLOHEN PËRMES ARTEVE

- Të vërejturit/ të dëgjuarit
- Ndjenja për të vërejtur dhe për të dalluar ritëm dhe harmoni (tingujsh, ngjyrash, formash, lëvizjesh etj.)
- Shkathtësitë muzikore
- Shkathtësitë lëvizore
- Shkathtësitë shprehëse figurative
- Komunikimi artistik
- Shkathtësia për prezantim
- Kreativiteti
- Shkathtësia për punë ekipore
- Procedimi dhe të kuptuarit e informatave (tingëllore, vizuale, tekstuale, lëvizore etj.)
- Te menduarit analitik, kritik dhe kreativ
- Zgjidhja kreative e problemeve

KONCEPTET KRYESORE QË MËSOHEN PËRMES ARTEVE

- | | |
|--|---|
| <ul style="list-style-type: none"> • Tingulli • Vija • Ngjyra • Forma • Lëvizja • Ritmi • Melodia • Harmonia • Tonaliteti • Stili (baroku, romantizmi, klasicizmi etj.) • Zhanri (artistik, argëtues, popullor) • Instrumentet dhe formacionet muzikore • Trupi • Hapësira • Koha | <ul style="list-style-type: none"> • Energjia • Marrëdhënia • Roli/karakteri • Koha dhe vendi • Tensioni <p style="text-align: center;">Parimet</p> <ul style="list-style-type: none"> • Kontrasti • Përsëritja • Ndryshimi (variacioni) • Theksi • Ekuilibri • Tërësia |
|--|---|

4. Qasja e bazuar në kompetenca

Sipas Kornizës së Kurrikulës së Kosovës, kompetencat përfshijnë një sistem të integruar dhe koherent të shkathtësive, shprehive, njohurive (dijeve) dhe qëndrimeve të nxënësve si arritje e të nxënësve për të cilën kontribuojnë të gjitha fushat kurrikulare.

Artet kontribuojnë në mënyrë të veçantë dhe me mjetet si dhe mënyrat shprehëse artistike në arritjen e gjashtë kompetencave kryesore: komunikues efektiv, mendimtar kreativ, nxënës i suksesshëm, kontribuues produktiv, individ i shëndoshë dhe qytetar i përgjegjshëm.

5. Rezultatet e të nxënësve të fushës

Rezultatet e të nxënësve në fushën kurrikulare shtrihen brenda këtyre dimensioneve kryesore:

krijimtaria, performanca dhe prezantimi artistik.

Përmes arteve nxënësit inkurajohen të:

- përjetojnë veprat e ndryshme artistike,
- performojnë (marrin pjesë) në aktivitetet artistike individualisht ose në grup sipas prirjeve, dispozitave dhe interesave të tyre.
- krijojnë tërësi të reja me mjete të ndryshme shprehëse artistike, duke përdorur idetë e tyre personale dhe origjinale,
- prezantojnë lirshëm idetë e tyre vetjake artistike,
- interpretojnë idetë artistike të krijimeve të tjerëve.

Mjetet shprehëse, teknikat dhe proceset

Nxënësit: njohin, kuptojnë dhe përdorin në mënyrë efektive dhe të vetëdijshme teknikat e mjeteve shprehëse të arteve të ndryshme, si: fjalët, tingujt, ngjyrat, format, lëvizjen etj. për komunikim dhe për të shprehur artistik.

Aplikojnë teknikat shprehëse dhe proceset e ndryshme krijuese e performuese në forma, gjini dhe zhanre të ndryshme artistike.

Komunikimi dhe të shprehurit (artistik)

Nxënësit inkurajohen dhe aftësohen që të:

- përdorin njohuritë dhe shkathtësitë e fituara për t'u shprehur në mënyrë artistike, të lirë dhe të pavarur,
- përdorin mjetet shprehëse të arteve të ndryshme për t'u shprehur në mënyrë artistike mbi temat që i preokupojnë,
- reflektojnë dhe vlerësojnë aktivitetet vetjake dhe të tjerëve në format e ndryshme të shprehjes artistike.

Relacioni art - shoqëri

Nxënësit:

- njohin, kuptojnë dhe vlerësojnë rolin e ndërveprimit art-shoqëri në kontekstet e ndryshme historike, shoqërore, kulturore etj.,
- njohin vepra dhe autorë më të rëndësishëm të krijimtarisë artistike në nivele të ndryshme (kombëtare, ndërkulturore dhe në nivelin global).

REZULTATET E TË NXËNIT PER SHKALLËT 5 DHE 6

Shkalla 5
Klasa X, XI

Shkalla 6
Klasa XII

1. INTERPRETOJNË, KRIJOJNË DHE PREZANTOJNË

	Nxënësit demonstrojnë aftësi për të sintetizuar shkathtësitë, mediumet (mjetet shprehëse) dhe teknikat përkatëse për interpretim, krijim dhe prezantim në artin muzikor, në artet pamore, në artin dramatik dhe në vallëzim.	
Interpretimi	Interpretojnë pjesë (këngë, valle, pjesë teatrale) të formave, gjinive dhe zhanreve të ndryshme muzikore, duke aplikuar teknika më të avancuara interpretuese dhe duke kombinuar teknikat interpretuese në disiplinat e ndryshme artistike.	Interpretojnë individualisht dhe në grup, duke zbatuar teknika të kombinuara të interpretimit artistik, në përputhje me karakterin shprehës dhe stilistik të veprës dhe zhanrit artistik përkatës (muzikë, dramë, vallëzim, prezantime sinkretike dhe multimediale etj.).
Krijimi	Krijojnë ritme, melodi, këngë e pjesë muzikore instrumentale më komplekse dhe për situata e audiencë të ndryshme duke përdorur zërin, instrumentet muzikore, por dhe kompjuterin. Shfaqin shkathtësi kreative në realizimin e rolit dhe lojës teatrale brenda kontekstit të ngjarjes. Krijojnë punime me teknika dhe material të ndryshme në kompozicione me tema më abstrakte, por dhe aplikative (peizazh, simbole, posterë etj.). Aplikojnë lëvizje të koordinuara dhe artistike në përputhje me idenë, mesazhin dhe karakterin e valles, lojës.	Krijojnë vepra (muzikore, figurative, dramë/lojë teatrale dhe vallëzim) për situata të ndryshme, duke përdorur edhe teknologjinë dhe medime të ndryshme dhe duke manipuluar në mënyrë të vetëdijshme me elementet shprehëse artistike përkatëse. Kuptojnë dhe aplikojnë në mënyrë të vetëdijshme teknika të kombinuara për kompozicionin/ realizimin e veprave të ndryshme artistike (këngë, pjesë muzikore, dramë, valle/koreografi) brenda temave/ situatave të caktuara.
Prezantimi	Prezantojnë aftësitë e tyre interpretuese dhe krijuese në klasë dhe para publikut të njohur me vetëbesim dhe siguri.	Prezantojnë krijimet e tyre artistike edhe para një publiku më të gjerë, duke demonstruar vetëbesim, siguri dhe të hapur për vlerësime kritike dhe reflektim të punës së tyre krijuese/interpretuese.

2. PROCESET, TEKNIKAT DHE MJETET SHPREHËSE

Nxënësit njohin elementet (mjetet, format) dhe kuptojnë proceset dhe teknikat themelore të krijimtarisë artistike në muzikë, arte pamore, art dramatik dhe në vallëzim.

	<ul style="list-style-type: none"> Zbatojnë përdorimin e elementeve muzikore, teknikave dhe proceseve krijuese për interpretimin artistik dhe krijimet e tyre muzikore. Analizojnë strukturën e shfaqjeve nga tradita të ndryshme, në periudha të ndryshme historike. Analizojnë dhe vlerësojnë kryeveprat artistike të kulturave të ndryshme duke identifikuar elementet, teknikat dhe proceset e përdorura. 	<ul style="list-style-type: none"> Sintetizojnë njohuritë e tyre mbi elementet, proceset dhe teknikat interpretuese dhe krijuese muzikore duke i përdorur ato në mënyrë të vetëdijshme në krijimet e tyre vetjake. Dallojnë aplikimet e inovacioneve në elemente shprehëse dhe teknika krijuese në veprat e ndryshme artistike.
--	--	---

3. TË SHPREHURIT DHE KOMUNIKIMI ARTISTIK

Nxënësit demonstrojnë aftësi për të përdorur mjete të ndryshme shprehëse të arteve (zërin, instrumentet, ngjyrat, format, fjalët, lëvizjen etj.) për të komunikuar dhe për të shprehur përjetimet dhe idetë e tyre.

	Komunikojnë me mjetet shprehëse artistike përkatëse (muzikë, dramë, vallëzim dhe arte vizuale) në mënyrë të përshtatshme për audiencë të ndryshme (kolegë, prindër, fëmijë të tjerë, publik më i gjerë etj.).	Komunikojnë me vetëbesim dhe siguri para audiencave të ndryshme, duke kombinuar format dhe mjetet shprehëse të arteve edhe me ndihmën e teknologjisë (prezantime multimediale, instalacione etj.).
--	---	--

4. TË KUPTUARIT E RELACIONIT ART- SHOQËRI

Nxënësit kuptojnë rolin, zhvillimin dhe ndikimin e artit në shoqëri dhe anasjelltas në kontekstin historik, social dhe kulturor.

- | | |
|---|--|
| <ul style="list-style-type: none"> • Kuptojnë përdorimin e inovacionit në arte në periudha të ndryshme historike dhe ndikimin në normat dhe vlerat shoqërore. • Përcaktojnë ndikimin e kontributit të individëve të shquar në artet e ndryshme të kulturave të ndryshme përgjatë historisë. | <ul style="list-style-type: none"> • Kuptojnë dhe dallojnë krijimet artistike të së kaluarës dhe ato moderne që përfaqësojnë ide, çështje, ngjarje me rëndësi për shoqëritë dhe kulturat në periudha të ndryshme. |
|---|--|

5. PËRJETIMI DHE VLERËSIMI ESTETIK

Nxënësit aplikojnë gjykim dhe vlerësim kritik të veprave artistike në muzikë, arte pamore, art dramatik dhe vallëzim, duke u bazuar në të kuptuarit e filozofisë së artit dhe parimet estetike.

- | | |
|---|---|
| <p>Demonstrojnë të kuptuarit se si artet komunikojnë ide përmes vlerave personale dhe shoqërore të inspiruara nga imagjinata individuale dhe konteksti historik, kulturor dhe social i krijuesit.</p> | <p>Interpretojnë dhe identifikojnë simbolizmat dhe metaforat e përdorura në veprat artistike të kulturave dhe periudhave të ndryshme historike.</p> |
|---|---|

6. Vetëdijesimi për identitetin personal dhe kolektiv

Kultivojnë identitetin(tet) përkatës(e): (individual, grupor, social, kulturor) (kombëtar, rajonal, evropian dhe global) përmes arteve.

Nxënësit dallojnë format e ndryshme artistike, ngjashmëritë dhe dallimet që rrjedhin nga përkatësia në familje, komunitet, kulturë kombëtare dhe më gjerë.

- | | |
|---|---|
| <p>Identifikojnë materiale nga kulturat e ndryshme dhe i përdorin ato në krijimet e tyre.</p> | <p>Përmes formave shprehëse artistike në muzikë, vallëzim, dramë dhe arte pamore komunikojnë ide, emocione dhe mesazhe që lidhen me çështjet aktuale politike, sociale kulturore në nivelin kombëtar dhe global si (antidiskriminimi, antiracizmi, paqja etj.).</p> |
|---|---|

VII. Vlerat dhe qëndrimet që promovohen përmes arteve

- Bashkëpunimi
- Respektimi i mendimit të tjerëve.
- Vëmendja
- Puna e pavarur
- Vullneti dhe motivacioni
- Iniciativa dhe interesi
- Imagjinata dhe kreativiteti
- Respektimi për veten dhe për të tjerët
- Qëndrimi pozitiv ndaj artit dhe së bukurës
- Qëndrimi pozitiv ndaj trashëgimisë kulturore kombëtare
- Qëndrimi pozitiv dhe respekti ndaj kulturave të ndryshme
- Bashkëpunimi dhe përgjegjësia
- Përqëndrimi dhe durimi
- Motivacioni për komunikim artistik dhe prezantime publike
- Përgjegjësia
- Përdorimi i TIK-ut
- Etika dhe sensi kritik
- Formimi kulturor

7. Shkathësitë që zhvillohen përmes arteve

- Të vërejturit/të dëgjuarit
- Ndjenja për të vërejtur dhe për të dalluar ritëm dhe harmoni (tingujsh, ngjyrash, formash, lëvizjesh etj.)
- Shkathësitë muzikore
- Shkathësitë lëvizore
- Shkathësitë shprehëse figurative
- Komunikimi artistik
- Shkathësia për prezantim
- Kreativiteti
- Vetëbesimi
- Përgjegjësia dhe bashkëpunimi
- Puna ekipore
- Procedimi dhe të kuptuarit e informatave (tingëllore, vizuale, tekstuale, lëvizore etj.)
- Te menduarit analitik, kritik dhe kreativ
- Zgjidhja kreative e problemeve

8. Konceptet kryesore që mësohen përmes arteve

<ul style="list-style-type: none"> • Tingulli • Vija • Ngjyra • Forma • Lëvizja • Ritmi • Melodia • Harmonia • Tonaliteti • Stili • Zhanri • Instrumentet dhe formacionet muzikore • Trupi • Hapësira • Koha • Energjia • Marrëdhënia • Roli/karakteri • Koha dhe vendi • Tensioni 	<p>Parimet</p> <ul style="list-style-type: none"> • Kontrasti • Përsëritja • Ndryshimi (variacioni) • Theksi • Ekuilibri • Tërësia
--	---

6.Çështjet ndërkurrikulare

Artet ndërveprojnë mes vete, andaj edhe në procesin mësimor mund të ndërliidhen format e ndryshme të të shprehurit artistik, p.sh. kënga me lëvizjen dhe vallëzimin, muzika dhe shprehja figurative, muzika dhe shprehja letrare, shprehja figurative me shprehjen letrare, performanca artistike, sinkretike etj. Në këtë nivel mund të aplikohet sidomos qasja e integruar e kombinimit të shprehjeve artistike për temat e ndryshme. Artet mund të ndërliidhen edhe me fushat e tjera kurrikulare. Ndërliidhja e gjuhës (amtare dhe të huaj) me muzikën mund të jetë shumë e suksesshme. Po ashtu, edhe shprehja figurative, e cila e vizualizon shprehjen gjuhësore (shkrimi, simbolet, figurat, ilustrimet etj.), ndërliidhet me gjuhën.

Artet mund të ndërliidhen suksesshëm edhe me lëndët e fushës kurrikulare shkencat (natyrore dhe shoqërore) matematika, shëndeti dhe mirëqenia, jeta dhe puna etj.

Çdo tematikë e veçantë dhe përmbajtje mësimore që përpunohet në këtë nivel bëhet më e qartë dhe e kup-tueshme kur shoqërohet me shprehje artistike (ilustrimet, grafikat, hartat, kënga, muzika, vallëzimet, videokli-pi etj.).

7.Ndarja e kohës - përshkrimi

Sipas Kornizës së Kurrikulës së Kosovës, në planin mësimor për nivelin e tretë janë paraparë 3 orë mësimore në javë nga fusha kurrikulare Artet për Gjimnazin e shkencave natyrore.

Në shkallën e tretë të Kurrikulës, (kl. X, XI dhe XII) janë gjithsej 6 orë mësimore në javë të planifikuara nga 2 orë për secilën klasë.

Meqë këtë fushë e përbëjnë dy lëndët e obligueshme – edukatë figurative dhe edukatë muzikore, atëherë orët ndahen në mënyrë të barabartë mes këtyre dy lëndëve.

Shkolla e mesme e lartë (SNKA 3) Gjimnazi i shkencave natyrore						
Fushat kurrikulare	Shk.5				Shk.6	
	Klasa X	Klasa XI	Gjithsej orë		Klasa XII	
	Nr. orëve	Nr. orëve	Gj. Orë	%	Gj. Orë	%
Artet - Edukatë muzikore - Edukatë figurative	1	1	2	3.33	1	3.13

Shkolla e mesme e lartë (SNKA 3) - Gjimnazi Shoqëror Gjuhësor						
Fushat kurrikulare	Shk.5				Shk.6	
	Klasa X	Klasa XI	Gjithsej orë		Klasa XII	
	Nr. orëve	Nr. orëve	Gj. Orë	%	Gj. Orë	%
Artet - Edukatë muzikore - Edukatë figurative	2	2	4	6.67	2	6.25

8.Udhëzime metodologjike

Artet edukojnë në mënyrë të suksesshme vetëm kur aplikohet me saktësinë më të madhe metodologjia speciale përkatëse e mësimdhënies dhe e nxënies artistike në secilën lëndë artistike. Metodika e mësimdhënies në lëndët artistike përfshin teknikat mësimore dhe metodat specifike të mësimimit të koncepteve, shkathtësive dhe njohurive që duhen fituar. Në këtë nivel përdoret mësimdhënia me qasje konstruktive të të nxënimit me ç'rast nxënësit aftësohen që të kuptojnë ndikimin e rrethanave të ndryshme shoqërore historike në periudha e vende të ndryshme në zhvillimin e disiplinave të ndryshme artistike përmes analizës dhe vrojtimit të artefakteve artistike (veprat muzikore për dëgjim, fotot e pikturave, të skulpturave etj., fotografitë, videomaterialet filmike, dokumentarët dhe vizitat mësimore në koncerte, ekspozita, shfaqje teatrale, balet etj.) Përjetimi artistik, kërkëshëria, imagjinata dhe liria e të shprehurit mbeten parimet kryesore të metodologjisë së mësimdhënies në fushën e arteve.

9.Udhëzime për vlerësim

Vlerësimi në fushën kurrikulare të artit kërkon kujdes të veçantë dhe mbështetet në parimin e individualizimit, ngase çdo nxënës ka predispozita dhe prirje të ndryshme për format e ndryshme të shprehjes artistike. Andaj, në vlerësim duhet të përfshihen: kuraja, imagjinata, shprehja origjinale dhe kreative, interesimi, përjetimi artistik, interpretimi etj. Arritjet në fushën e artit janë individuale, andaj edhe duhet të vlerësohen si të tilla, duke shfrytëzuar vlerësimin për motivim dhe inkurajim të zhvillimit të aftësive të tyre krijuese.

Në art duhet të vlerësohet interesimi dhe pjesëmarrja aktive (individuale dhe në grup) në aktivitetet artistike të ndryshme, që organizohen në shkollë dhe në komunitet.

Në këtë nivel, meqë një pjesë të madhe të përmbajtjeve e përbëjnë edhe temat të ndërlidhura me zhvillimin historik të arteve në kontekste të ndryshme shoqërore e historike, ka hapësirë edhe për forma të tjera të vlerësimit të njohurive dhe të të kuptuarit të këtyre konteksteve (ese me shkrim, teste njohurish e konceptesh, prezantime me poëerpoint mbi stilet e ndryshme artistike në periudha të ndryshme historike, harta, posterë, videoinstalacione e performanca të ndryshme).

10. Materialet dhe burimet mësimore

Artet kanë mjetet e tyre shprehëse, teknikat dhe procedurat specifike që kushtëzojnë përdorimin e materialeve të ndryshme për realizimin e përmbajtjeve nga kjo fushë kurrikulare. P.sh., në artin figurativ materiali mësimor përkon me materialin e punës, si: letra, pëlhura, plastelina, materiali organik. Përpos materialeve, shfrytëzohen edhe burime mësimore, si: teksti shkollor, fotografitë, videoja, interneti etj.

Në artin muzikor materiali kryesor është vetë tingulli muzikor që prodhohet nga zëri i njeriut ose nga instrumentet muzikore. Burimet mësimore përfshijnë edhe tekstin shkollor dhe burimet tingëllore (CD-të përkatëse, CD-të muzikore, DVD-të, incizimet nga interneti, TV-të, koncertet publike etj.). Në këtë nivel me mjaft sukses mund të përdoret edhe teknologjia bashkëkohore për riprodhimin, por edhe krijimin e muzikës (programet e ndryshme muzikore kompjuterike, studiot muzikore etj.).

Fusha kurrikulare - Matematikë

Hyrje

Arsyeshmëria dhe përshkrimi

Konceptet dhe përshkrimi

Qasja e bazuar në kompetenca

Rezultatet e të nxënit të fushës

Çështjet ndërkurrikulare

Ndarja e kohës – përshkrimi

Udhëzime metodologjike

Udhëzime për vlerësim

Materialet dhe burimet mësimore

1. Hyrje

Kurrikula e fushës së matematikës reflekton në politikat arsimore të vendit, që do të ketë ndikim në ngritjen e cilësisë në matematikë dhe në arsim në përgjithësi. Kurrikula e fushës së matematikës paraqet një të drejtë statutore për mësimin e matematikës për të gjithë nxënësit. Ajo paraqet kompetencat se çka do të mësohet dhe përcakton rrugën e arritjeve kryesore të mësimin të matematikës. Po ashtu, Kurrikula paraqet se si do të vlerësohet dhe do të raportohet performanca e nxënësve. Prandaj, Kurrikula nxënësve, mësuesve, prindërve dhe komunitetit të gjerë u jep një pasqyrë të qartë të të kuptuarit dhe të aftësive që nxënësit duhet t'i përvetësojnë në shkollë. Kjo Kurrikulë shkollave u lejon që të plotësojnë nevojat individuale të nxënësve dhe të zhvillojnë një karakter të dallueshëm dhe tipare karakteristike rrënjësore në komunitetin e tyre. Ajo, po ashtu paraqet një model sipas të cilit të gjithë partnerët në edukim mund të përkrahin nxënësit në rrugën e mëtutjeshme të mësuarit. Kurrikula në vete paraqet një zgjedhje të vështirë dhe të balancuar, është mjaft e fortë dhe e qëndrueshme për të mbrojtur dijen dhe përvojën kulturore, e cila është e drejtë e çdo nxënësi dhe në të njëjtën kohë duhet të jetë mjaft fleksibile për t'u mundësuar mësuesve që të arrijnë të ndërtojnë metodën e tyre të të mësuarit në atë mënyrë që atë ta përcjellin drejt te nxënësit e tyre.

Kurrikula e fushës së matematikës nxënësve u mundëson që të zhvillojnë aftësitë thelbësore në matematikë, që t'i përvetësojnë ato, t'u paraqitet atyre e drejta e garantuar dhe e plotë për mësim dhe të kujdeset për kreativitetin e tyre.

Mësuesve t'u japë të drejtën që të gjejnë mënyrën më të mirë të mundshme, për të inspiruar nxënësit e tyre për të mësuar.

Përmbajtja e dokumentit do të jetë në harmoni me parimet e përcaktuara në Kornizën e Kurrikulës. Ajo paraqet

kërkesat legale të Kurrikulës për matematikën dhe ofron informata për të ndihmuar nxënësit që të jenë kompetentë mbi atë që mësohet.

Kryesisht renditja është e bazuar sipas hierarkisë së shkallëve dhe niveleve. Kurrikula për nxënësit e nivelit I (klasa 0-V) është paraqitur për mësuesit e shkollave fillore. Kurrikula për nxënësit e nivelit II (klasa VI-IX) është paraqitur për mësuesit e shkollave të mesme të ulëta. Kurrikula për nxënësit e nivelit të tretë (klasa X-XII) është paraqitur për mësuesit e shkollave të mesme të larta për:

- a. drejtimet e gjimnazeve dhe
- b. arsimin profesional dhe shkollat artistike.

2. Arsyeshmëria dhe përshkrimi

Matematika mundëson zhvillimin e shkathtësive dhe aftësive të nxënësve për të menduar në mënyrë kritike zhvillimin e personalitetit të tyre, zhvillimin e shkathtësive për të punuar në mënyrë të pavarur dhe sistematike, nxitjen dhe inkurajimin për zbulim, ndërtimin e njohurive të reja me qëllim të zbatimit dhe integritit të tyre në fushat e tjera dhe zgjidhjen e situatave problemore në jetën e përditshme.

Matematika, përmes rezultateve të pritshme dhe atyre thelbësore, ka në konsideratë të mësuarit në fusha, si shpirtërore, morale, sociale dhe kulturore, si dhe aftësitë kryesore dhe aftësitë e të menduarit.

3. Konceptet dhe përshkrimi

Në matematikë kryesisht janë këto koncepte:

- Numrat realë dhe kompleksë
- Format
- Hapësira
- Matjet
- Algjebra
- Analiza matematike
- Gjeometria
- Gjeometria analitike
- Statistika
- Kombinatorika
- Trigonometria

Matematika mësohet në të gjitha shkallët e Kurrikulës. Në shkallën e parë dhe të dytë bëhet një lidhje e njohurive për numrat, figurat gjeometrike, pozitën në hapësirë, matjet dhe shkathtësitë për llogaritje të zgjidhjeve të problemeve.

Në shkallën e tretë dhe të katërt kjo lidhje integrohet me njohuritë nga algjebra, gjeometria dhe statistika, kurse në shkallën e pestë dhe të gjashtë sigurohet një zgjerim dhe thellim i njohurive edhe nga trigonometria, analiza matematike dhe probabiliteti.

Përshkrimi i nivelit ofron bazat e marrjes së vendimeve për performancën e nxënësve në fund të çdo shkalle kryesore 1-6 dhe për tri nivelet.

4. Qasja e bazuar në kompetenca

Sipas KKK-së, të mësuarit është i bazuar në kompetenca. Organizimi i mësimin përqendrohet në atë që duhet të dinë dhe që duhet të jenë të gatshëm të bëjnë nxënësit. Për të bërë diçka, duhen njohuri, shprehje, shkathtësi përkatëse, por edhe qëndrime të caktuara. Bazuar në këtë, Kurrikula e matematikës është e konceptuar në një sistem të ndërtuar me bazë niveli, shkallë dhe klase, që justifikohet me rezultate të përgjithshme të të nxënësve për fushë dhe shkallë, andaj kemi tri nivele kompetencash, përmbushja e të cilave u referohet aspekteve më të rëndësishme të mësimdhënies, ndërsa janë të orientuara e të renditura sipas nevojave reale të nxënësve për të cilat nevojitet planifikim kohor dhe trajnues të përgatitur.

Qasja e bazuar në kompetenca për fushën e matematikës arrihet përmes metodave rekomanduese: shtjellim

bashkëbisedim, dhënie dhe ilustrim shembujsh, dhënie udhëzimesh, prezantim i zgjidhjeve, prezantimi i pu nës në grupe, praktikim i mbikëqyrur i grupeve të nxënësve, diskutim në grup, praktikë. Rezultatet thelbësore mësimore në matematikë janë bazuar në këto tetë kompetenca matematikore:

1. Zgjidhja e problemeve matematike
2. Arsyetimi dhe vërtetimet matematike
3. Komunikimi matematik
4. Lidhjet në matematikë
5. Përfaqësimi matematik
6. Modelimi matematik
7. Të menduarit matematik
8. Përdorimi i teknologjisë në matematikë

5. Rezultatet e të nxënit të fushës

REZULTATET E TË NXËNIT PËR SHKALLËT 5 DHE 6

Shkalla 5
Klasa X, XI

Shkalla 6
Klasa XII

Njohuritë, të kuptuarit dhe shkathësitë që zhvillohen përmes përvojave mësimore që ndërlidhen me:

1. Zgjidhjen e problemeve
2. Arsyetimet dhe vërtetimet matematike
3. Komunikimin në/përmes matematikës
4. Lidhjen matematike
5. Përfaqësimeve matematike
6. Promovimin e modelimit matematik
7. Strukturimin e të menduarit matematik
8. Përdorimin e TIK-ut në/për matematikë

1. Zgjidhja e problemeve

Përzgjedh strategji të përshtatshme nga algjebra dhe nga gjeometria për të zgjidhur probleme që zbatohen në situata të përditshme jetësore.

Planifikon, formulon, monitoron dhe reflekton mbi proceset e strategjive të zgjidhjes së problemeve më komplekse në matematikë dhe në fusha të ndryshme nga jeta e përditshme.

2. Arsyetimet dhe vërtetimet matematike

Përzgjedh strategji të përshtatshme nga algjebra dhe nga gjeometria për të zgjidhur probleme që zbatohen në situata të përditshme jetësore.

Planifikon, formulon, monitoron dhe reflekton mbi proceset e strategjive të zgjidhjes së problemeve më komplekse në matematikë dhe në fusha të ndryshme nga jeta e përditshme.

Vërteton teorema duke përdorur koncepte matematike dhe jo matematike.

Vlerëson arsyetimet matematike; vërteton dhe arsyeton pohime komplekse matematike duke përdorur zgjidhje të ndryshme.

3. Komunikimi në/përmes matematikës

Përdor tipa të ndryshëm të diskursit matematik ("forma të të shprehurit") duke përdorur gjuhën natyrore dhe matematikore (p.sh., grafikët, diagramet), formulon hipoteza, përkufizon, arsyeton, nxjerr konkludime relevante.

Vlerëson gojarisht ose me shkrim idetë në grup; shpreh mendimin personal mbi konceptet e matematikës; thekson se deri në ç'masë ato zbatohen në jetën e përditshme.

4. Lidhja matematike

Bën lidhjen mes numrave dhe koncepteve algjebrike, gjeometrike dhe trigonometrike në situata praktike.

Vlerëson lidhshmërinë e përmbajtjes së matematikës me fushat e tjera, përdor informatat e grumbulluara për zgjidhjen e problemeve nga jeta e përditshme.

5. Përfaqësimet matematike

Ndërton forma ekuivalente të përfaqësimit të modeleve dhe koncepteve për të interpretuar fenomenet sociale, natyrore dhe matematikore.

Përdor përfaqësimet matematike dhe definon marrëdhëniet midis tyre.

6. Modelimi matematik

Ndërton modele të reja dhe përdor metoda algoritmike matematike (p.sh., për të analizuar të dhënat, për të kryer matje të ndryshme etj.).

Zbaton modele të shumëllojshme matematike, brenda dhe jashtë matematikës.

7. Të menduarit matematik

Me zbatimin e saj në fushat jashtë matematikës, bën strukturimin e të menduarit matematik, duke komunikuar në mënyrë koherente dhe të qartë.

Përdor në mënyrë efektive të menduarit matematik për arsyetime, argumentime dhe paraqitjen e qartë të problemeve matematikore, të zbatueshme në jetën e përditshme.

8. Përdorimi i TIK-ut në/për matematikë

Përdor programe softuerike të përshtatshme (p.sh., tabelat në Excel) për njehsime të ndryshme në matematikë; identifikon përparësitë dhe kufizimet e përdorimit të teknologjisë moderne dhe TIK në matematikë.

Përdor programe të avancuara softuerike për llogaritje dhe modelime matematikore të problemeve në shkallë më të lartë të vështirësisë.

VII. VLERAT DHE QËNDRIMET

- Insistimi, këmbëngulja dhe fuqia në fokusimin e problemeve
- Shpirti i objektivitetit dhe paanësisë
- Estetika dhe sensi kritik, të çmuarit e rigorozitetit, renditjes dhe elegancës në arkitekturën e zgjidhjes së problemeve dhe ndërtimit të teorive
- Shprehitë për të përdorur konceptet matematike në metodat në qasjen e situatave të përditshme ose në zgjidhjen e çështjeve praktike
- Qëndrim aktiv në ide të përbashkëta, diskutim dhe debatim
- I hapur për të kërkuar dhe për të ofruar përkrahje
- Respektimi i mendimit të tjerëve
- Formimi human dhe zhvillimi i personalitetit dhe proporcioni kulturor
- I vëmendshëm për rolin e matematikës në modelimin e mendjes njerëzore
- I vëmendshëm për rolin e matematikës në zhvillimin modern të shoqërisë

III. Aftësitë dhe shkathhtësitë matematike

- Identifikim
- Përshkrim
- Formulim
- Arsyetim
- Zbatim
- Njehsime
- Matje
- Skicime
- Krijim modelesh
- Ndërtim
- Përdorim burimesh dhe informacionesh

IV. Njohuritë dhe konceptet që promovohen nga fusha e matematikës (aritmetika, algjebra, matja, gjeometria, statistika, probabiliteti)

- Numrat realë dhe kompleksë
- Format
- Hapësira
- Matjet
- Algjebra
- Analiza matematike
- Gjeometria
- Gjeometria analitike
- Statistika
- Kombinatorika
- Trigonometria
- Teoria e numrave
- Matematika financiare

6.Çështjet ndërkurrikulare

Mësimi i matematikës do të përqendrohet në shkathtësitë themelore me numra, objekte e figura në zhvillimin e arsyeshmërisë dhe zgjidhjes së problemeve duke i përdorur metodat matematikore.

Matematika dhe mësimdhënia e saj do të ketë parasysh çështjet ndërkurrikulare të paraqitura më poshtë:

- Zhvillim personal dhe shkathtësi për jetë, puna në ekip, zgjidhje të problemeve, vendimmarrje, planifikim të buxhetit personal.
- Zhvillim i qëndrueshëm, vetëdije ekonomike, shkathtësi gjuhësore dhe të komunikimit, mësimin elektronik (TIK), krijim i modeleve virtuale matematikore.
- Grumbullimi i të dhënave dhe paraqitja në graf.

7.Ndarja e kohës - përshkrimi

Plani mësimor specifikon numrin minimal dhe maksimal të orëve për çdo fushë mësimore për fushën matematikës është domosdoshmëri që të ketë një kohë më të madhe në dispozicion. Në nivelin e tretë, klasa (10-12) numri i orëve është i përcaktuar në KKK. Vlerësimi i rezultateve mësimore bëhet në përputhje me KKK.

Shkolla e mesme e lartë (SNKA 3) Gjinnazi i shkencave natyrore						
Fushat kurrikulare	Shk.5				Shk.6	
	Klasa X	Klasa XI	Gjithsej orë		Klasa XII	
	Nr. orëve	Nr. orëve	Gj. Orë	%	Gj. Orë	%
Matematika	4	4	8	13.33	4	12.50

Shkolla e mesme e lartë (SNKA 3) - Gjinnazi Shoqëror Gjuhësor						
Fushat kurrikulare	Shk.5				Shk.6	
	Klasa X	Klasa XI	Gjithsej orë		Klasa XII	
	Nr. orëve	Nr. orëve	Gj. Orë	%	Gj. Orë	%
Matematika	4	3	7	11.67	3	9.38

Tabela e orëve në arsimin profesional:

Shkolla e mesme e lartë (SNKA 3) Shkollat profesionale						
Fushat kurrikulare	Shk.5				Shk.6	
	Klasa X	Klasa XI	Gjithsej orë		Klasa XII	
	Nr. orëve	Nr. orëve	Gj. Orë	%	Gj. Orë	%
Matematika	3	3	6	9.38	3	9.38

8.Udhëzime metodologjike

Mësimdhënësi përdor metoda mësimore bashkëkohore ndërvepruese dhe gjithëpërfshirëse, teknika e forma të shumëllojta të punës dhe një kompleks të tërë procedurash (informacion i ri, përsëritje, përforsim, ushtrime, detyra, punë me projekte, mjete materiale, siç janë: vizatime, makete, diagrame, modele, grafikë dhe mjete të tjera teknike bashkëkohore – kompjuter, internet etj.). Këto metoda duhet të jenë në funksion të nxitjes së mendimit të pavarur, kritik e krijues.

Përzgjedhja e metodave është kompetencë e mësimdhënësit të lëndës. Ajo bëhet në përshtatje me nevojat dhe kërkesat e nxënësve, me natyrën e përmbajtjes së temës mësimore, me bazën didaktike, me nivelin e formimit të nxënësve etj.

Metodat dhe teknikat e punës me nxënës duhet të jenë të kombinuara dhe të shumëllojta, ngase nxënësi dinamikën e orës mësimore, thyejnë monotoninë dhe motivojnë nxënësit për mësim.

Metodat, teknikat dhe format e punës me nxënës duhet të jenë në funksion të përvetësimit më të lehtë të përmbajtjeve mësimore dhe të zbatimit më të shpejtë e më të saktë të njohurive, shprehive, shkathtësive, qëndrimeve dhe vlerave të tjera, që marrin pjesë në formimin e tërësisë së personalitetit të tyre për t'u ballafaquar me sfidat jetësore.

9.Udhëzime për vlerësim

Vlerësimi përfshin tërë veprimtarinë e cila shërben për të gjykuar mbi arritshmërinë e rezultateve të të nxënësit në nivel klase dhe shkolle të nxënësit si dhe zotërimin e kompetencave të fushës së matematikës.

Mësimdhënësi gjatë vlerësimit duhet të ketë parasysh përmbajtjen programore në arritjen e rezultateve mësimore dhe kompetencave të përcaktuara për këtë nivel, po ashtu, vlerësimin ai duhet ta konsiderojë si pjesë të pandashme të mësimin dhe t'i angazhojnë nxënësit në procesin mësimor dhe t'i aftësojë ata për punë të pavarur. Gjatë vlerësimit mësimdhënësi duhet të mbështet në një sasi të konsiderueshme të dhënash, ku përfshihen këto elemente:

- vlerësimi i përgjigjeve me gojë,
- vlerësimi i ndihmesës në grup,
- vlerësimi i aktivitetit gjatë debateve në klasë,
- vlerësimi i detyrave të shtëpisë,
- testet për një grup temash të caktuara,
- testet në fund të kategorisë së përmbajtjes,
- testet në fund të gjysmëvjetorit ose në fund të vitit mësimor.

Po ashtu, mësimdhënësi është i pavarur në zgjedhjen e:

- llojeve të vlerësimit (formativ, përmbledhës, diagnostikues, motivues etj.);
- metodave të vlerësimit (vetëvlerësimi, biseda me nxënës, dosja, vëzhgimi, projektet etj.);
- instrumenteve të vlerësimit (fleta për vetëvlerësim analitik, dritare koordinuese: di, dua të di dhe mësova), diagramet (plus +, minus -, interesant I), semafori, partner për biseda (shoku – me shokun) etj.).

Vlerësimi duhet të jetë në funksion të sigurimit të informatave kthyesë me qëllim të përmirësimit të të nxënësit motivimin e nxënësve për mësimnxënie, të përcaktojë shkaqet e ngecjes apo ato të përparimit, përmirësimit të mësimdhënies dhe në zhvillimin individual të nxënësit (Për më shumë, shih kapitullin V - për vlerësimin).

Kurrikula e bazuar në kompetenca përbëhet nga deklaratat se për çka do të jetë i aftë nxënësi me përfundimin e suksesshëm të një kategorie apo nënkategorie mësimore.

Këtyre deklaratave u referohen Rezultatet mësimore.

Vlerësimi sipas skemës së dhënë nga Kurrikula Bërthamë:

1	2	3	4	5	Përkrahje përmirësuese	Mënyrat	Përkrahje për të talentuarit	Mënyrat
Nxënësi nuk ka punuar fare ose ka punuar, por s'ka pasur të bëjë fare me detyrën	Nxënësi ka ide për të zgjidhur problemin, paraqet sistemin	Nxënësi, përveç idesë, arrin të një zgjidhje e pjesshme, p.sh. gjen vetëm x ose vetëm y	Nxënësi arrin të zgjidhja e plotë, por nuk verifikon zgjidhjen	Nxënësi bën zgjidhjen e plotë dhe verifikimin e zgjidhjes	Mësuesi vendos se si të përkrahë nxënësin, p.sh., si duhet të përdorë të panjohurat x dhe y dhe të parash-trojë sistemin e ekuacioneve	Çfarë metoda të aplikojë duke pasur parasysh stilin e të nxënët të nxënësit, p.sh., i tregon njërin nga metodat që nxënësi e ka më të përafërt për zgjidhjen e sistemeve të ekuacioneve	I jepet ndonjë detyrë shtëpie e posaçme	Çfarë metoda të aplikojë duke pasur parasysh stilin e të nxënët të nxënësit

10. Materialet dhe burimet mësimore

- Mësimdhënësi jep mësimin me një kuptueshmëri duke përdorur materiale dhe burime, të cilave nxënësit mund t'u qasen përmes të parit, të dëgjuarit, prekjes etj. Përdor fjalë dhe fjali të lehta, të sakta, njëkuptimore, për mjete vizuale, teknologji të nevojshme, bërje aktivitete, si: vizatime, modelime, jep ndihma të veçanta, adaptim shembujsh, krijim ambienti aktivitete alternative etj.
- Mësimdhënësi siguron qasje përmes përdorimit të teksteve dhe materialeve adekuate që përkon me moshën dhe mundësinë e nivelit të të mësuarit, ofron broshura të nevojshme, fjalorë, përdor gjuhë të pastër. Mësimdhënësi nxënësve u prezanton/sqaron përmbajtje të caktuara ose shkathtësi. Fokusi është në bartjen e informatave (gjithashtu videomateriale arsimore, prezantim nga ana e nxënësve);
- Demonstrim nga ana e mësimdhënësit ose nxënësit: Arsimitari jep informata vizuale, të cilat e ndihmojnë sqarimin gojor.

Fusha kurrikulare - Shkencat e natyrës

Hyrje

Arsyeshmëria dhe përshkrimi

Konceptet dhe përshkrimi

Qasja e bazuar në kompetenca

Rezultatet e të nxënit të fushës

Çështjet ndërkurrikulare

Ndarja e kohës – përshkrimi

Udhëzime metodologjike

Udhëzime për vlerësim

Materialet dhe burimet mësimore

1.Hyrje

Kurrikula Bërthamë e shkencave të natyrës është e obligueshme për të tri nivelet e arsimit parauniversitar. Kjo fushë mësimore përfshin realizimin e kompetencave (njohuritë, të kuptuarit, shprehitë, shkathtësitë, qëndrimet dhe vlerat) që do të arrihen nga nxënësit pas përfundimit të çdo niveli të arsimit parauniversitar.

Shkencat natyrore u mundësojnë nxënësve të njohin, të kuptojnë, të hulumtojnë natyrën, botën e gjallë e jo të gjallë dhe njeriun.

Njohuritë dhe arritjet shkencore zbatohen: në prodhimin e ushqimit dhe të mirave të tjera materiale, në mjekësi, në komunikacion, në komunikim, në prodhimin e energjisë, në hulumtimin dhe përdorimin e pasurive natyrore, në ruajtjen e mjedisit jetësor, në krijimtarinë kulturore, në art dhe në hulumtimin e gjithësisë.

2.Arsyeshmëria dhe përshkrimi i fushës së shkencave të natyrës

Shkencat e natyrës janë në funksion të:

- shpjegimit të botës materiale, vetitë dhe shndërrimet e saj;
- zbatimit të metodave të hulumtimit të dukurive dhe të proceseve natyrore;
- përshkrimit të tokës si trup qiellor, me kushte të përshtatshme për jetën e qenieve të gjalla dhe të njeriut;
- përshkrimit të botës së gjallë, botës jo të gjallë dhe lidhshmërinë mes tyre;
- përshkrimit të resurseve energjetike;
- shpjegimit të proceseve përmes katër bashkëveprimeve kryesore (të gravitetit, elektromagnetik, bërthamor i dobët dhe i fuqishëm);
- përshkrimit të proceseve natyrore në kohë dhe hapësirë;

- përcaktimit të ndërlidhjes së njeriut dhe natyrës dhe ndikimet e ndërsjella mes tyre;
- përdorimit të arritjeve shkencore në kimi, biologji, fizikë, astronomi për sqarimin dhe parashikimin e ngjarjeve dhe dukurive të reja.

3. Konceptet dhe përshkrimi

Konceptet themelore të shkencave të natyrës duhet të mbështeten në 6 shtylla kryesore:

- Hulumtimi/kërkimi shkencor
- Zbatimi i shkencës dhe i teknologjisë
- Materia, vetitë dhe shndërrimet e saj
- Proceset fizike
- Proceset jetësore
- Toka dhe gjithësia

Në shkencat e natyrës konceptet themelore, kompetencat dhe metodologjia për shkallët 1, 2, 3, 4 jepen të integruara, ndërsa për shkallët 5 dhe 6 jepen në lëndë të veçanta: kimi, fizikë, biologji dhe astronomi (vetëm në shkallën e gjashtë). Në disa raste edhe gjeografia bën pjesë në këtë fushë.

Në shkollat profesionale këto koncepte jepen në formë të integruar, të bazuara në qasje tematike të profesioneve të caktuara.

4. Qasja e bazuar në kompetenca

Sipas KKK-së, të mësuarit e shkencave natyrore është i bazuar në kompetenca dhe me nxënësin në qendër. Organizimi i mësimit përqendrohet në atë që duhet të dinë të bëjnë nxënësit dhe që duhet të jenë të gatshëm të bëjnë. Për të bërë diçka duhen njohuritë, shprehitë, shkathtësitë përkatëse, por edhe qëndrimet e caktuara, të cilat mund të jenë pozitive, negative, indiferente.

5.Rezultatet e të nxënit të fushës

Shkalla 5 dhe 6

SNKA / ISCED 3

Shkalla 5, Klasa X, XI (mosha 16-17 vjeç)

Shkalla 6, Klasa XII (mosha 18 vjeç)

I. NJOHURITË, TË KUPTUARIT DHE ZHVILLIMI I SHKATHTËSIVE PËRMES PROCESIT TË TË NXËNIT:

1. Strukturimi i mendimit shkencor për konceptet, modelet, teoritë dhe ligjet për ndërtimin e materies, të proceseve dhe dukurive në natyrë.

Materia e gjallë dhe jo e gjallë dhe vetitë e saj.

Proceset dhe dukuritë fizike, kimike, biologjike, në Tokë dhe në Gjithësi.

2. Zhvillimi i shkathtësive të kërkimit shkencor për ndërtimin e materies, proceseve dhe dukurive në natyrë

3. Ndërlidhja e lëndëve të shkencave të natyrës me fushat e tjera të Kurrikulës.

4. Zbatimi i shkencës dhe teknologjisë në jetën e përditshme.

5. Zhvillimi i shkathtësive të komunikimit në shkencë dhe përmes shkencës.

1. Strukturimi i mendimit shkencor për konceptet, modelet, teoritë dhe ligjet e ndërtimit të materies, të proceseve dhe dukurive në natyrë

Materia e gjallë dhe jo e gjallë dhe vetitë e saj

Proceset dhe dukuritë fizike, kimike, biologjike, në Tokë dhe në Gjithësi

Shpjegon dhe demonstroi strukturën e atomit, të molekulës, të joneve, përbërjen, rëndësinë, vetitë fizike dhe kimike të elementeve, komponimet dhe reaksionet ndërmjet tyre.

Shpjegon dhe hulumton përbërjen dhe vetitë e komponimeve organike dhe inorganike që gjenden në botën e gjallë dhe jo të gjallë si dhe ato të krijuara nga njeriu dhe analizon ndërlidhjen e tyre në proceset jetësore.

Shpjegon shkaktarët e ndryshimit të mjedisit jetësor dhe rrjedhojat e tij në nivel lokal, rajonal, kombëtar, kontinental dhe global.

Vlerëson sistemin gjeocentrik dhe heliocentrik, lëvizjen e dukshme të Diellit, rrjedhojat e saj, teoritë bashkëkohore të krijimit të sistemit diellor dhe shpjegon lidhshmërinë e hapësirë – kohës në krijimin e Gjithësisë në procesin e Eksplodimit të Madh.

Analizon dhe hulumton llojllojshmërinë e botës së gjallë si rezultat i evolucionit, rolin e ADN-së në trashëgimi dhe proceset kimike në qelizë, biologjinë e pesë mbretërive të qenieve të gjalla dhe zbatimin e ligjshmërisë së ndërtimit dhe funksionit të sistemeve të gjalla në bioteknologji dhe teknikë.

Interpreton ndërlidhjet funksionale të strukturave qelizore dhe proceset fiziko-kimike në qelizë; biologjinë e njeriut dhe format bashkëkohore të mbrojtjes së shëndetit të njeriut.

Shpjegon ligjin e ruajtjes së energjisë në proceset natyrore, energjinë e brendshme, ndërrimet e saj, rregullin, kaosin, ciklet dhe lidhshmërinë e nxehtësisë me temperaturën.

Shpjegon lidhshmërinë e resurseve energjetike me ndotjen e mjedisit jetësor dhe vlerëson trendët e zbulimit të energjisë së pastër.

Në mënyrë analitike, grafike dhe me numra paraqet rregullat e bashkëveprimeve themelore të natyrës.

Shpjegon bashkëveprimin e dobët dhe të fuqishëm bërthamor dhe ndikimin e tyre në jetën e njeriut dhe ndotjen e mjedisit.

2. Zhvillimi i shkathtësive të kërkimit shkencor për ndërtimin e materies, të proceseve dhe dukurive në natyrë

Demonstroi shkathtësi dhe shprehi praktike për hulumtim shkencor; formulon pyetje dhe hipoteza shkencore për hulumtim, dizajnon dhe kryen hulumtime shkencore duke përfshirë matjet, provat e përsëritura; mbledh dhe organizon burime të ndryshme; analizon dhe teston modelet dhe teori të bazuara në argumentet në dispozicion; shpjegon dhe përmbledh të dhënat e modelit të hulumtimit duke përdorur konceptet shkencore.

Përdor në mënyrë efektive instrumente hulumtuese adekuate nga fusha tematike e shkencës me qëllim të kryerjes së punës individuale ose në grup në projekte, zgjidhjes së problemeve dhe të studimeve të rastit.

3. Ndërlidhja e lëndëve të shkencave të natyrës me fushat e tjera

Integrimi i koncepteve të përbashkëta në shkencat natyrore (biologji, kimi, fizikë, kimi, astronomi):

- materiet organike dhe inorganike, fermentimi, ushqimi i shëndetshëm, acidet nukleike, proteinat, karbohidratet, yndyrat, metabolizmi, difuzioni, osmoza, galaktika, korrozioni, radioaktiviteti.

3.2 Integrimi në metodën shkencore hulumtuese:

- Parashtrimi i hipotezës, eksperimenti, prova, përdorimi i instrumenteve për matje, planifikimi dhe projektimi i pavarur i hulumtimeve shkencore, përpunimi i rezultateve, interpretimi i rezultateve dhe përgatitja e konkluzioneve, zbatimi.

3.3 Integrimi i shkencave natyrore me fushat e tjera

Komunikimi dhe të shprehurit

Komunikon dhe shprehet qartë, saktë dhe kuptueshëm me gojë dhe me shkrim në gjuhën amtare dhe së paku në një gjuhë të huaj, përgatitja dhe prezantimi i rezultateve të fituara gjatë hulumtimeve duke përdorur një fjalor shkencor të pasur, interpretimi i tyre përmes formave të ndryshme.

- Matematika

Përdor formulat analitike dhe operacionet matematikore për zgjidhjen e problemeve dhe i shpreh ato me vlera sasiore.

- Shoqëria dhe mjedisi

Kontribuon në zgjidhjen e problemeve aktuale të mjedisit dhe respekton diversitetin dhe tolerancën në proceset demokratike në mjedisin shoqëror.

- Shëndeti dhe mirëqenia

Kontribuon për ruajtjen e shëndetit dhe të mirëqenien personale dhe të tjerëve në mjedisin ku jeton.

- Jeta dhe puna

Përdor dhe mirëmban veglat dhe pajisjet e punës, teknologjinë e informacionit dhe të komunikimit (p.sh., poëer point, videoklip, aparat fotografik, digjital) si dhe burime të tjera të informacionit duke grumbulluar dhe duke interpretuar në mënyrë të pavarur rezultatet e hulumtimit.

4. Zbatimi i shkencës dhe i teknologjisë në jetën e përditshme

Vlerëson në mënyrë kritike rolin e zbulimeve shkencore dhe të teknologjive të reja në ofrimin e zgjidhjeve për të sotmen dhe plotësimin e nevojave të shoqërisë në të ardhmen.

Përdor në mënyrë të pavarur burime të ndryshme të informacionit nga zbulimet më të reja shkencore dhe teknologjike me qëllim të identifikimit të fushave të ndryshme shkencore për hulumtimet e ardhshme individuale dhe grupore.

5. Zhvillimi i shkathtësive të komunikimit në shkencë dhe përmes shkencës

Përdor forma të thjeshta të interpretimit të të dhënave shkencore me gojë dhe me shkrim; formulon një problem hulumtues shkencor kompleks, përgatit një plan të hulumtimit, shfrytëzon modele të sakta të komunikimit të të dhënave për prezantim, përshkrim, shpjegim dhe përmbledhje të rezultateve të hulumtimit.

Shkruan një punim të shkurtër hulumtues shkencor, prezanton punimin duke përdorur "Poëer Point" ose forma të tjera të prezantimit modern.

II. Qëndrimet dhe vlerat e strukturuar nga arsimimi përmes fushës së shkencave natyrore

Nxënësi pritet të manifestojë:

Interesim për kërkim shkencor dhe për debat.

Qëndrueshmëri.

Kureshtje për metoda të reja në fushën e shkencës.

Interesim dhe përkushtim për zhvillimet shkencore dhe të mjedisit.

Jep vlerësim të drejtë për sugjerimet e të tjerëve.

Interesim për evolucionin e teorive dhe të ideve në shkencë.

Respekton faktet.

Zhvillim të shprehive për të përdorur njohuritë dhe shkathtësitë shkencore në vendimmarrje personale për çështjet e interesit të komunitetit.

Kreativitet dhe imagjinatë.

Motivim për të zbatuar në mënyrë të përgjegjshme njohuritë për mjedisin dhe njeriun.

Etikë në shkencë.

Ndërgjegjësim lidhur me çështjet bashkëkohore, siç janë: menaxhimi i ujërave, ndryshimet klimatike, hulumtimi i kultivimit të qelizave, nanoteknologji, teknologji të gjeneve.

Zbatim të të kuptuarit shkencor në marrjen e vendimeve të përgjegjshme, etike dhe të informuara lidhur me çështjet e ndryshme.

Vlerësimin që shkencën siguron karrierë të bujshme.

Vlerësimin e diversitetit të njerëzve të cilët kanë kontribuar në formësimin dhe zhvillimin e shkencës.

III. AFTËSITË DHE SHKATHTËSITË NË SHKENCAT NATYRORE

- Përdorim burimesh dhe informacionesh
- Shkathtësi bashkëpunimi
- Shkathtësi komunikimi
- Aftësi psikomotorike
- Kreativitet
- Shkathtësi të mendimit kritik
- Shkathtësi në teknologji të informatikës
- Shkathtësi numerike
- Shkathtësi të zgjidhjes së problemeve
- Shkathtësi menaxhimi
- Shkathtësi studimi

IV. KONCEPTET DHE LËNDËT E FUSHËS SHKENCAT NATYRORE

- Kimi
- Fizikë
- Biologji
- Astronomi
- Hibridizimi
- Radioaktiviteti
- Galaktika
- Reaksionet bërthamore
- Globalizimi
- Bionika
- Trashëgimia

6. Çështjet ndërkurrikulare

Integrimi i çështjeve ndërkurrikulare në fushën e shkencave të natyrës ndihmon nxënësit të njohin dhe kuptojnë botën dhe të përballojnë më lehtë sfidat e jetës.

Çështjet ndërkurrikulare që mund të integrohen në Kurrikulën e shkencave të natyrës për këtë moshë të nxënësve janë:

- edukimi për ndërmarrësi;
- TIK dhe mësimi elektronik;
- ndërgjegjësimi për karrierën;
- edukimi për medie;
- edukimi shëndetësor dhe seksual;
- besimet;
- edukimi për zhvillim të qëndrueshëm etj.

7.Ndarja e kohës - përshkrimi

Numri i orëve të Kurrikulës Bërthamë është i përcaktuar në çdo fushë mësimore, ndërsa Kurrikula Zgjedhore përcaktohet nga shkolla përkatëse.

Fusha e shkencave të natyrës në Kurrikulën Bërthamë, shkalla 5 dhe shkalla 6, përfshin lëndët: kimi, biologji, fizikë, gjeografi dhe astronomi (shkalla 6), ndërsa te shkollat profesionale, lëndët: fizikë, kimi dhe biologji janë të integruara.

Kriter për Kurrikulën Bërthamë të shkencave natyrore në çdo lëndë është: vëllimi, baraspesha, lidhja horizontale dhe vertikale e rezultateve mësimore me gjashtë (6) kompetencat kryesore dhe vazhdimësia e realizimit të tyre nga klasa X-XII.

Plani A:

Shkolla e mesme e lartë (SNKA 3) Gjimnazi i shkencave natyrore						
Fushat kurrikulare	Shk.5				Shk.6	
	Klasa X	Klasa XI	Gjithsej orë		Klasa XII	
	Nr. orëve	Nr. orëve	Gj. Orë	%	Gj. Orë	%
Shkencat natyrore - Fizikë - Kimi - Biologji - Astronomi	7	8	15	25.00	9	28.13

Shkolla e mesme e lartë (SNKA 3) - Gjimnazi Shoqëror Gjuhësor						
Fushat kurrikulare	Shk.5				Shk.6	
	Klasa X	Klasa XI	Gjithsej orë		Klasa XII	
	Nr. orëve	Nr. orëve	Gj. Orë	%	Gj. Orë	%
Shkencat natyrore - Fizikë - Kimi - Biologji	3	3	6	10.00	3	9.38

Shkolla e mesme e lartë (SNKA 3) Shkollat profesionale						
Fushat kurrikulare	Shk.5				Shk.6	
	Klasa X	Klasa XI	Gjithsej orë		Klasa XII	
	Nr. orëve	Nr. orëve	Gj. Orë	%	Gj. Orë	%
Shkencat natyrore - Fizikë - Kimi - Biologji	2	2	4	6.25	2	6.25

Plani A1:

Shkolla e mesme e lartë (SNKA 3) - Gjinnazi Natyror										
Fushat kurrikulare	Lëndët mësimore	Shk.5				Shk.6				
		Klasa X		Klasa XI		Gjithsej orë		Klasa XII		
		Nr. orëve	Nr. orëve	Nr. orëve	Nr. orëve	Gj. Orë	%	Nr. oreve	Gj. Orë	%
Shkencat natyrore	<i>Fizikë</i>	3		3		15	25.00	2		28.13
	<i>Kimi</i>	2		3				2		
	<i>Biologji</i>	2	7	2	8			3	9	
	<i>Astronomi</i>							2		

Shkolla e mesme e lartë (SNKA 3) - Gjinnazi Shoqëror Gjuhësor										
Fushat kurrikulare	Lëndët mësimore	Shk.5				Shk.6				
		Klasa X		Klasa XI		Gjithsej orë		Klasa XII		
		Nr. orëve	Nr. orëve	Nr. orëve	Nr. orëve	Gj. Orë	%	Nr. oreve	Gj. Orë	%
Shkencat natyrore	<i>Fizikë</i>	2		1		7	11.67	1		9.38
	<i>Kimi</i>	1	4	1	3			1	3	
	<i>Biologji</i>	1		1				1		

8. Udhëzime metodologjike

Suksesi i nxënësve në lëndët e shkencave të natyrës varet nga puna dhe angazhimi i mësimit dhe nxënësit. Kjo arrihet duke pasur qasje bashkëkohore ndërvepruese dhe gjithëpërfshirëse dhe duke përdorur metoda, teknika e forma të shumëllojta të punës. Për këtë qëllim zbatohet një kompleks i tërë procedurash, si informacioni i ri, përsëritje, përforsim, ushtrime, detyra, punë me projekte, punë praktike e të tjera. Po ashtu përdoren mjete materiale teknike, siç janë: modele, grafikë, kimikate, enë të kuzhinës, enë laboratorike, instrumente, kompjuter e teknologji të tjera arsimore. Këto qasje dhe metoda duhet të jenë në funksion të nxitjes së mendimit të pavarur, kritik e krijues.

Përzgjedhja e metodave është kompetencë e mësimit dhe nxënësit të lëndës. Ajo bëhet në përshtatje me nevojat dhe kërkesat e nxënësve, me natyrën e përmbajtjes së temës mësimore, me bazën didaktike, me nivelin e formimit të nxënësve etj.

Metodat, teknikat dhe format e punës me nxënës duhet të jenë në funksion të përvetësimit më të lehtë të përmbajtjeve mësimore, të njohurive, shprehive, shkathtësive, qëndrimeve dhe vlerave të tjera për të përballuar sfidat jetësore.

Me qëllim të përmbushjes së kërkesave për nxënës cilësorë, sugjerohen metoda, forma dhe teknika të ndryshme të punës:

Mësimdhënie e drejtpërdrejtë (shpjegim, sqarim, ushtrime praktike dhe shembuj);

Mësimdhënie jo e drejtpërdrejtë (shqyrtim, zbulim, zgjidhje e problemeve);

Mësimdhënie me anë të pyetjeve (teknika e pyetjeve drejtuar nxënësve);

Diskutim dhe nxënës në bashkëpunim (në grupe të vogla, grupe më të mëdha dhe me të gjithë nxënësit);

Mësimdhënie që nxit të menduarit kritik, krijues dhe zgjidhjen e problemeve;

Të mësuarit përmes projekteve, punëve kërkimore në terren;

Mësimdhënie përmes vrojtimit, demonstrimit dhe eksperimentit;

Të mësuarit dhe të nxënësit përmes mjeteve multimediale e në veçanti përmes kompjuterit;

Mësimdhënie që nxit hulumtimin e pavarur;

Të mësuarit në natyrë dhe vizitat objekteve industriale.

Në të gjitha rastet zbatimi i metodave apo i teknikave mësimore duhet të shoqërohet me përdorimin e materialeve dhe të mjeteve përkatëse didaktike, pa të cilat nuk mund të arrihen rezultatet e pritura.

9. Udhëzime për vlerësim

Vlerësimi është proces i grumbullimit sistematik, cilësor e sasior të informatave të arritjes së nxënësve gjatë procesit të të nxënësve dhe nxjerrja e gjyqimeve për to.

Vlerësimi është në funksion të:

- sigurimit të informatave të nevojshme për përparimin e nxënësve dhe motivimit të tyre për të nxënë;
- identifikimit të vështirësive gjatë procesit të të nxënësve;
- nxjerrjes së përfundimeve për arritjet e nxënësve gjatë procesit të të nxënësve;
- vetëvlerësimit të nxënësve dhe mësuesve;
- përmirësimit të mësimit dhe të të nxënësve.

Vlerësimi i nxënësve për lëndët e Kurrikulës Bërthamë dhe për lëndët zgjedhore bëhet me notë, në përputhje me kriteret e përcaktuara nga MASHT-i. Vlerësimi i nxënësve me notë bëhet për përgjigjet me gojë dhe me shkrim, për detyrat e shtëpisë, për aftësitë gjatë punës në grup, gjatë provave, gjatë punës me projekte etj.

Format e vlerësimit duhet të jenë në përputhje me stilet e ndryshme të të nxënësve.

Mësuesi është i pavarur në përzgjedhjen e metodave, teknikave dhe instrumenteve të vlerësimit. Vlerësimi duhet të jetë transparent për nxënësit, prindërit dhe komunitetin.

Instrument i rëndësishëm për vlerësim, vetëvlerësim dhe marrjen e informacioneve të përparimit apo ngecjes së nxënësve është dosja e nxënësve.

10. Materialet dhe burimet mësimore

Për realizimin me sukses të kompetencave në shkencat e natyrës është e nevojshme të krijohen kushte, të sigurohen mjete mësimore dhe mjedis i përshtatshëm mësimor.

Materiale tekstuale: teksti shkollor, fletorja e punës, libri i mësuesit, udhëzuesi profesional, fjalorë, gazeta, revista, materiale psikopedagogjike, enciklopedi etj.

Mjete vizuale – pamore: tabelë shkrimi, fotografi, piktura, modele, makete, diagrame, mjete grafike etj.

Mjete auditive - dëgjimore: radioja, magnetofoni, telefoni, kasetofoni etj.

Mjete audiovizuale - pamore-dëgjimore: televizori, filmi, videoja, videoprojektori, videokaseta, kompjuteri, interneti, teleteksti, CD-ja, e-maili (posta elektronike).

Mjedis mësimor (klasa, laborator, punëtorja, natyra, ferma etj.).

Fusha kurrikulare - Shoqëria dhe mjedisi

Hyrje

Arsyeshmëria dhe përshkrimi

Konceptet dhe përshkrimi

Qasja e bazuar në kompetenca

Rezultatet e të nxënit të fushës

Çështjet ndërkurrikulare

Ndarja e kohës – përshkrimi

Udhëzime metodologjike

Udhëzime për vlerësim

Materialet dhe burimet mësimore

1. Hyrja

Fusha kurrikulare Shoqëria dhe mjedisi në nivelin e tretë, realizohet përmes mësimin lëndor. Lëndët mësimore të kësaj fushe në këtë nivel janë: historia, edukata qytetare, gjeografia, sociologjia, psikologjia, filozofia dhe logjika. Mësimdhënësit duhet t'i marrin në konsideratë synimet e përbashkëta të fushës që do të realizohen përmes përmbajtjeve lëndore të të gjitha lëndëve.

Fusha Shoqëria dhe mjedisi i ndihmon nxënësit për të kuptuar, për të analizuar e për të vlerësuar konceptet, proceset, idetë, zhvillimet psikologjike dhe ndryshimet historike e shoqërore në nivel lokal, kombëtar, rajonal dhe ndërkombëtar, duke përfshirë lindjen dhe zhvillimin e qytetërimeve, strukturave shoqërore, si dhe ngjarjet dhe rolin e personaliteteve nga kohët më të lashta deri më sot.

Kjo fushë ndihmon nxënësit për të thelluar të kuptuarit mbi vendet dhe hapësirën, sistemet fizike e humane, rajonet dhe karakteristikat e tyre. Gjithashtu, ndihmon krijimin e shprehive, vlerave dhe qëndrimeve në raport me diversitetin kulturor, identitetin social e psikologjik, trashëgiminë kulturore, organizimin shoqëror, liritë dhe të drejtat e njeriut si dhe rolin dhe funksionimin e institucioneve demokratike.

2. Arsyeshmëria dhe përshkrimi

Përmes fushës Shoqëria dhe mjedisi, në shkallën e pestë dhe të gjashtë (klasat X, XI dhe XII) synohet zhvillimi i aftësive, i shkathtësive, i vlerave dhe i qëndrimeve të nxënësve, për të qenë qytetarë të përgjegjshëm, për të zhvilluar identitetin personal dhe për të njohur më mirë identitetin kolektiv (social, kombëtar, shtetëror, etnik, fetar, racor, gjinor, kulturor, regjional) si dhe për të zhvilluar një personalitet të qëndrueshëm psikologjik. Kjo fushë ndihmon zhvillimin e aftësive për të gjykuar drejt dhe për të marrë vendime të përgjegjshme në situatat e jetës së përditshme, për të kultivuar e shprehur e për të marrë iniciativa për ruajtjen dhe mbrojtjen e mjedisit.

Fusha Shoqëria dhe mjedisi, në këtë nivel, ndihmon nxënësit për të zhvilluar e për të përforcuar më tej të kuptuarit, duke siguruar një bazë të qëndrueshme në orientimet akademike e profesionale të tyre në karrierë.

3. Konceptet dhe përshkrimi

Në ShK5 dhe ShK5, konceptet e përgjithshme të fushës kurrikulare Shoqëria dhe mjedisi, të cilat i përshkojnë të tri nivelet e arsimit parauniversitar, zërthehen më gjerësisht dhe në nivel më të thelluar.

Grupet dhe marrëdhëniet shoqërore

Në konceptin strukturat shoqërore, në fushën shoqëria dhe mjedisi për nivelin e tretë, përfshihet zhvillimi i aftësive dhe shprehive të nxënësve për të ushtruar role dhe për të ndërtuar raporte të qëndrueshme shoqërore, si në familje, në grup shoqëror ashtu edhe në komunitet dhe në shoqëri në përgjithësi, por edhe në raportet intrapersonale psikologjike. Në përmbajtjen e këtij koncepti përfshihet edhe aftësimi për pjesëmarrje aktive në strukturat dhe organizime të ndryshme shoqërore.

Proceset shoqërore

Ky koncept nënkupton proceset shoqërore, zhvillimet dhe ndryshimet që kanë ndodhur dhe ndodhin në vend, në rajon dhe në botë. Në kuadër të këtij koncepti bëjnë pjesë edhe njohuritë, qëndrimet dhe vlerësimet për zhvillimet e popullsisë, për individin si element i shoqërisë dhe si personalitet psikologjik, për vendbanimet, migrimet, diversitetin kulturor, për zhvillimin e qëndrueshëm, për komunikimin kulturor, për teknologjinë dhe globalizmin.

Normat, të drejtat dhe përgjegjësitë

Në kuadër të kësaj tërësie nxënësit thellojnë të kuptuarit dhe u përmbahen normave dhe rregullave shoqërore në mjedisin jetësor. Ata mësojnë se liria dhe e drejta e tyre kërkon përgjegjësi ndaj vetes, ndaj familjes, ndaj shkollës, ndaj rrethit ku jeton dhe më gjerë. Kjo nënkupton edhe vetëdijesimin për rëndësinë e lirive dhe të drejtave njerëzore, barazinë gjinore, tolerancën, solidaritetin, luftën kundër diskriminimit dhe paragjyqimeve, nevojën e bashkëpunimit dhe komunikimit me të tjerët, për të kaluarën dhe të tashmen.

Vendimmarrja

Në këtë nivel kultivohen vetëbesimi dhe arsyeshmëria e vendimmarrjes në raste të caktuara, duke u mbështetur në argumentet e qëndrueshme. Nxënësit duhet të gjykojnë dhe të vlerësojnë se vendimmarrja e drejtë dhe e argumentuar është e dobishme për veten e tyre, për të tjerët, por edhe për mjedisin shoqëror dhe natyror. Gjithashtu, praktikohet shkëmbimi i ideve dhe i informatave të nevojshme të cilat i shërbejnë për të marrë vendime në mënyrë të vetëdijshme dhe të përgjegjshme.

Mjedisi

Nënkupton njohuri të thelluara për raportin e njeriut dhe mjedisit jetësor, për lidhjet dhe ndikimet e tyre të ndërsjella, shkaktarët që ndikojnë në dëmtimin e mjedisit dhe masat për mbrojtjen e tij. Gjithashtu, përfshin edhe vetëdijesimin dhe angazhimin për nevojën e ruajtjes së mjedisit, të ekosistemeve dhe biodiversitetit për të siguruar zhvillim të qëndrueshëm. Ky koncept përfshin edhe njohuritë mbi hapësirën (tokën dhe gjithësinë), elementet dhe tiparet natyrore dhe socio-geografike të mjedisit natyror e human, të rajoneve dhe vendeve, duke përfshirë edhe njohuritë për objektet e trashëgimisë natyrore dhe kulturore dhe kujdesin për to. Nxënësit duhet të nxiten që të krijojnë shprehitë për ruajtjen, mbrojtjen dhe përmirësimin e ambientit jetësor.

4. Qasja e bazuar në kompetenca

Fusha Shoqëria dhe mjedisi duhet të realizohet në atë mënyrë që t' u mundësojë nxënësve përvetësimin dhe kultivimin gradual të kompetencave kryesore të parapara në KKK. Organizimi i mësimin duhet të përqendrohet në atë se çka duhet të dinë dhe çka duhet të jenë të gjendje të bëjnë nxënësit. Kjo pasqyrohet përmes njohurive, shkathtësive, shprehive, por edhe përmes qëndrimeve dhe sjelljeve që duhet t' i reflektojë nxënësi, duke bërë analiza e vlerësime të nevojshme dhe duke zhvilluar angazhime konkrete.

5. Rezultatet e të nxënit të fushës

Shoqëria dhe mjedisi SNKA / ISCED 3	
Shkalla 5, Klasa X, XI (15-16 vjeç)	Shkalla 6, Klasa XII (17 vjeç)
I. Njohuritë, të kuptuarit dhe shkathtësitë përmes të cilave nxënësi:	
<ol style="list-style-type: none"> Hulumton strukturën e grupeve shoqërore dhe mënyrat e pjesëmarrjes apo të përfshirjes në to Hulumton objektet, dukuritë, proceset historike, shoqërore, natyrore e mjedisore si dhe lidhjet dhe ndikimet ndërmjet tyre Analizon dhe shqyrton në mënyrë kritike dhe zbaton normat dhe rregullat shoqërore për jetë të përbashkët në diversitet Jep ide dhe propozime si dhe merr vendime në mënyrë të vetëdijshme dhe të përgjegjshme Kontribuon në ruajtjen dhe mbrojtjen e mjedisit si dhe në zhvillimin e qëndrueshëm të tij Shfrytëzon efektivisht TIK-un dhe teknologjitë e tjera bashkëkohore 	
1. Hulumton strukturën e grupeve shoqërore dhe mënyrat e pjesëmarrjes apo të përfshirjes në to	
Analizon dhe nxjerr përfundime logjike për ndikimin e personaliteteve të shquara historike, shoqërore, politike kulturore e arsimore, kombëtare e ndërkombëtare, gjatë periudhave të ndryshme historike.	Reflekton për gjendjen dhe nevojat e komunitetit dhe angazhohet me veprime konkrete në dobi të tij, duke u bazuar në burimet dhe përvojat historike njerëzore për liri, barazi dhe demokraci.
Reflekton për gjendjen dhe nevojat e komunitetit dhe angazhohet me veprime konkrete në dobi të tij, duke u bazuar në burimet dhe përvojat historike njerëzore për liri, barazi dhe demokraci.	Merr iniciativë në organizime rinore në shkollë dhe jashtë saj për të zhvilluar proceset demokratike dhe i adreson çështjet me interes përmes veprimeve konkrete.
2. Hulumton objektet, dukuritë, proceset historike, shoqërore, natyrore e mjedisore si dhe lidhjet dhe ndikimet ndërmjet tyre	
Përmes punës me projekte analizon në mënyrë kritike dallimet e shkaqeve të ngjarjeve dhe dukurive të ndryshme në shoqëri dhe në mjedis dhe shpreh opinionet personale për ndikimet e tyre në individë, në sisteme shoqërore dhe në zhvillime globale.	Merr pjesë aktivisht (planifikim, organizim, udhëheqje, menaxhim etj.) në aktivitete hulumtuese duke përdorur lloje të ndryshme të informacioneve për ngjarjet dhe dukuritë shoqërore, historike e gjeografike dhe sjell të dhëna të mbështetura në fakte, duke iu shmangur paragjykimëve dhe opinionëve subjektive.
3. Analizon dhe shqyrton në mënyrë kritike dhe zbaton normat e rregullat shoqërore për jetë të përbashkët në diversitet	
Hulumton të dhënat që ndërlidhen me identitetin (si: traditat, rregullat, besimet, mitet, legendat, ndërtesat tipike/përfaqësuese, monumentet etj.) të popullit të vet dhe të popujve të tjerë; shpjegon vlerat e identitetit kombëtar, rajonal, evropian dhe global.	Prezanton fakte dhe opinione, sqaron prejardhjen e tyre dhe përmes tyre nxjerr përfundime dhe shpreh pikëpamjet dhe qëndrimet e veta për çështje të ndryshme shoqërore, historike, kulturore si dhe për dukuri të ndryshme natyrore dhe gjeografike.
4. Jep ide dhe propozime si dhe merr vendime në mënyrë të vetëdijshme dhe të përgjegjshme	
Përmes punës në projekte ose në aktivitete grupore analizon në mënyrë kritike dallimet ndërmjet sistemeve të vendimmarrjes në nivel lokal, rajonal dhe ndërkombëtar, si dhe ndikimin e tyre në jetën e qytetarëve në rrethana dhe në periudha të ndryshme historike.	Vlerëson ndikimin e zhvillimit ekonomik, shkencor dhe teknologjik në shoqëri në përgjithësi si dhe në vendimmarrje.
5. Kontribuon në ruajtjen dhe mbrojtjen e mjedisit si dhe në zhvillimin e Qëndrueshëm të tij	
Bazuar në një raste studimi, identifikon një problem konkret aktual të ndotjes në mjedisin e tij, planifikon punën, mbledh të dhëna, analizon dhe interpreton ato dhe vjen me një sërë zgjidhesh të qëndrueshme.	Analizon karakteristikat shoqërore-ekonomike të mjedisit, proceset ekonomike, sociale, politike, kulturore dhe paraqet ndryshimet në shoqëri si rezultat i ndërveprimit në nivel lokal, rajonal dhe ndërkombëtar.

6. Shfrytëzon efektivisht TIK-un dhe teknologjitë e tjera bashkëkohore

Shfrytëzon burime të ndryshme të shkruara dhe elektronike për të bërë analiza (shkak-pasojë) të ngjarjeve të rëndësishme shoqërore dhe të dukurive natyrore, në mjedisin ku jeton si dhe në nivel kombëtar e ndërkombëtar.

Përdor me shkathtësi programe dhe mjete digjitale për të qenë qytetar i informuar dhe pjesëmarrës aktiv në veprimtaritë shoqërore dhe në zhvillimin e qëndrueshëm.

II. Qëndrimet dhe vlerat e strukturuar nga arsimimi përmes fushës

Shoqëria dhe mjedisi

- Respekti për të tjerët
- Vetërespekti
- Empatia (bashkëndjenja me të tjerët)
- Solidariteti
- Humanizmi
- Filantropia
- Barazia
- Toleranca
- Gjykimi i drejtë
- Diskutimi dhe debatimi
- Pjesëmarrja konstruktive

III. Aftësitë dhe shkathtësitë e fituara nga fusha Shoqëria dhe mjedisi

- Përdorimi i informacioneve
- Hulumtimi
- Shfrytëzimi i burimeve
- Grumbullimi dhe dokumentimi i informacioneve
- Përdorimi i fjalorit të mësuar
- Ndërtimi dhe leximi i grafikëve, diagrameve, tabelave dhe hartave
- Evidentimi i ngjashmërive dhe i ndryshimeve
- Menaxhimi efektiv i kohës
- Ndërlidhja e shkakut dhe pasojës
- Pjesëmarrja në aktivitete shoqërore
- Pjesëmarrja në vendimmarrje
- Marrja e iniciativave
- Interpretimi i burimeve
- Krijimi i modeleve
- Analizimi i proceseve

IV. Konceptet kyç të fushës Shoqëria dhe mjedisi

Shoqëria	Ambienti	Individi	Qytetari	Civilizimi
Mjedisi	Gjinia	Liria	Barazia	Familja
Komunikimi	Solidariteti	Bashkëndjenja	Rregullat	Toleranca
Kronologjia	Grupet shoqërore	Marrëdhëniet shoqërore	Normat	Të drejtat
Përgjegjësitë	Vendi dhe hapësira	Orientimi	Globi	Harta
Koha	Mjedisi natyror	Toka	Litosfera	Atmosfera
Hidrosfera	Mjedisi human	Popullsia	Vendbanimi	Ekonomia
Rajoni(regjioni)	Shteti	Kontinenti	Deti	Lufta
Oqean	Migrimet	Vendimmarrja	Relievi	Erozion
Epoka	Klima	Burimi	Kombi	Flora
Fauna	Ideja	Gjykimi	Sistemi nervor	Emocionet
Konjitiviteti	Personaliteti	Perceptimi	Kujtesa	Të menduarit
Nocioni	Induksioni	Deduksioni	Silogjizmi	Rrymat filozofike

6. Çështjet ndërkurrikulare

Ndër qëllimet e rëndësishme të fushës Shoqëria dhe mjedisi është edhe mësimi i çështjeve ndërkurrikulare, që do të ndihmojnë në arritjen e kompetencave kryesore të parapara me KKK. Disa nga çështjet ndërkurrikulare që merren në konsideratë në këtë nivel e që janë trajtuar në vazhdimësi edhe në nivelet paraprake janë:

- Edukimi për paqen
- Shfrytëzimi medias (përdorimi i medias për ta kuptuar botën përreth)
- Edukimi për zhvillim të qëndrueshëm (ekonomik, shërbimet për bashkësinë; siguria, mbrojtja e mjedisit natyror dhe human dhe zhvillimi i qëndrimeve ekologjike)
- Gjuha dhe shkathtësitë e komunikimit në tërë Kurrikulën (cilësia e mirë e komunikimit në të gjitha lëndët)
- Zhvillimi personal dhe shkathtësitë për jetë (edukimi për konsumim dhe kursim; respektit për vete dhe për të tjerët, toleranca, vetëpërbajtja, aftësia për marrëveshje, vetiniciativa dhe përgatitjet për të ardhmen)

7. Ndarja e kohës - përshkrimi

Në planin mësimor, për Kurrikulën Bërthamë për këtë nivel (për shkallët kurrikulare 5 dhe 6), si për arsimin e përgjithshëm ashtu edhe për arsimin dhe aftësimin profesional, është përcaktuar koha e nevojshme minimale për secilën fushë mësimore kurrikulare, që shprehet në përqindje apo në numra orësh mësimore. Për fushën Shoqëria dhe mjedisi është ndarë kohë që llogaritet e mjaftueshme për arritjen e qëllimeve dhe rezultateve të nxëniet të parashikuara për këtë nivel. Për shkallën e pestë dhe të gjashtë kurrikulare, përqindja e përcaktuar për këtë fushë për arsimin e përgjithshëm është 16.67% nga totali i kohës së paraparë për të gjitha fushat. Ndërsa në arsimin dhe aftësimin profesional përqindja e përcaktuar për këtë fushë është 6.25%.

Shkolla e mesme e lartë (SNKA 3) - Gjinnazi Shoqëror Gjuhësor						
Fushat kurrikulare	Shk.5				Shk.6	
	Klasa X	Klasa XI	Gjithsej orë		Klasa XII	
	Nr. orëve	Nr. orëve	Gj. Orë	%	Gj. Orë	%
Shkencat natyrore						
- Histori						
- Gjeografi						
- Ed. qytetare						
- Psikologji						
- Sociologji						
- Filozofi						
- Logjikë						
	7	8	15	25.00	9	28.13

Shkolla e mesme e lartë (SNKA 3) Gjinnazi i shkencave natyrore						
Fushat kurrikulare	Shk.5				Shk.6	
	Klasa X	Klasa XI	Gjithsej orë		Klasa XII	
	Nr. orëve	Nr. orëve	Gj. Orë	%	Gj. Orë	%
Shkencat natyrore						
- Histori						
- Gjeografi						
- Ed. qytetare						
- Psikologji						
- Sociologji						
- Filozofi						
- Logjikë						
	4	3	7	11.67	4	12.50

Shkolla e mesme e lartë (SNKA 3) Shkollat profesionale

Fushat kurrikulare	Shk.5				Shk.6	
	Klasa X	Klasa XI	Gjithsej orë		Klasa XII	
	Nr. orëve	Nr. orëve	Gj. Orë	%	Gj. Orë	%
Shkencat natyrore - Histori - Gjeografi - Ed. Qytetare	2	2	4	6.25	1	3.13

Shkolla e mesme e lartë (SNKA 3) - Gjinnazi Shoqëror Gjuhësor

Fushat kurrikulare	Lëndët mësimore	Shk.5				Shk.6		
		Klasa X	Klasa XI	Gjithsej orë		Klasa XII		
		Nr. orëve	Nr. orëve	Gj. Orë	%	Nr. oreve	Gj. Orë	%
Shkencat natyrore	Histori	3	2	15	25.00	2		28.13
	Gjeografi	2	2			2		
	Ed. qytetare	2	0			0		
	Psikologji	0	7	2	8	0	9	
	Sociologji	0	2			1		
	Filozofi	0	0			2		
	Logjikë	0	0			2		

Shkolla e mesme e lartë (SNKA 3) - Gjinnazi Shoqëror Gjuhësor

Fushat kurrikulare	Lëndët mësimore	Shk.5				Shk.6		
		Klasa X	Klasa XI	Gjithsej orë		Klasa XII		
		Nr. orëve	Nr. orëve	Gj. Orë	%	Nr. oreve	Gj. Orë	%
Shkencat natyrore	Histori	2	1	7	11.67	1		12.5
	Gjeografi	1	1			2		
	Ed. qytetare	1	0			0		
	Psikologji	0	4	1	3	0	4	
	Sociologji		0			1		
	Filozofi		0			0		
	Logjikë		0			0		

8.Udhëzime metodologjike

Për të realizuar qëllimet e Kurrikulës përmes fushës Shoqëria dhe mjedisi këshillohet përdorimi i metodave të ndryshme që e plotësojnë njëra-tjetrën dhe që mundësojnë zhvillimin e mendimit kritik e kreativ të nxënësi, për zbatimin e njohurive në situata të ndryshme.

Mësimdhënësi është i lirë të zgjedhë metodologjinë e punës duke vlerësuar drejt kushtet, rrethanat dhe mundësitë të cilat i ka në dispozicion. Duke u bazuar në udhëzimet e KKK-së, të marrë parasysh mësimin e bazuar në arritjen e kompetencave, mësimin me nxënësin në qendër, gjithëpërfshirjen, mësimin e diferencuar, duke respektuar stilet e ndryshme të të nxënësve si dhe Mësimin e Bazuar në Projekte (MBP), i cili zhvillon shkathësitë praktike të kërkuara në KKK.

Në kuadër të metodologjisë për këtë fushë dhe për këtë nivel sugjerohet shfrytëzimi:

- I intervistës dhe i historisë gojore për mbledhjen e të dhënave për ngjarjet, vendet, personalitetet dhe mënyrën e jetesës. Këto rrisin shkathësinë e përdorimit të burimeve të ndryshme të informacionit.
- I debateve, që krijon shprehje të komunikimit efektiv, shkathësi të të menduarit kreativ, të prezantimit të pikëpamjeve dhe argumentimit të ideve, aftësi bashkëpunuese, socializim.
- I vrojtimit dhe kontaktit të drejtpërdrejtë me mjedisin dhe natyrën, organizimi i vizitave mësimore dhe ekskursioneve zhvillojnë të nxënësit aftësitë e hulumtimit dhe të vëzhgimit, të interpretimit dhe të diskutimit për dukuri të ndryshme natyrore dhe mjedisore.

- Racional i TIK-ut nga nxënësi në bashkëpunim ose sugjerim të mësimit dhe prindit ndihmon në kompletimin e marrjes së informacioneve dhe përgatitjen e tij për të qenë i suksesshëm.
- I bashkëveprimi brenda grupit zhvillon aftësitë për komunikim, për organizim, menaxhim si dhe për të dalluar dhe për të vlerësuar situata të ndryshme nga e kaluara dhe e tashmja si dhe që të dijë të nxjerrë përfundime.

Bashkëpunimi me institucionet, grupet e interesit dhe me shoqërinë civile, janë forma të tjera të punës që realizohen edhe jashtë hapësirës shkollore. Përshkrimi i ngjarjeve si dhe i vendeve të ndryshme, mbledhja e të dhënave dhe materialeve të tjera hulumtuese si dhe prezantimi i punës së vet dhe të grupit para të tjerëve, e ndihmojnë nxënësin në arritjen e kompetencave.

9. Udhëzime për vlerësim

Vlerësimi, si një ndër çështjet më komplekse në procesin arsimor, duhet të shërbejë në përkrahjen dhe forcimin e të nxënësve; kontrollin e progresit individual të nxënësve; përmbushjen me sukses të rezultateve të të nxënësve dhe kompetencave të përcaktuara në Kurrikulë.

Gjatë procesit të vlerësimit sugjerohet që mësimit/vlerësuesit të përdorin forma dhe instrumente të ndryshme vlerësimi, duke u ofruar nxënësve jo vetëm kritere të shkruara, por edhe lloje të tjera të vlerësimit, për të kuptuar në mënyrë konkrete arritjet të cilat ata i synojnë. Instrumentet për vlerësim gjithmonë duhet të jenë të përshtatshme, varësisht prej qëllimit të vlerësimit. Forma dhe lloji i vlerësimit dhe veçanërisht mënyra në të cilën rezultatet raportohen, gjithmonë duhet të reflektojnë qëllimin e vlerësimit. Mënyra e ndërtimit të vlerësimit gjithmonë duhet të jetë transparente dhe e drejtë. Vlerësimi gjithmonë duhet të zbatohet me standartet më të larta etike. Vlerësimi i nxënësve duhet të jetë motivues dhe objektiv.

Vlerësimi i nxënësve në këtë nivel për këtë fushë duhet të ketë parasysh specifikat e moshës së fëmijëve, kapacitetet e tyre intelektuale dhe rregullat pedagogjike.

Veçoritë që dallojnë fushën Shoqëria dhe mjedisi si një lëmë përmes së cilës pretendohet të përgatitet një

qytetar pjesëmarrës dhe i përgjegjshëm, kërkojnë nga mësimit që të përdorin shumëllojshmëri të mënyrave të vlerësimit në baza ditore, javore dhe afate të tjera të planifikuara kohore. Fokusi i vlerësimit sugjerohet të përqendrohet mbi të kuptuarit e koncepteve të shoqërisë dhe mjedisit, mbi shkathtësitë dhe praktikimin e sjelljeve dhe qëndrimeve pozitive. Vlerësimi duhet t'i ndihmojë nxënësit që të përmirësojnë e të avancojnë vazhdimisht, në mënyrë aktive, zbatimin e njohurive të mësuara në jetën e tyre të përditshme.

Vlerësimi është i lidhur ngushtë me metodologjinë e mësimit dhe kërkon kompatibilitet e konsistencë në gjithë procesin. Vlerësojmë atë që synojmë, atë që e vëmë në objektiv. Qasja e Kurrikulës së re në kompetenca, synon vlerësimin e asaj se çka është në gjendje nxënësi të bëjë, pra vlerësimi i zbatimit praktik të njohurive të marra gjatë shkollimit. Kështu, aplikimi i vlerësimit përmes vëzhgimit të vazhdueshëm të arritjeve të nxënësve dhe mbajtja e evidencës për qëllime dokumentimi dhe planifikimi të punës së mëtutjeshme me nxënësit është e domosdoshme.

Vlerësimi mund t'i shërbejë gjithashtu punës në grupe, që mund të realizohet në forma të ndryshme, si përmes miniprojekteve etj., që tek nxënësit do të masin shkathtësitë e bashkëpunimit e të hulumtimit, aftësitë e të shprehurit (të folurit) etj. Vëzhgimi i punës në grupe dhe nismave individuale mund të bëhet edhe përmes teknikës që njihet si buletin i pjesëmarrjes ose edhe asaj që quhet listë e kontrollit etj.

Për të gjitha llojet e vlerësimeve që duhet t'i bëhen nxënësit, pikë referimi janë rezultatet për fushë në nivel klase si dhe ato për kompetenca në nivel shkalle. Mësimit, varësisht nga specifikat e tyre, hulumton gjetjen e formave më të përshtatshme për vlerësimin e arritjes së tyre. Në këtë kuptim përvojat e deritanishme të secilit mësimit dhe ato të praktikuara në përgjithësi në sistemin arsimor kosovar, për vlerësim, janë një bazë fillestare e cila duhet të pasurohet në përputhje me frymën e KKK-së dhe Kurrikulës Bërthamë.

10. Materialet dhe burimet mësimore

Për formimin kompetent në fushën mësimore Shoqëria dhe mjedisi përdoren burime të ndryshme mësimore që motivojnë nxënësit në arritjen e progresit të përvetësimit të shprehive dhe shkathtësive që do t' i përdorin në të tashmen dhe në të ardhmen.

Përveç teksteve mësimore, nxënësit kanë qasje edhe në burime të tjera të njohurive. Tekstet mësimore dhe burimet e tjera mësimdhënësit i shërbejnë për të realizuar procesin mësimor.

Për njohje të qëndrueshme të fushës mësimore Shoqëria dhe mjedisi përdoret një spektër i gjerë i burimeve mësimore, përfshirë tekstet shkollore, librat e aktiviteteve dhe të ushtrimeve, fletoret e punës, broshura, atlaset, globet, enciklopeditë, literaturë, softuerë arsimorë, projekte, studime të ndryshme, analiza dhe raporte të ndryshme të lëmit përkatës, vizita të ndryshme njohëse, si, p.sh., objekteve shoqërore, kulturore dhe natyrore.

Mësimdhënësit, nxënësit dhe bartësit e tjerë të arsimit, po ashtu mund të angazhohen në hartimin e burimeve të përshtatshme mësimore, p.sh: rezultatet e projekteve nga nxënësit mund të bëhen burime të

vlefshme mësimore për klasa të ndryshme.

Mësimdhënësit mund të shfrytëzojnë dhe të krijojnë dosje, gazeta, revista, literaturë të specializuar apo doracakë të ndryshëm për aktivitete me nxënës. Gjithashtu është shumë me rëndësi që nxënësit dhe mësimdhënësit të bashkëpunojnë edhe në prodhimin e produkteve të ndryshme përmes shfrytëzimit të burimeve të teknologjisë informative.

Fusha kurrikulare - Shëndeti dhe mirëqenia

Hyrje

Arsyeshmëria dhe përshkrimi

Konceptet dhe përshkrimi

Qasja e bazuar në kompetenca

Rezultatet e të nxënit të fushës

Çështjet ndërkurrikulare

Ndarja e kohës – përshkrimi

Udhëzime metodologjike

Udhëzime për vlerësim

Materialet dhe burimet mësimore

1. Hyrje

Fusha mësimore Shëndeti dhe mirëqenia ka për qëllim edukimin e nxënësve për të qenë qytetarë aktivë, të cilët, individualisht apo në grup, ndërmarrin veprime për jetë dhe për mjedis të shëndetshëm.

2. Arsyeshmëria dhe përshkrimi

Shëndeti dhe mirëqenia ka si qëllim t'u japë nxënësve njohuri, shkathtësi dhe t'i udhëheqë drejt jetës së shëndetshme në mënyrë që të jënë në gjendje të marrin përgjegjësi për shëndetin dhe për mirëqenien e vet dhe të tjerëve. Gjithashtu, kjo fushë nxënësve u siguron mundësinë për të zhvilluar dhe për të praktikuar shprehje, qëndrime, cilësi, vlera dhe sjellje, të cilat do t'i ndihmojnë ata në përballimin me sukses të jetës së tashme dhe të ardhme.

Të mësuarit për shëndetin dhe mirëqenien fëmijëve dhe të rinjve u mundëson të:

- krijojnë koncepte mbi zhvillimin e njeriut dhe të marrin njohuritë bazë të shëndetit;
- aftësojë nxënësit për ndryshimin e vetes dhe të mjedisit që i rrethon;
- kuptojnë dhe të zbulojnë ndjenjat, qëndrimet dhe vlerat e veta;
- vendosin kontroll mbi sjelljet shëndetësore, që në mënyrë të ndërgjegjshme të sigurojnë shëndetin e tyre të ardhshëm;
- marrin vendime të informuara në mënyrë që të përmirësojnë mirëqenien e tyre mendore, emocionale, sociale dhe fizike;
- praktikojnë mënyrë të shëndoshë të jetës;
- mësojnë për higjienën dhe rëndësinë e saj për shëndetin, faktorët e rrezikut dhe si t'u shmangen aksidenteve;

- baraspeshojnë punën dhe pushimin, të bëjnë ushtrime fizike dhe t'u kushtojnë vëmendje higjienës personale dhe rregullave të të ushqyerit të shëndetshëm;
- ndërgjegjësojë nxënësit për rëndësinë e mjedisit të shëndetshëm për mbrojtjen e shëndetit dhe për zhvillimin personal kolektiv/social.

3. Konceptet dhe përshkrimi

- Zhvillimi i gjithanshëm dhe i harmonishëm i trupit përmes aktiviteteve trupore dhe sportive.
- Mirëqenia fizike, psikike, emocionale dhe sociale.
- Të ushqyerit e shëndetshëm.
- Shëndeti seksual dhe riprodhues.
- Rreziqet nga përdorimi i substancave që krijojnë varshmëri.
- Edukimi mbi mjedisin.

Shëndeti fizik

Edukata fizike nxënësve u ofron një platformë nga, e cila ata mund të ndërtojnë kompetenca fizike, për të përmirësuar aspektet fizike dhe për të zhvilluar aftësitë personale, ndërpersonale dhe atributet. Ajo u mundëson nxënësve të zhvillojnë konceptet dhe aftësitë e nevojshme për pjesëmarrje në një gamë të gjerë të aktiviteteve fizike, sportive, në valle dhe në të mësuarit në natyrë, e cila rrit mirëqenien e tyre fizike dhe i përgatit për jetë aktive e të shëndetshme.

Mirëqenia e plotë fizike, mendore, emocionale dhe sociale

Mirëqenia fizike, mendore, emocionale dhe sociale u mundëson nxënësve të njohin, të ruajnë dhe të kultivojnë shëndetin e tyre dhe të tjerëve, të njohin dhe të zbulojnë ndjenjat e tyre, të zhvillojnë respektin për vetveten dhe për të tjerët. Kjo do të rrisë besimin në arritjet e tyre, do t'u ndihmojë të menaxhojnë ndjenjat dhe emocionet e tyre si dhe do t'i përgatisë për të përballuar situatat e ndryshme.

Të ushqyerit e shëndetshëm

Të ushqyerit e shëndetshëm kontribuon në krijimin e shprehive të drejta të të ushqyerit të fëmijëve përmes promovimit të vlerave që u mundësojnë atyre të bëjnë zgjedhje të shëndetshme. Kjo i ndihmon nxënësit të njohin dhe të kuptojnë praktika të sigurta dhe higjienike në mënyrë që të aplikojnë ato në jetën e përditshme.

Shëndeti seksual dhe riprodhues

Shëndeti seksual dhe riprodhues synon që fëmijët të kuptojnë ndryshimet që ndodhin në trupin e tyre, të marrin informacione rreth rritjes dhe zhvillimit, proceseve të riprodhimit njerëzor dhe problemeve të abuzimit seksual.

Rreziqet nga përdorimi i substancave që krijojnë varshmëri

Nxënësit zhvillojnë të kuptuarit e përdorimit dhe keqpërdorimit të substancave të ndryshme, duke përfshirë medikamentet e papërshkruara. Ata zhvillojnë të kuptuarit për ndikimin e tyre negativ në marrjen e vendimeve.

Edukimi për mjedisin

Edukimi për mjedisin ndihmon nxënësit të bëhen të ndërgjegjshëm për mjedisin dhe të mund të mbrojnë veten dhe të tjerët nga faktorët e rrezikshëm. Ndërgjegjësimi mjedisor përfshin zhvillimin e ndjenjës së informimit dhe të përgjegjësisë për ruajtjen dhe përdorimin e mjedisit.

4. Qasja e bazuar në kompetenca

Sipas KKK-së, të mësuarit e shëndetit dhe mirëqenies është e bazuar në kompetenca dhe me nxënësin në qendër. Organizimi i mësimit përqendrohet në atë që duhet të dinë të bëjnë nxënësit dhe që duhet të jenë të gatshëm të bëjnë. Për të arritur diçka, duhen njohuritë, shprehitë, shkathtësitë përkatëse, por edhe qëndrimet e caktuara, të cilat mund të jenë pozitive, negative, indiferente.

5.Rezultatet e të nxënit të fushës

REZULTATET E TË NXËNIT PËR SHKALLËT 5 DHE 6

	Shkalla 5 Klasa X, XI	Shkalla 6 Klasa XII
<p>I. Njohuritë, të kuptuarit dhe shkathtësitë që zhvillohen përmes përvojave të të nxënit që lehtësojnë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Ndërtimin dhe ruajtjen e mirëqenies mendore, emocionale, shoqërore dhe fizike në shtëpi, në shkollë dhe në komunitet • Praktikimin e të ushqyerit dhe të konsumit të shëndetshëm • Praktikimin e edukatës fizike, aktiviteteve fizike dhe sportit • Të kuptuarit e fëmijërisë, adoleshencës, të qenit prind; ndërtimin e marrëdhënieve të hapura, udhëheqjen e shëndetit seksual • Parandalimin dhe shmangien nga keqpërdorimi i substancave • Planifikimin për zgjedhje dhe ndryshime 		
<p>Ndërtimi dhe ruajtja e mirëqenies mendore, emocionale, shoqërore dhe fizike në shtëpi, në shkollë dhe në komunitet</p>		
Mirëqenia mendore dhe emocionale	Zgjedh strategji adekuate kur ballafaqohet me situata të vështira emocionale në jetën e vet dhe të të tjerëve (p.sh., problemet në familje, aksidentet, humbjet në jetë dhe streset e ndryshme).	Dallon situatat dhe ndihmon njerëzit kur ndonjëherë ata ndihen të vetmuar, të keqkuptuar dhe të braktisur.
Mirëqenia shoqërore	Shfaq shkathtësi organizative në planifikim, udhëheqje dhe vlerësim të shërbimeve të komunitetit “Projekte grupore”.	Vlerëson në mënyrë aktive rezultatet e projekteve grupore, aktivitetet grupore dhe merr iniciativë për aktivitete të reja në shërbim të komunitetit.
Mirëqenia fizike	Vepron në mënyrë të koordinuar dhe me përgjegjësi në situata të fatkeqësive të ndryshme, si pasojë e katastrofave natyrore dhe fizike në jetë dhe në punë.	Demonstron njohuri dhe shkathtësi për përdorim të drejtë të mjeteve adekuate të reagimit të shpejtë në situata të fatkeqësive të ndryshme.
<p>Praktikimi i të ushqyerit dhe konsumit të shëndetshëm</p>		
Ushqimi dhe të ushqyerit e shëndetshëm	Demonstron shkathtësi për përgatitjen e ushqimeve të shëndetshme për të përmbushur nevojat për një individ të shëndoshë.	Diskuton dhe vendos në mënyrë të pavarur për preferencat e ushqimit që ndikohen nga faktorët, si: burimet ushqimore, financiare, të kulturës, të fesë dhe shpjegon politikën, legjislacionin mbi dietat dhe shëndetin si dhe ndikimin e tyre tek individët dhe komuniteti në përgjithësi.
Siguria dhe praktikimi i higjienës	Inicion plane, organizon dhe menaxhon aktivitete me rëndësi shoqërore përmes projekteve që trajtojnë problematikën mjedisore në mjedisin ku jeton.	Zbaton në praktikë dhe këshillon të tjerët për aplikimin e sjelljeve të shëndosha që kontribuojnë në ruajtjen dhe përparimin e shëndetit individual dhe të shoqërisë.
Ushqimi dhe kultura e konsumatorit	Kupton ndikimin e reklamave dhe medieve të konsumatorit dhe përdor burime të ndryshme që të marrë vendime të drejta.	Njeh dhe aplikon të drejtat dhe përgjegjësitë e konsumatorit dhe identifikon agjencitë që mbrojnë këto të drejta.

Praktikimi i edukatës fizike, aktiviteteve fizike dhe sportit		
Edukata fizike	Vlerëson rëndësinë dhe rolin e trashëgimisë kulturore, sportive dhe kontribuon në ruajtjen, afirmimin dhe prezantimin e tyre.	Shfaq qëndrim pozitiv për ndikimin e aktiviteteve fizike dhe sportive në zhvillimin e sjelljeve tolerante ndërpersonale dhe kultivimin e shprehive për ruajtjen e shëndetit dhe përparimin e mirëqenies.
Aktiviteti fizik dhe sporti	Merr pjesë në baza ditore, sipas zgjedhjes, në aktivitete energjetike, duke e përfshirë edhe sportin dhe mëson për mundësitë në dispozicion në vend dhe më gjerë.	Demonstron pjesëmarrje aktive në arritjen e objektivave personale dhe zgjedh ushtrime komplekse dhe të koordinuara gjimnastikore, të cilat ndikojnë në përmirësimin e performancës fizike.
Aktiviteti fizik dhe shëndeti	Shfaq qëndrim pozitiv për ndikimin e aktiviteteve fizike dhe sportive në zhvillimin e sjelljeve tolerante ndërpersonale dhe kultivimin e shprehive për ruajtjen e shëndetit dhe përparimin e mirëqenies.	Hulumton faktorët që mund të ndikojnë në pjesëmarrjen në aktivitete fizike, në zgjedhjen e ushqimit dhe ndikimin e këtyre aktiviteteve në shëndetin e popullatës së Kosovës dhe me gjerë.
Të kuptuarit e fëmijërisë, adoleshencës, të qenit prind; ndërtimi i marrëdhënieve të hapura, udhëheqja e shëndetit seksual		
Të kuptuarit e fëmijërisë, adoleshencës, të qenit prind	Njeh vendet se ku mund të marrë përkrahje në lidhje me situatat që përfshijnë abuzimin dhe kupton ligjet që e mbrojnë nga lloje të ndryshme të abuzimit.	Shpjegon rëndësinë dhe përgjegjësinë e të qenit prind /kujdestar dhe është i përgjegjshëm për zgjedhjet që duhet të bëjë për të ardhmen e vet.
Marrëdhëniet	Inicion dhe merr pjesë dhe mban përgjegjësi për organizimin e aksioneve dhe aktiviteteve që realizohen në shkollë dhe komunitet.	Analizon dhe merr vendime në mënyrë të pavarur dhe të përgjegjshme për krijimin e klimës pozitiv në shkollë dhe në mjedisin ku jeton, i vetëdijshëm për veprimet e veta dhe implikimet e tyre në jetë.
Shëndeti seksual	Zbaton njohuritë themelore lidhur me rreziqet për shëndetin seksual dhe riprodhues, dukuritë dhe shprehjet negative të cilat ndikojnë në jetën e tyre dhe të bashkëmoshatareve të tyre.	Vepron në mënyrë të pavarur lidhur me shëndetin seksual dhe riprodhues, duke u bazuar në informata të drejta të fituara. Planifikimi i familjes dhe marrëdhëniet familjare.
Parandalimi dhe shmangja nga keqpërdorimi i substancave		
	Demonstron strategji për të bërë zgjedhje të informuar, për të ruajtur dhe për të përmirësuar shëndetin dhe mirëqenien e vet dhe di t'i aplikojë në situata të vështira, sfiduese, duke përfshirë edhe presionin e bashkëmoshatareve.	
Planifikimi për zgjedhje dhe ndryshime		
	Analizon interesat, shkathtësitë, preferencat për të bërë zgjedhje reale të përshtatshme, të cilat i vendos si qëllime dhe plane për faza kalmtare të vetat për të ardhmen.	Hulumton lidhur me profesionet e ndryshme, mënyrën e mësimin të punës (kurse, trajnime) që e ndihmojnë në zgjedhjen sipas interesave dhe shkathtësive të veta.

II. Qëndrimet, vlerat dhe besimet	
	<ul style="list-style-type: none"> • Respekti ndaj profesioneve, diversitetit • Tolerant • Respekt ndaj te tjerëve • Kontribuues • Konsumues • Vendimmarrës • I përgjegjshëm • I vendosur • Marrëdhënie ndërpersonale • Mirëqenie • Sfidue
III. Njohuritë	
	<ul style="list-style-type: none"> • Analizon • Diskuton • Dallon situatat • Identifikon • Mendimi kritik • Vendos qëllime
IV. Shkathtësitë	
<ul style="list-style-type: none"> • Zbaton strategji • Vlerëson mundësitë • Projekton sjellje të përshtatshme • Vepron • Demonstron • Vlerëson situatat e rrezikshme • Hulumton • Kontribuon • Avokon • Prezanton • Përforcon 	<ul style="list-style-type: none"> • Pjesëmarrje aktive • Inicion, merr pjesë • Organizon • Planifikon • Menaxhon • Shfrytëzon kapacitetet • Hulumton profesionet • Bën zgjedhje

6. Çështje ndërkurrikulare

Çështjet e ndërlidhura dhe dimensionet që duhet të merren parasysh janë:

- Arsimimi për paqe dhe tolerancë;
- Zhvillimi personal dhe shkathtësitë për jetë;
- Arsimimi për zhvillim të qëndrueshëm;
- Edukimi shëndetësor, përfshirë edukimin seksual;
- Arsimimi TIK/elementet bazë dhe mësimi elektronik;
- Vetëdijesimi për karrierë;
- Përgatitja për jetë dhe për punë;
- Vetëdijesimi për ekonomi;
- Arsimimi për ndërmarrësi;
- Shkathtësitë gjuhësore dhe të komunikimit përgjatë Kurrikulës.

7. Ndarja e kohës - përshkrimi

Fusha mësimore Shëndeti dhe mirëqenia në Kurrikulën Bërthamë përfshin aktivitete që nxisin zhvillimin e shkathtësive fizike, psikike, emocionale dhe sociale, duke përfshirë lëndët: Edukatë fizike dhe sporte dhe Edukatë shëndetësore, seksuale dhe familjare në nivelin 3. Gjithashtu, në KKK janë të përcaktuara edhe numri dhe përqindja e orëve mësimore.

Kriter për Kurrikulën Bërthamë të Shëndetit dhe mirëqenies është: vëllimi, baraspesha, lidhja horizontale dhe vertikale e rezultateve mësimore me gjashtë (6) kompetencat kryesore dhe vazhdimësia e realizimit të tyre nga klasa I-XII.

Shkolla e mesme e lartë (SNKA 3) Gjinnazi i shkencave natyrore

Fushat kurrikulare	Shk.5				Shk.6	
	Klasa X	Klasa XI	Gjithsej orë		Klasa XII	
	Nr. orëve	Nr. orëve	Gj. Orë	%	Gj. Orë	%
Shkencat natyrore -Edukimi shëndetësor -Edukatë fizike	2	2	4	6.67	2	6.25

Shkolla e mesme e lartë (SNKA 3) - Gjinnazi Shoqëror Gjuhësor

Fushat kurrikulare	Shk.5				Shk.6	
	Klasa X	Klasa XI	Gjithsej orë		Klasa XII	
	Nr. orëve	Nr. orëve	Gj. Orë	%	Gj. Orë	%
Shkencat natyrore -Edukimi shëndetësor -Edukatë fizike	2	2	4	6.67	2	6.25

Shkolla e mesme e lartë (SNKA 3) - Gjinnazi Shoqëror Gjuhësor

Fushat kurrikulare	Shk.5				Shk.6	
	Klasa X	Klasa XI	Gjithsej orë		Klasa XII	
	Nr. orëve	Nr. orëve	Gj. Orë	%	Gj. Orë	%
Shkencat natyrore -Edukimi shëndetësor -Edukatë fizike	2	2	4	6.25	2	6.25

8.Udhëzime metodologjike

Për realizimin e përmbajtjeve që përcaktohen në fushën e Shëndetit dhe mirëqenies mund të përdoren metoda të ndryshme të punës me qëllim të përmbushjes së kërkesave që ka fusha, por edhe për shkak të specifikave që mbart në vete ajo. Disa prej metodave të cilat e lehtësojnë zhvillimin e suksesshëm janë metodat e mësimdhënies me nxënësin në qendër:

Të nxënit në bashkëpunim - ndodh kur nxënësit punojnë së bashku, ndonjëherë dy e nga dy, e ndonjëherë në grupe, për të ngritur një problem të përbashkët, për të eksploruar një temë të përbashkët, ose për të arritur mirëkuptime të ndërsjella në krijimin e ideve të reja. Mësuesi, me mjaft sukses, në orën e mësimimit mund të realizojë punën me grupe, lojën me role, brainstorming (stuhi mendimesh) etj.

Edukimi shëndetësor mund të zhvillohet në fôrma nga më të ndryshmet duke shfrytëzuar metodat interaktive të cilat kombinohen me format, si: punë në grupe të vogla, vizitë në qendra të ndryshme shëndetësore, java e shëndetit, e pastërtisë, pjesë teatrale, ekspozita vizatimi dhe krijimi të fëmijëve me tematikë nga edukimi shëndetësor, lojëra simbolike me role sipas temës etj.

9. Udhëzime për vlerësim

Fusha Shëndeti dhe mirëqenia, për shkak të natyrës dhe specifikave që ka, kërkon shumëllojshmëri të mënyrave të vlerësimit në baza të rregullta, ndërsa fokusi është mbi të kuptuarit e shëndetit, konceptet dhe praktikimin e sjelljeve dhe qëndrimeve pozitive. Me fjalë të tjera, nxënësit duhet të jenë në gjendje të vazhdueshme dhe në mënyrë aktive të zbatojnë në praktikë njohuritë e mësuara në jetën e tyre të përditshme.

Gjithashtu, edhe për lëndët e fushës së edukimit, siç është dhe edukimi shëndetësor, për shkak të specifikave që ka, do të ishte e vlefshme që, përveç vlerësimit numerik, të aplikohet në masë të madhe vlerësimi përshkrues, pasi puna në grup, projektet, aftësitë motorike, aftësia e të folurit etj. nuk mund të maten me anë të testeve. Për t'i matur dhe për t'i vlerësuar ato, përdoren instrumente të tjera. Vëzhgimi i drejtpërdrejtë është një procedurë e përshtatshme për fushën e edukimit shëndetësor dhe që mund të përdoret në situata të ndryshme mësimore dhe në të gjitha nivelet e shkollimit.

Ekzistojnë disa teknika dhe instrumente që ndihmojnë vrojtimin e drejtpërdrejtë të veprimtarisë së nxënësit, që përdoren për vlerësim.

Buletini i pjesëmarrjes, është teknikë vrojtimi, që mund të përdoret për të vrojtuar në grupe të vogla ose gjatë diskutimit. Buletini tregon se cili jep ndihmesë, sa shpesh bashkëpunon dhe sa të vlefshme janë ndihmesat etj.

Lista e kontrollit - përmban një listë me tema, objektiva, njohuri, për të cilat nxënësi do të vëzhgohet. Qëllimi kryesor i listës së kontrollit është të regjistrojë një vlerësim të vazhdueshëm për përparimin e nxënësit, duke dëshmuar se si i përmbush ai detyrat ose objektivat e llojeve të ndryshme. Krahas listës me elementet që do të vrojtohen, jepet edhe një shkallë vlerësuese.

Dosja e nxënësit – paraqet një portret të saktë dhe të përmbledhur, përdoret si koleksion i qëllimshëm i punimeve për të treguar modele të punëve të nxënësve, të cilat dëshmojnë përparimin e nxënësit, aftësitë e tij dhe nivelin e punimeve. Përdorimi i saj përmirëson mësimdhënien duke integruar vlerësimin për të nxënë (VpN).

Dosja mund të përmbajë, për shembull, vizatime, një projekt, një krijim, plane etj.

Dosja ka vlera, për këto arsye:

- Është një mjet që i jep informacion mësuesit, prindërve dhe nxënësve (për zhvillimin dhe progresin e tyre).
- I jep nxënësit një pamje tërësore të punës së tij.
- Duke e përgatitur vetë dosjen, nxënësi luan rol aktiv në procesin e mësimit dhe të vlerësimit (vetëvlerësimit).

Informata kthyese - e cila ka për qëllim kontrollin dhe vlerësimin e arritjeve të nxënësve që do të shërbejë si një lloj dialogu ndërmjet mësimitdhënësit dhe nxënësit për cilësinë e të nxënësit, mësimdhënies dhe arritjeve në përgjithësi. Informata kthyese shërben për identifikimin e vështirësive me të cilat ballafaqohen nxënësit gjatë procesit të nxënies, por njëkohësisht siguron zbulimin e shkaqeve të cilat i sjellin ato vështirësi dhe mundësitë për përmirësimin e punës së tyre. Informata kthyese është efektive kur jepet në kohën e duhur - atëherë kur është e domosdoshme për nxënësin.

10. Materialet dhe burimet mësimore

Për realizimin me sukses të kompetencave në fushën mësimore shëndeti dhe mirëqenia është e rëndësishme të përdoren burime të ndryshme mësimore që motivojnë nxënësit dhe stimulojnë progresin e tyre në mënyrë që të përvetësojnë shprehje dhe shkathtësi të nevojshme për të tashmen dhe të ardhmen. Meqenëse tekstet shkollore janë burime të vlefshme dhe të rëndësishme të të nxënësit, qasja e nxënësve në informacion nuk duhet të kufizohet vetëm në tekste shkollore, por duhet të shfrytëzohen edhe burime të tjera të cilat i shërbejnë për të planifikuar dhe për të realizuar procesin mësimor në klasë.

Për realizimin më të suksesshëm të fushës mësimore Shëndeti dhe mirëqenia duhet të përdoren një spektër i gjerë i burimeve mësimore, përfshirë tekstet shkollore, librat e aktiviteteve dhe të ushtrimeve, librat e punës, broshura, atlaset, enciklopeditë, softuerët arsimorë, projekte, studime të ndryshme, analiza dhe raporte të ndryshme të lëmit përkatës dhe libra të tjerë.

Mësimdhënësit, nxënësit dhe bartësit e tjerë të arsimit, po ashtu mund të angazhohen në hartimin e burimeve të përshtatura mësimore. p.sh., rezultatet e projekteve të realizuara nga nxënësit mund të bëhen burime të vlefshme mësimore për klasa të ndryshme.

Mësimdhënësit mund të krijojnë dosje, gazeta, revista, literaturë të specializuar apo doracakë të ndryshëm për aktivitete me nxënësit. Gjithashtu, është shumë me rëndësi që nxënësit dhe mësimdhënësit të bashkëpunojnë edhe në prodhimin e materialeve të ndryshme përmes shfrytëzimit të burimeve të teknologjisë informative.

Fusha kurrikulare - Jeta dhe puna

Hyrje

Arsyeshmëria dhe përshkrimi

Konceptet dhe përshkrimi

Qasja e bazuar në kompetenca

Rezultatet e të nxënit të fushës

Çështjet ndërkurrikulare

Ndarja e kohës – përshkrimi

Udhëzime metodologjike

Udhëzime për vlerësim

Materialet dhe burimet mësimore

1.Hyrje

Përderisa përgatitja për jetë dhe për punë theksohet në tërë Kurrikulën si një çështje e rëndësishme, fusha e kurrikulës Jeta dhe puna synon të kontribuojë veçanërisht si një fushë “mbartëse” në zhvillimin e kompetencave për jetë dhe punë. Në ShK 5 dhe ShK 6, ajo përqendrohet në shkathhtësitë për jetë, krahas shkathhtësive që kanë të bëjnë me ekonominë, ndërmarrësinë, orientimin në karrierë, teknologjinë dhe TIK-un.

2.Arsyeshmëria dhe përshkrimi

Përmes kësaj fushe të Kurrikulës, nxënësit do të njihen me rolet e ndryshme të individëve në jetë dhe në punë, si anëtarët e familjes, qytetarët, prodhuesit, konsumuesit, punëdhënësit dhe punëmarrësit. Nxënësit do ta zhvillojnë vetëdijesimin dhe vetëbesimin për ekzistimin e mundësive të orientimit profesional dhe karrierës (përgatitja për tregun e punës dhe për shkollim të mëtejshëm), zbatimit të TIK-ut, zhvillimit të shkathhtësive të ndërmarrësisë, zbatimit të teknologjisë profesionale dhe nevojës për t'u zhvilluar në marrëdhënie ndërpersonale në jetë dhe në punë sa i përket tolerancës dhe respektit reciprok.

Ata do ta zhvillojnë shpirtin për iniciativë e ndërmarrësi, të hartojnë dhe t'i respektojnë planet e punës dhe afatet kohore, si dhe të njihen me cilësinë e proceseve dhe të rezultateve.

Të nxënit në fushën e Kurrikulës Jeta dhe puna nxënësve u mundëson:

- Të nxënit në fushën e Kurrikulës Jeta dhe puna nxënësve u mundëson:
- Të kuptuarit dhe ushtrimin e punës praktike në shtëpi, në shkollë dhe në komunitet.
- Ngritjen e kualiteteve personale për jetë dhe për punë.
- Të kuptuarit dhe përdorimin e teknologjisë për jetën dhe punën e përditshme
- Përdorimin e TIK-ut për të avancuar nxënien dhe cilësinë e jetës së përditshme.

- Ushtrimin e zhvillimit të ndërmarrësisë dhe biznesit.
- Promovimin e kushteve të sigurta për jetë dhe për punë. Përgatitjen për jetën profesionale dhe karrierën e ardhshme.
- Lehtësi komunikimi në / për jetë dhe për punë.
- Gatishmëri për mbrojtjen dhe ruajtjen e natyrës dhe të mjedisit.

3. Konceptet themelore të fushës:

- Këshillim dhe orientim në karrierë
- Teknologji, duke përfshirë TIK-un
- Punë dhe edukim për ndërmarrësi

Këshillim dhe orientim në karrierë

Të zhvillojë te nxënësi aftësi për të zbuluar mundësitë e karrierës, si dhe për të vetëvlerësuar interesat dhe prirjet e veta me qëllim vendimmarrjen për shkollimin / trajnimin e mëtejshëm dhe punësimin, për të qenë pjesëtar funksional i shoqërisë.

Është shumë e rëndësishme që nxënësi të ketë informacion të plotë lidhur me tregun e punës në lokalitetin e tij, por edhe në rang vendi, si dhe në tregun botëror të punës.

Në vija të përgjithshme jepet informacion mbi tregun lokal të punës.

Nxënësi do të punojë shumë për të njohur më mirë veten.

Teknologji, duke përfshirë TIK-un

Teknologjia mundëson përvetësimin e njohurive dhe të shkathtësive të nevojshme nga aspekti i zhvillimeve tekniko-teknologjike, përdorimin e suksesshëm dhe të pavarur të pajisjeve të teknologjisë së profesionit dhe TIK-ut.

Nxënësit përvetësojnë konceptet mbi proceset tekniko-teknologjike, zhvillojnë shkathtësi teknike dhe aftësi për planifikime të veprimeve praktike.

Nxënësit përvetësojnë shkathtësi të përdorimit të TIK-ut për gjetjen, zhvillimin, analizimin dhe prezantimin e informacioneve, si dhe të modeleve për zgjidhjen e problemeve në situata të caktuara.

Vërejtje: ekspertët e grupit reflektojnë (konfigurojnë të veçuar teknologjinë dhe të veçuar TIK-un).

Punë dhe edukim për ndërmarrësi

Hulumtimi i ndërmarrjeve dhe zhvillimi i ndërmarrësisë nxënësve u mundëson hulumtimin e nevojave për kreativitet në ndërmarrësi, qoftë si punëdhënës qoftë si i punësuar, të identifikojë dhe të ushtrojë disa shkathtësi dhe të zhvillojë attribute në ndërlidhje me shkathtësi ndërmarrësie.

Hulumtimi i punës në ekonomi lokale dhe globale u mundëson nxënësve të hulumtojnë ndikimet në tregun e punës, implikimet për ardhmërinë e tyre në punësim. Pajisja e nxënësve me kompetenca dhe shkathtësi të domosdoshme të ndërmarrësisë, siç janë planifikimi i biznesit, administrimi, marketingu, menaxhimi me burime njerëzore, menaxhimi i projekteve.

4. Qasja e bazuar në kompetenca

Qëllimet e arsimit kosovar do të realizohen te fusha kurrikulare Jeta dhe puna përmes përvetësimit dhe kultivimit gradual të kompetencave kryesore të parapara në KKK.

Fusha Jeta dhe puna duhet të realizohet në atë mënyrë që t' u mundësojë nxënësve përvetësimin dhe zbatimin gradual të kompetencave kryesore të parapara në KKK. Organizimi i mësimit duhet të përqendrohet në atë se çka duhet të dinë dhe çka duhet të jenë të gjendje të bëjnë nxënësit. Ajo pasqyrohet përmes njohurive, shkathtësive, shprehive, por edhe qëndrimeve dhe sjelljeve që ata duhet t' i reflektojnë.

5. Rezultatet e të nxënit të fushës

Rezultatet mësimore janë hartuar mbi bazën e koncepteve themelore të fushës, RNSH për fushën kurrikulare Jeta dhe puna përmbajnë në vete kërkesat që nxënësi duhet t'i arrijë pas përfundimit të çdo shkalle. Organizimi i RNSH-së përmban njohuritë, shkathtësitë, qëndrimet dhe vlerat të cilat zhvillohen dhe thellohen sipas gradacionit në progres, duke pasur parasysh zhvillimin fizik dhe psikomotorik të nxënësve. Këto rezultate mundësojnë arritjen e gjashtë kompetencave të përcaktuara në Kornizën e Kurrikulës duke e theksuar kompetencën Kontribuues produktiv.

REZULTATET MËSIMORE PËR SHKALLËT 5 DHE 6

Shkalla 5 Klasa X, XI	Shkalla 6 Klasa XII
Kuptimi dhe ushtrimi i punës praktike në shtëpi, në shkollë dhe në komunitet	
5. Përshkruan ndryshimet ndërmjet punës individuale dhe punës me projekte.	6. Zbaton aktivitete të ndërlidhura me punën individuale dhe në grup gjatë realizimit të produkteve dhe projekteve të caktuara.
5. Hulumton, organizon në mënyrë efektive dhe prezanton informacione për aktivitete praktike individuale dhe në grup.	6. Shfrytëzon njohuritë dhe përvojën personale për të dizajnuar dhe për të zbatuar punë me projekte në shkollë në mënyrë individuale dhe në grup.
2. Ngritja e kualiteteve personale për jetë dhe punë	
5. Demonstron shkathtësitë e nevojshme për qasje mundësish punësimi.	6. Vlerëson aftësitë personale dhe arritjet e identifikuar në bazë të fushave të ndryshme të interesit sipas objektivave të caktuara për vetëpërmirësim, duke marrë në konsideratë ndikimet në zgjedhjen e karrierës në të ardhmen.
3. Kuptimi dhe përdorimi i teknologjisë për jetën dhe punën e përditshme	
5. Përshkruan ndikimin e zhvillimit aktual teknologjik si nevojë për zhvillimin e kapaciteteve profesionale me qëllim punësimi.	6. Shpjegon rëndësinë e kreativitetit dhe inovacioneve dhe zhvillon/ merr pjesë në projekte shkollore për të promovuar një frymë sipërmarrëse përmes krahasimit me praktikën më të mira, duke ndërtuar shkathtësitë për planifikimin e karrierës.
5. Përshkruan rolin dhe funksionin e produkteve dhe shërbimeve për destinime përkatëse me qëllim të përmbushjes së kërkesave dhe nevojave ditore dhe jetësore.	6. Vlerëson cilësinë, funksionalitetin dhe vlefshmërinë e pajisjeve, produkteve dhe shërbimeve që shfrytëzohen nga familja, nga shkolla dhe nga komuniteti.
4. Përdorimi i TIK-ut për të avancuar nxënien dhe cilësinë e jetës së përditshme	
5. Përdor teknologjinë informative me qëllim plotësimi, përmirësimi dhe avancimi të përvojës dhe njohurive të veta dhe të tjerëve	6. Përdor programe të avancuara për kryerjen e punëve ditore dhe në jetën e përditshme brenda dhe jashtë shkollës.
5. Ushtrimi i zhvillimit të ndërmarrësisë dhe biznesit	
5. Parandalon rreziqet e ndryshme të cilat mund të ndodhin në vendin ku punon në mënyrë që të ruajë veten.	6. Parandalon rreziqet e ndryshme të cilat mund të ndodhin në vendin ku jeton dhe punon në mënyrë që të ruajë veten, të tjerët dhe ambientin përreth.

6. Promovimi i kushteve të sigurta për jetë dhe për punë	
5. Prezanton situata të njohurive dhe shkathësisive personale për të hulumtuar burimet e mundshme të tregut të punës.	6. Merr vendime të përshtatshme për zhvillim të mëtejshëm në karrierë duke analizuar dhe duke krahasuar mundësitë personale.
7. Përgatitja për jetën profesionale dhe karrierën e ardhshme	
5. Lexon, interpreton dhe plotëson dokumentacion për nevoja personale duke u bazuar në legjislacion dhe kërkesa të tregut të punës.	6. Përdor aplikacione softuerike për përpunimin e të dhënave për aktivitete të ndryshme profesionale.
8. Komunikimi në / për jetë dhe punë	
5. Lexon, interpreton dhe plotëson dokumentacion për nevoja personale duke u bazuar në legjislacion dhe kërkesa të tregut të punës.	6. Përdor aplikacione softuerike për përpunimin e të dhënave për aktivitete të ndryshme profesionale.
9. Mbrojtja dhe ruajtja e natyrës dhe mjedisit	
5. Kupton, përshkruan dhe demonstroi marrëdhëniet mes teknologjisë, shoqërisë dhe mjedisit.	6. Intervenon në mënyrë kritike kur pasojat negative të zhvillimit ekonomik apo thyerja e rregullave ekologjike ndikon në mjedisin natyror që na rrethon dhe në nivel global.
II. Qëndrimet, vlerat dhe besimet	
<p>Respekton veten dhe të tjerët</p> <p>Vetërespekt</p> <p>I përgjegjshëm</p> <p>Tolerant</p> <p>Respektim i diversitetit</p> <p>I përkushtuar</p> <p>Qëndrim pozitiv</p> <p>Bashkëpunues</p> <p>Respekton kodin e mirësjelljes</p> <p>Respekton rregulloret</p> <p>Gatishmëri</p> <p>I sigurt</p>	<p>Kureshtar</p> <p>Pavarësi në mendime dhe veprime</p> <p>Iniciativë dhe interes në qasje të ndryshme</p> <p>Besimi në forcat vetjake</p> <p>Besimi në përdorimin e teknologjisë</p> <p>Vullneti</p> <p>Gatishmëria për bashkëpunim</p> <p>Qëndrim i hapur ndaj përkrahjes së të tjerëve</p> <p>Shprehje dhe shkathhtësi gjatë punës teorike dhe praktike</p> <p>Vetëvlerësim, vetëkritik</p> <p>Kritika konstruktive</p> <p>Respekt për saktësinë</p> <p>Hulumtimi për orientim profesional</p>

III. Njohuritë

Identifikon rreziqet e ndryshme Kupton ndikimin e veprimeve pozitive dhe negative Shkëmben përvojat Përshkrim Identifikim Zbatim Matje Vlerësim Skicim Prerje Krijim modelesh Qasje e problemeve nga perspektiva të ndryshme Dizajnim (kreativiteti) Hulumtim	Arsyetim Planifikim Argumentim Biznes Ekonomi Orientim në karrierë Tregu i punës Punëdhënës Punëmarrës
--	--

IV. Shkathtësitë

Diskuton Pjesëmarrje aktive Shpjegon Demonstron sjelle, veprime, shprehi Zbaton principet Praktikon ushtrime Ndërton bashkëpunim	Hulumton Komunikim grafik Fleksibilitet Vetëvlerësim Vetëkontroll Vendosmëri Komunikim elektronik
--	---

6. Qasja ndërkurrikulare

Në kuadër të fushës kurrikulare Jeta dhe puna një ndër qëllimet e rëndësishme të saj duhet të jetë edhe realizimi i çështjeve ndërkurrikulare që do të ndihmojnë në arritjen e kompetencave kryesore të parapara me KKK. Disa nga çështjet ndërkurrikulare që duhet të merren në konsideratë në këtë nivel, por që mund të trajtohen në vazhdimësi edhe në nivelet e tjera, janë:

- Njohja e medias (përdorimi i medias për të kuptuar botën përreth);
- Edukimi për zhvillim të qëndrueshëm (shërbimet për bashkësinë);
- Mbrojtja e mjedisit dhe zhvillimi i qëndrimeve ekologjike;
- Zhvillimi personal dhe shkathtësitë për jetë;
- Puna vullnetare;
- Arsimimi TIK/elementet bazë dhe mësimi elektronik;
- Vetëdijesimi për karrierë;
- Përgatitja për jetë dhe për punë;
- Vetëdijesimi për ekonomi;
- Njohuri themelore financiare;
- Arsimimi për ndërmarrësi;
- Shkathtësitë gjuhësore dhe të komunikimit përgjatë Kurrikulës.

7. Ndarja e kohës (plani i orëve)

Fusha kurrikulare Jeta dhe puna në Kurrikulën Bërthamë përfshin aktivitete që nxisin zhvillimin e shkathtësive, aftësive, vlera dhe qëndrime, duke përfshirë lëndët (modulet mësimore) në nivelin 3:

- Orientim në karrierë (module mësimore);
- Teknologji (module mësimore teorike-praktike profesionale);

TIK (module mësimore teorike-praktike të profilit);

Puna dhe edukimi për ndërmarrësi (module mësimore).

Gjithashtu në KKK është përcaktuar edhe numri dhe përqindja e orëve mësimore.

Kriter për alokimin për fushën kurrikulare Jeta dhe puna është: vëllimi, baraspesha, lidhja horizontale dhe vertikale e rezultateve mësimore me gjashtë (6) kompetencat kryesore dhe vazhdimësia e realizimit të tyre nga klasa X-XII.

Shkolla e mesme e lartë (SNKA 3) Gjinnazi i shkencave natyrore						
Fushat kurrikulare	Shk.5				Shk.6	
	Klasa X	Klasa XI	Gjithsej orë		Klasa XII	
	Nr. orëve	Nr. orëve	Gj. Orë	%	Gj. Orë	%
<i>Jeta dhe puna</i>	1	1	2	3.33	1	3.13

Shkolla e mesme e lartë (SNKA 3) - Gjinnazi Shoqëror Gjuhësor						
Fushat kurrikulare	Shk.5				Shk.6	
	Klasa X	Klasa XI	Gjithsej orë		Klasa XII	
	Nr. orëve	Nr. orëve	Gj. Orë	%	Gj. Orë	%
<i>Jeta dhe puna</i>	1	1	2	3.33	1	3.13

Shkolla e mesme e lartë (SNKA 3) Shkollat profesionale						
Fushat kurrikulare	Shk.5				Shk.6	
	Klasa X	Klasa XI	Gjithsej orë		Klasa XII	
	Nr. orëve	Nr. orëve	Gj. Orë	%	Gj. Orë	%
<i>Jeta dhe puna</i>	15	15	30	46.88	16	50.00

8. Udhëzime metodologjike

Për realizimin e përmbajtjeve që përcaktohen në fushën kurrikulare Jeta dhe puna mund të përdoren metoda të ndryshme të punës me qëllim të përmbushjes së kërkesave që ka fusha, por edhe për shkak të specifikave që mbart në vete. Disa prej metodave të cilat e lehtësojnë zhvillimin e suksesshëm janë metodat e mësimdhënies që në qendër kanë nxënësin, si:

Të nxënit në bashkëpunim - ndodh kur nxënësit punojnë së bashku, ndonjëherë dy e nga dy, e ndonjëherë në grupe, për të ngritur një problem të përbashkët, për të eksploruar një temë të përbashkët, ose për të arritur mirëkuptime të ndërsjella në krijimin e ideve të reja. Mësuesi, me mjaft sukses, në orën e mësimin mund të realizojë punën me grupe, lojën me role, brainstorming (stuhi mendimesh) etj.

Loja me role - është një bisedë e shkurtër, e thjeshtë për t'u organizuar, me situata të këndshme bashkëbisedimi. Ajo të nxënësit zhvillon rrjedhshmërinë, nxit ndërveprimin në klasë, duke i lënë hapësirë nismës dhe imagjinatës së nxënësit. Loja me role ngre në një shkallë të lartë motivimin.

Edukimi shëndetësor mund të zhvillohet në forma nga më të ndryshmet, duke shfrytëzuar metodat interaktive të cilat kombinohen me format, si: punë në grupe të vogla, vizitë në qendra të ndryshme shëndetësore, java e shëndetit, pjesë teatrale, ekspozita vizatimi dhe krijimi të fëmijëve me tematikë nga edukimi shëndetësor etj.

9. Udhëzime për vlerësim

Vlerësimi është një element i pranishëm në çdo veprimtari mësimore. Matja dhe vlerësimi janë pjesë përbërëse

dhe mjaft e rëndësishme e mësimdhënies në shkollën bashkëkohore.

Nxënësit nxënë mjaft gjatë viteve të shkollimit. Sidoqoftë, jo gjithçka që ata nxënë mund të matet me anë të testeve, edhe për faktin se, për nxënësit e nivelit fillor, përdorimi i teknikave të ndryshme mundëson vlerësim sa më real bazuar në karakteristikat e ndryshme të nxënësve.

Fusha kurrikulare Jeta dhe puna, për shkak të natyrës dhe specifikave që ka, kërkon shumëllojshmëri të mënyrave të vlerësimit në baza të rregullta, ndërsa fokusi është mbi të kuptuarit e jetës dhe punës, konceptet dhe praktikimi i sjelljeve dhe qëndrimeve pozitive. Me fjalë të tjera, nxënësit duhet të jenë në gjendje të vazhdueshme dhe në mënyrë aktive të zbatojnë në praktikë njohuritë e mësuara në jetën e tyre të përditshme.

Gjithashtu, edhe për lëndët e fushës Jeta dhe puna, për shkak të specifikave që ka, do të ishte e vlefshme që, përveç vlerësimit numerik, të aplikohet në masë të madhe vlerësimi përshkrues, pasi puna në grup, projektet, aftësitë psikomotorike, sensore, aftësia e të folurit etj., nuk mund të maten me anë të testeve. Për t'i matur dhe për t'i vlerësuar ato, përdoren instrumente të tjera. Vëzhgimi i drejtpërdrejtë është një procedurë e përshtatshme për fushën Jeta dhe puna dhe që mund të përdoret në situata të ndryshme mësimore dhe në të gjitha nivelet e shkollimit.

Ekzistojnë disa teknika dhe instrumente që ndihmojnë në vrojtimin e drejtpërdrejtë të veprimtarisë së nxënësit, që përdoren për vlerësim. Ja disa prej tyre:

Buletini i pjesëmarrjes, përshkruhet si një teknikë vrojtimi që mund të përdoret për të vrojtuar, në grupe të vogla ose gjatë diskutimit. Buletini tregon se cili jep ndihmesë, sa shpesh bashkëpunon dhe sa të vlefshme janë ndihmesat etj.

Lista e kontrollit, është një instrument që përmban një listë me tema, objektiva, njohuri, për të cilat nxënësi do të vëzhgohet. Qëllimi kryesor i listës së kontrollit është të regjistrojë një vlerësim të vazhdueshëm për përparimin e nxënësit.

Dosja e nxënësit është një mjet që mund të përdoret për të treguar modele të punëve të nxënësve, të cilat dëshmojnë përparimin e nxënësit, aftësitë e tij dhe nivelin e punimeve.

Dosja mund të përmbajë, për shembull, vizatime, një projekt, një krijim, plane etj.

Dosja ka vlera, për këto arsye:

Është një mjet që i jep informacion mësuesit, prindërve dhe nxënësve.

I jep nxënësit një pamje tërësore të punës së tij.

Duke e përgatitur vetë dosjen, nxënësi luan rol aktiv në procesin e mësimin dhe të vlerësimit.

10. Materialet dhe burimet mësimore

Për realizimin me sukses të kompetencave në fushën kurrikulare Jeta dhe puna është e rëndësishme të përdoren burime të ndryshme mësimore që t'i motivojnë nxënësit dhe të stimulojnë progresin e tyre në mënyrë që të përvetësojnë shprehje dhe shkathtësi të nevojshme për jetë dhe për punë në përditshmëri. Meqenëse teksteve shkollorë janë burime të vlefshme dhe të rëndësishme të të nxënësve, qasja e nxënësve në informacion nuk duhet të kufizohet vetëm në teksteve shkollorë, por duhet të shfrytëzohen edhe burime të tjera të cilat shërbejnë për të planifikuar dhe për të realizuar procesin mësimor në klasë.

Për realizimin më të suksesshëm të fushës kurrikulare Jeta dhe puna duhet të përdoret një spektër i gjerë i burimeve mësimore, përfshirë teksteve shkollorë, librat e aktiviteteve dhe të ushtrimeve, librat e punës, broshura, atlase, enciklopedi, softuerë arsimorë, projekte, studime të ndryshme, analiza dhe raporte të ndryshme të lëmit përkatës dhe materiale përkatëse pune.

Mësimdhënësit, nxënësit dhe bartësit e tjerë të arsimit, po ashtu mund të angazhohen në hartimin e burimeve të përshtatura mësimore, p.sh., rezultatet e projekteve të realizuara nga nxënësit mund të bëhen burime të vlefshme mësimore për klasa të ndryshme.

Mësimdhënësit mund të krijojnë dosje, gazeta, revista, literaturë të specializuar apo doracakë të ndryshëm për aktivitete me nxënës. Gjithashtu, është shumë me rëndësi që nxënësit dhe mësimdhënësit të bashkëpunojnë edhe në prodhimin e materialeve të ndryshme përmes shfrytëzimit të burimeve të teknologjisë informative.

... (faint, illegible text) ...



... (faint, illegible text) ...

IV.

PLANET DHE PROGRAMET MËSIMORE

Përkufizimi

Fondi i përgjithshëm i orëve në arsimin parauniversitar të Kosovës

Plani mësimor për arsimin e mesëm të lartë

Kriteret për hartimin e planit mësimor

Zbatimi i planit mësimor

Autonomia e shkollës

1. Përkufizimi

Plani mësimor është një dokument nga i cili varet i gjithë organizimi i procesit mësimor në shkollë, në nivel shkalle kurrikulare apo klase të caktuara. Me të përkufizohen fushat e Kurrikulës, lëndët mësimore dhe koha e nevojshme minimale që shprehet në përqindje apo në numra orësh për arritjen e rezultateve të të nxënimit për fushë dhe shkallë kurrikulare, të dhëna në Kurrikulën Bërthamë

Me KKK-në e re parashikohen ndryshime konceptuale dhe strategjike të planit mësimor. Deri tani plani mësimor në sistemin tonë të arsimit ka qenë i hartuar dhe i mbikëqyrur në nivelin qendror (MASHT), kurse tash e tutje synohet që gradualisht (me përkrahjen e MASHT-it) plani mësimor të zhvillohet në nivel shkollë. Kjo mundëson dhe lejon autonomi më të madhe të shkollës në organizimin e planit, por njëherazi kërkon angazhim dhe përgjegjësi më të madhe nga ajo.

2. Plani i përgjithshëm mësimor (fondi i përgjithshëm i orëve) për arsimin parauniversitar

Shkolla gjatë hartimit të planit mësimor për nivel formal (shkallë dhe klasë) duhet të ketë parasysh vazhdimësinë e gjithë planit mësimor parauniversitar për secilën fushë kurrikulare.

Shkolla ka lirinë që brenda kohës (përqindjes) së përcaktuar për secilën fushë të planifikojë organizimin e mësimorit si e vlerëson më së miri, gjithnjë duke pasur parasysh rezultatet e të nxënimit për fusha dhe shkallë kurrikulare dhe mundësitë e nxënësve.

Fushat e Kurrikulës	SNKA 0		SNKA 1	SNKA 2		SNKA 3	
	ShK1		ShK2 Klasa III & V	ShK3 Klasa VI & VII	ShK4 Klasa VIII & IX	ShK5&6 Arsimi i përgjith- shëm Klasa X, XI & XII	ShK5&6 Arsimi profesional Klasa X, XI & XII
	Klasa parafillore	Klasa I & II					
Gjuhët dhe komunikimi	33.33%	38.10%	33.33%	25.00%	26.67%	20.00 %	15.63%
Artet	11.11%	9.25%	8.33%	7.14%	6.67%	6.67%	3.13%
Matematika	22.22%	23.81%	20.83%	17.86%	13.33%	13.33%	9.38%
Shkencat natyrore	5.56%	4.76%	8.33%	14.29%	16.67%	16.67%	6.25%
Shoqëria dhe mjedisi	5.56%	4.76%	8.33%	14.29%	13.33%	16.67%	6.25%
Shëndeti dhe mirëqenia	11.11%	9.52%	8.33%	7.14%	6.67%	6.67%	6.25%
Jeta dhe puna	5.56%	4.76%	4.17%	7.14%	6.67%	6.67%	46.88%
Pjesa zgjedhore	5.56%	4.76%	8.33%	7.14%	10%	13.33%	6.25%
Aktivitetet e tjera							

Tabela: Plani i përgjithshëm mësimor (fondi i përgjithshëm i orëve) për arsimin parauniversitar

3. Plani mësimor (PM) për arsimin e mesëm të lartë

Plani mësimorë për arsimin e mesëm të lartë SNKA/ISKED 3 ka disa specifika më të theksuara. Së pari, ky nivel përbëhet nga dy shkallë të Kurrikulës, shkalla 5 dhe shkalla 6. Shkalla 5 përfshin dy klasa, X dhe XI, kurse shkalla 6 vetëm klasën XII. Po ashtu, ky nivel i arsimit pasqyron dy lloje të arsimit, arsimin e përgjithshëm (AP) dhe arsimin dhe aftësimin profesional (AAP), që, për sa i përket shpërndarjes së përqindjes së fondit kohor për fusha mësimore, nuk është i njëjtë.

Shkollat dhe mësimdhënësit duhet t' u kushtojnë vëmendje fleksibilitetit dhe mundësive të ndryshme të planifikimit mësimor që lejon plani mësimor për këtë nivel të arsimit.

Fleksibiliteti lejohet si në shpërndarjen e orëve mësimore për fusha, ku mësimdhënësit kanë mundësi që në mënyrë të pavarur të vendosin për shpërndarjen e fondit vjetor të orëve, gjithmonë brenda numrit të përqindjes ose orëve të parapara për fushat brenda shkallës së caktuar. Po ashtu, mësimdhënësit kanë mundësi që brenda fushës së caktuar të vendosin për shpërndarjen e balancuar të orëve mësimore për lëndët që e përbëjnë atë fushë. Për këtë arsye, përpara se shkolla, mësimdhënësit, të shpërndajnë orët mësimore për fusha, kanë mundësi që në mënyrë të pavarur të vendosin për shpërndarjen e fondit javor të orëve në total, gjithmonë brenda numrit të përqindjes ose orëve të parapara për shkallë, p.sh. në shkallën e pestë (SHK5) për dy klasa (klasën e dhjetë dhe klasën e njëmbëdhjetë) ka gjithsej p.sh., 61 orë në javë, atëherë mësimdhënësi mund të vendosë në mënyrë autonome se sa orë në javë do të ketë në klasën e dhjetë, 30 apo 31 dhe sa në klasën e njëmbëdhjetë. Kështu, nëse shkolla, mësimdhënësit, mendojnë se në klasën e dhjetë (X) ka nevojë për 31 orë në total për javë, për të gjitha fushat, atëherë në klasën e njëmbëdhjetë (XI) ata duhet t' i përmbahen fondit të 30 orëve, në mënyrë që të mos tejkalohet fondi prej 61 orëve në javë për të dy klasat dhe për shkallën e pestë (SHK5). Ose mund të ndodhë e kundërta, që në klasën e dhjetë të vendoset fondi javor prej 30 orëve dhe në klasën e njëmbëdhjetë 31 orë, duke pasur gjithnjë në konsideratë moshën e nxënësve.

Klasa	Numri javor i orëve (AP)	Numri javor i orëve (AAP)
Klasa X	30	32
Klasa XI	30	32
Klasa XII	32	32

Plani mësimor për arsimin e mesëm të lartë bazohet në planin mësimor të përgjithshëm, që është përcaktuar në KKK. Në këtë nivel plani mësimor paraqitet me nga dy variante për secilin lloj të arsimit. Varianti A dhe A1, për arsimin e përgjithshëm (AP), dhe variantet B dhe B1, për arsimin dhe aftësimin profesional (AAP).

Varianti A të arsimit të përgjithshëm (gjimnazet) (AP), bazohet në përqindjen për fushë dhe numrin total të orëve për shkallët. Shkollat, mësimdhënësit pastaj mund t' i shpërndajnë për vite shkollore dhe për lëndë sipas planifikimit që ata duan, por gjithmonë duke pasur kujdes përqindjen e paraparë për fushë dhe duke ruajtur numrin total të orëve për të gjitha fushat për javë,

Varianti A (Gjimnazi i shkencave natyrore):

Shkolla e mesme e lartë (SNKA 3) Gjimnazi i shkencave natyrore						
Fushat kurrikulare	Shk.5				Shk.6	
	Klasa X	Klasa XI	Gjithsej orë		Klasa XII	
	Nr. orëve	Nr. orëve	Gj. Orë	%	Gj. Orë	%
Gjuhët dhe komunikimi - Gjuhë amtare - Gjuhë angleze -Gjuhë e dytë e huaj -Gjuhët e tjera	8	8	16	26.67	8	25.00
Artet - Edukatë muzikore - Edukatë figurative	1	1	2	3.33	1	3.13
Matematika	4	4	8	13.33	4	12.50
Shkencat natyrore - Fizikë - Kimi -Biologji - Astronomi	7	8	15	25.00	9	28.13
Shoqëria dhe mjedisi - Histori - Gjeografi - Ed. qytetare - Psikologji - Sociologji - Filozofi - Logjikë	4	3	7	11.67	4	12.50
Shëndeti dhe mirëqenia -Edukim shëndetësor -Edukatë fizike	2	2	4	6.67	2	6.25
Jeta dhe puna	1	1	2	3.33	1	3.13
Pjesa zgjedhore	3	3	6	10.00	3	9.38
TOTAL:	30	30	60	100.00	32	100.00

Varianti A (Gjimnazi i shkencave shoqëror gjuhësor):

Shkolla e mesme e lartë (SNKA 3) - Gjimnazi Shoqëror Gjuhësor

Fushat kurrikulare	Shk.5		Shk.6			
	Klasa X	Klasa XI	Gjithsej orë		Klasa XII	
	Nr. orëve	Nr. orëve	Gj. Orë	%	Gj. Orë	%
Gjuhët dhe komunikimi - Gjuhë amtare - Gjuhë angleze - Gjuhë e dytë e huaj - Gjuhët e tjera	8	8	16	26.67	8	25.00
Artet - Edukatë muzikore - Edukatë figurative	2	2	4	6.67	2	6.25
Matematika	4	3	7	11.67	3	9.38
Shkencat natyrore - Fizikë - Kimi - Biologji - Astronomi	3	3	6	10.00	3	9.38
Shoqëria dhe mjedisi - Histori - Gjeografi - Ed. qytetare - Psikologji - Sociologji - Filozofi - Logjikë	7	8	15	25.00	9	28.13
Shëndeti dhe mirëqenia - Edukim shëndetësor - Edukatë fizike	2	2	4	6.67	2	6.25
Jeta dhe puna	1	1	2	3.33	1	3.13
Pjesa zgjedhore	3	3	6	10.00	3	9.38
TOTAL:	30	30	60	100.00	32	100.00

Varianti A1 te arsimit i përgjithshëm – gjimnazet (AP) bazohet në përqindjen apo numrin e orëve mësimore totale për fushë për shkallët dhe në numrin specifik të përcaktuar të orëve për lëndë, për vite dhe për shkallë.

Varianti A1 (Gjimnazi i shkencave natyrore):

Shkolla e mesme e lartë (SNKA 3) - Gjimnazi Natyror										
Fushat kurrikulare	Lëndët mësimore	Shk.5					Shk.6			
		Klasa X		Klasa XI		Gjithsej orë		Klasa XII		
		Nr. orëve		Nr. orëve		Gj. Orë	%	Nr. oreve	Gj. Orë	%
Gjuhët dhe komunikimi	<i>Gjuhë amtare</i>	4		4		16	26.67	4		25.00
	<i>Gjuhë angleze</i>	2		2				2		
	<i>Gjuhë e dytë e huaj</i>	2	8	2	8			2	8	
	<i>Gjuhë e tretë e huaj</i>	-		-				-		
	<i>Gjuhët e tjera</i>	-		-				-		
Artet	<i>Edukatë muzikore</i>	0.5		0.5		2	3.33	0.5		3.13
	<i>Edukatë figurative</i>	0.5	1	0.5	1			0.5	1	
Matematika	<i>Matematikë</i>	4	4	4	4	8	13.33		4	12.50
Shkencat natyrore	<i>Fizikë</i>	3		3		15	25.00	2		28.13
	<i>Kimi</i>	2		3				2		
	<i>Biologji</i>	2	7	2	8			3	9	
	<i>Astronomi</i>							2		
Shoqëria dhe mjedisi	<i>Histori</i>	2		1		7	11.67	1		12.50
	<i>Gjeografi</i>	1		1				2		
	<i>Ed. qytetare</i>	1		0				0		
	<i>Psikologji</i>	0	4	1	3			0	4	
	<i>Sociologji</i>			0				1		
	<i>Filozofi</i>			0				0		
	<i>Logjikë</i>			0				0		
Shëndeti dhe mirëqenia	<i>Edukim shëndetësor</i> <i>Edukatë fizike</i>		2		2	4	6.67	2	2	6.25
Jeta dhe puna			1		1	2	3.33		1	3.13
Pjesa zgjedhore			3		3	6	10.00	3	3	9.38
TOTAL:			30		30	60	100.00		32	100.00

Varianti A1 (Gjimnazi i shkencave shoqëror gjuhësor):

Shkolla e mesme e lartë (SNKA 3) - Gjimnazi Natyror

Fushat kurrikulare	Lëndët mësimore	Shk.5				Shk.6				
		Klasa X		Klasa XI		Klasa XII				
		Nr. orëve		Nr. orëve		Gj. Orë	%	Nr. oreve	Gj. Orë	%
Gjuhët dhe komunikimi	<i>Gjuhë amtare</i>	4		4		16	26.67	4		28.13
	<i>Gjuhë angleze</i>	2		2				3		
	<i>Gjuhë e dytë e huaj</i>	2	8	2	8			2	9	
	<i>Gjuhë e tretë e huaj</i>	-		-				-		
	<i>Gjuhët e tjera</i>	-		-				-		
Artet	<i>Edukatë muzikore</i>	1		1		4	6.67	1		6.25
	<i>Edukatë figurative</i>	1	2	1	2			1	2	
Matematika	<i>Matematikë</i>	3	3	3	3	6	10.00		3	9.38
Shkencat natyrore	<i>Fizikë</i>	2		1		7	11.67	1		9.38
	<i>Kimi</i>	1	4	1	3			1	3	
	<i>Biologji</i>	1		1				1		
Shoqëria dhe mjedisi	<i>Histori</i>	3		2		15	25.00	2		28.13
	<i>Gjeografi</i>	2		2				2		
	<i>Ed. qytetare</i>	2		0				0		
	<i>Psikologji</i>	0	7	2	8			0	9	
	<i>Sociologji</i>	0		2				1		
	<i>Filozofi</i>	0		0				2		
	<i>Logjikë</i>	0		0				2		
Shëndeti dhe mirëqenia	<i>Edukim shëndetësor</i>		2		2	4	6.67		2	6.25
	<i>Edukatë fizike</i>									
Jeta dhe puna			1		1	2	3.33		1	3.13
Pjesa zgjedhore			3		3	6	10.00		3	9.38
TOTAL:			30		30	60	100.00		32	100.00

Varianti B për AAP-në bazohet në përqindjen për fushë dhe numrin total të orëve për shkallët. Shkolat, mësimdhënësit pastaj mund t'i shpërndajnë për vite shkollore dhe për lëndë, sipas planifikimit që ata duan, por gjithmonë duke pasur kujdes përqindjen e paraparë për fushë dhe duke ruajtur numrin total të orëve për të gjitha fushat për javë. Karakteristikë e këtij varianti është se në disa fusha mësimi realizohet si lëndë e integruar, kurse në disa fusha me lëndë të ndara. Ndërkaq, pjesa të fusha Jeta dhe puna mund të organizohet përmes lëndëve, kurseve apo moduleve profesionale, varësisht nga drejtimit dhe profilet e shkollave.

Varianti B1 për AAP-në bazohet në përqindjen për fushë dhe për lëndë mësimore (për ato fusha ku mësimi realizohet me lëndë të ndara, fusha Gjuhët dhe komunikimi dhe Shëndeti dhe mirëqenia) në harmoni me numrin total të orëve për shkallët. Kurse në ato fusha ku realizohet mësim i integruar shkollat, mësimdhënësit, kanë lirinë për t'i shpërndarë orët për vite shkollore dhe për lëndë sipas planifikimit që ata duan, por gjithmonë duke pasur kujdes përqindjen e paraparë për fushë dhe duke ruajtur numrin total të orëve për të gjitha fushat për javë.

Tabela e orëve:

Fushat kurrikulare	Shkolla e mesme e lartë (SNKA 3) Shkollat profesionale					
	Shk.5				Shk.6	
	Klasa X	Klasa XI	Gjithsej orë		Klasa XII	
	Nr. orëve	Nr. orëve	Gj. Orë	%	Gj. Orë	%
Gjuhët dhe komunikimi						
- Gjuhë amtare	5	5	10	15.63	5	15.63
- Gjuhë angleze						
- Gjuhë e dytë e hua						
Artet						
- Edukatë muzikore			0	0.00		0.00
- Edukatë figurative						
Matematika	3	3	6	9.38	3	9.38
Shkencat natyrore						
- Fizikë						
- Kimi	2	2	4	6.25	2	6.25
- Biologji						
Shoqëria dhe mjedisi						
- Histori						
- Gjeografi	2	2	4	6.25	1	3.13
- Ed. qytetare						
Shëndeti dhe mirëqenia						
- Edukimi shëndetësor	2	2	4	6.25	2	6.25
- Edukatë fizike						
Jeta dhe puna	15	15	30	46.88	16	50.00
Pjesa zgjedhore	3	3	6	9.38	3	9.38
TOTAL:	32	32	64	100.00	32	100.00

Në shkollat profesionale, varësisht nga profilet, shkollat vendosin për shpërndarjen e orëve, por gjithmonë duke pasur parasysh përqindjen e orëve sipas fushave në shkallë kurrikulare. Përqindja e orëve të fusha Jeta dhe puna së bashku me orët nga mësimi zgjedhor duhet të mbetet afër 60%.

4. Kriteret për hartimin e planit mësimor

Me qëllim që plani mësimor të jetë funksional në zhvillimin e kompetencave të parapara me KKK, mësimdhënësit duhet të kenë parasysh disa kriteret:

- Përqindjen totale të dhënë në planin mësimor për secilën fushë kurrikulare për një shkallë kurrikulare
- Numrin javor të orëve për një klasë
- Rezultatet e të nxënësve për fushë kurrikulare që duhet të zotërojnë nxënësit gjatë një shkalle kurrikulare
- Rezultatet e të nxënësve për shkallë kurrikulare
- Mundësitë psikofizike dhe intelektuale të nxënësve
- Parapërgatitjet dhe përvojat e nxënësve dhe
- Kriteret e tjera që shkolla i sheh të nevojshme (si, p.sh., për arritjen e rezultateve, mbajtja e orëve shtesë ose forma të tjera të punës, të cilat i përcakton shkolla)

5. Zbatimi i planit mësimor

Zbatimi i Kurrikulës përmes planprogrameve dhe praktikave në klasë do t'i marrë parasysh edhe mënyrat inovative dhe fleksibile të caktimit të fondit të orëve, si:

- mësimdhënia në bllok, për shembull, për një semestër për lëndët për të cilat nuk kërkohet sekuencë rigoroze (p.sh., mund të mësohet me shkëputje, nuk nevojitet vazhdimësi);
- mësimdhënia në bllok bëhet atëherë kur nevojitet kohë për zhvillim të ndonjë aktiviteti të caktuar në mënyrë të pandërprerë apo ndonjë vizite studimore në rajonin në të cilin vepron shkolla;
- orët bllok brenda javës mund të organizohen me kohëzgjatje 80-90 minuta në vend të orës mësimore 40-45 minuta, në funksion të zbatimit të pedagogjive (metodave) ndërvepruese;
- fondi i orëve për mësimdhënie në bllok për mësimin dhe aftësimin praktik në shkollat profesionale.

6. Autonomia e shkollës

Shkollat do të mund të vendosin, në bashkëpunim me prindërit dhe palët e tjera, për shfrytëzimin në mënyrë inovative dhe fleksibile të kohës së mësimdhënies dhe nxënies si bazë për hartimin e programeve mësimore me bazë shkollën, të cilat përkojnë me nevojat e nxënësve, me kontekstin dhe me interesat e tyre.

Pjesa e Kurrikulës me bazë shkollën (midis 10%-14% të kohës së shkollës) do t'i marrë parasysh disa opsione, përmes të cilave mund të përkufizohet autonomia e shkollës, si:

- aktivitetet shpesh të mësimdhënies dhe nxënies, që mund të ndihmojnë në arritjen e kompetencave specifike (d.m.th., të lëndëve zgjedhore, projekteve, shërbimeve për bashkësinë, aktiviteteve artistike dhe sportive);
- përforcimi i njohurive, i shkathtësive dhe i qëndrimeve në fusha të caktuara mësimore;
- adoptimi i temave/kurseve/moduleve opsionale të ofruara prej MASHT-it;
- zhvillimi i aktiviteteve specifike të shkollës, të cilat i përcaktojnë projektet shkollore (si: mësimdhënia dhe nxënia e gjuhëve, TIK-u, orientimi në karrierë);
- zhvillimi dhe zbatimi i Kurrikulës së modifikuar në raport me kushtet lokale, mjetet dhe nevojat;
- përforcimi i orientimit në karrierë dhe përgatitja për jetë dhe për punë.

LËNDËT NË KUADËR TË SHKALLËVE TË KURRIKULËS 5 DHE 6

Në Kurrikulën e re për ShK5 dhe 6 në secilën fushë të Kurrikulës paraqiten një numër lëndësh apo fushash mësimore, të cilat janë pikë organizative e Kurrikulës. Ato janë paraqitur në tabelën më poshtë. Të shtatë fushat e Kurrikulës përbëjnë bazën për përcaktimin e lëndëve dhe të programeve përkatëse të mësimin (shih versionin e miratuar në shqip të KKK-së, f. 32, në aneksin 5).

Fushat e Kurrikulës	SHKALLËT E KURRIKULËS			
	ShK 5		ShK6	
	Klasa X dhe XI (Arsimi i përgjithshëm)	Klasa X dhe XI (Arsimi dhe aftësimi profesional)	Klasa XII (Arsimi i përgjithshëm)	Klasa XII (Arsimi dhe aftësimi profesional)
Gjuhët dhe të shprehurit	Gjuhë amtare Gjuhë angleze Gjuhë e dytë Gjuhë të tjera	Gjuhë amtare Gjuhë angleze Gjuhë të tjera	Gjuhë amtare Gjuhë angleze Gjuhë e dytë Gjuhë të tjera	Gjuhë amtare Gjuhë angleze Gjuhë të tjera
Artet	Edukatë figurative Edukatë muzikore	Arte aplikative	Edukatë figurative Edukatë muzikore	Arte aplikative
Matematika	Matematikë	Matematikë	Matematikë	Matematikë
Shkencat	Biologji Fizikë Kimi	Shkencat natyrore	Biologji Fizikë Kimi Astronomi	Shkencat natyrore
Shoqëria dhe mjedisi	Histori Gjeografi Edukatë qytetare Sociologji Psikologji Filozofi	Shoqëria dhe mjedisi	Histori Gjeografi Edukatë qytetare Sociologji Psikologji Filozofi	Shoqëria dhe mjedisi
Shëndeti dhe mirëqenia	Shëndeti dhe mirëqenia Edukatë fizike	Shëndeti dhe mirëqenia Edukatë Fizike	Shëndeti dhe mirëqenia Edukatë fizike	Shëndeti dhe mirëqenia Edukatë fizike
Jeta dhe puna	Jeta dhe puna	Jeta dhe puna	Jeta dhe puna	Jeta dhe puna

Gjuhë të tjera - Nxënësit mund të zgjedhin mes gjuhëve ndërkombëtare (përveç anglishtes) dhe atyre të fqinjëve, në pajtim me listën e miratuar të MASHT-it dhe të ofertës së shkollës, të miratuar nga këshilli i shkollës. Nxënësit e bashkësive të tjera, përveç shqiptarëve dhe serbëve, do ta kenë mundësinë që ta mësojnë njëren prej gjuhëve zyrtare, d.m.th. shqip ose serbisht nga klasa III.

KURRIKULA ZGJEDHORE PËR NIVELINË TRETË

Shqipëri

Shqipëri

Shqipëri dhe Kosovë

Shqipëri

Shqipëri dhe Kosovë

Shqipëri dhe Kosovë

Shqipëri



V.

KURRIKULA ZGJEDHORE PËR NIVELIN E TRETË

Koncepti

Qëllimi

Përmbajtja dhe realizimi

Struktura

Procedurat për hartimin e Kurrikulës Zgjedhore

Procedurat për zgjedhjen e lëndës zgjedhore

Zbatimi

1. Koncepti

Kurrikula Zgjedhore është pjesë e Kurrikulës së përgjithshme, e cila, ndryshe nga Kurrikula Bërthamë, përcaktohet nga shkolla dhe zhvillohet brenda kohës së planifikuar me planin mësimor në përputhje me interesimet, potencialet, mundësitë, informacionet paraprake të nxënësve dhe me mundësitë e shkollës.

2. Qëllimi

Kurrikula zgjedhore është në funksion të arritjes së kompetencave kryesore për shkallë dhe për fusha kurrikulare për:

- thellimin dhe zgjerimin e njohurive, aftësive dhe qëndrimeve të lëndëve të Kurrikulës Bërthamë;
- përforcimin e njohurive, aftësive dhe qëndrimeve të lëndëve të Kurrikulës Bërthamë;
- plotësimin e interesimeve dhe nevojave specifike të nxënësve sipas moshës, komunitetit dhe vendit.
-

3. Përmbajtja dhe realizimi

Kurrikula zgjedhore përmban lëndë mësimore që realizohen përmes:

- lëndëve të veçanta,
- moduleve,
- projekteve,
- njësive tematike (të lëndës së Kurrikulës Bërthamë dhe të temave ndërkurrikulare).
-

4. Struktura e Kurrikulës zgjedhore

Kurrikula zgjedhore ka strukturë të njëjtë me Kurrikulën Bërthamë. Ajo përfshin:

- Hyrje
- Arsyeshmëria dhe përshkrimi
- Konceptet dhe përshkrimi
- Qasja e bazuar në kompetenca
- Rezultatet e të nxënësve të fushës
- Çështjet ndërkurrikulare
- Ndarja e kohës – përshkrimi
- Udhëzime metodologjike
- Udhëzime për vlerësim (realizohet si vlerësim i mbrendshëm dhe nuk përfshihet në vlerësim të jashtëm)
- Materialet dhe burimet mësimore

5. Procedura për hartimin e Kurrikulës zgjedhore

Procedurat për hartimin e Kurrikulës zgjedhore (lëndës me zgjedhje), bazohen në Udhëzuesin për mësimdhënës, të hartuar nga MASHT-i.

6. Procedura për zgjedhjen e lëndës me zgjedhje

Për procedurën e zgjedhjes së lëndës zgjedhore, është i domosdoshëm respektimi i hapave të përcaktuar në Udhëzimin Administrativ të Kurrikulës Zgjedhore të hartuar nga MASHT-i.

7. Zbatimi

Lënda me zgjedhje, prej momentit kur zgjidhet nga ana e nxënësve dhe miratohet nga organet përkatëse, ka status të njëjtë me lëndët e Kurrikulës Bërthamë, d.m.th. është e detyrueshme për të gjithë nxënësit që e përzgjedhin.

Periudha mësimore duhet të zgjasë jo më pak se një gjysmëvjetor.

Kurrikula zgjedhore monitorohet, vlerësohet (me status të veçantë) dhe evidentohet me kritere e parime të njëjta me ato të Kurrikulës Bërthamë.

Udhëzimet e mëtejme të lëndës zgjedhore përcaktohen me Udhëzimin për mësimdhënës të Kurrikulës

VI.

METODOLOGJIA E PËRGJITHSHME - UDHËZIME

Hyrje

Përkufizimi

Ndërlidhja e rezultateve të fushave kurrikulare dhe rezultateve të nxënies për shkallë

Mësimdhënia dhe nxënia me nxënësin në qendër dhe gjithëpërfshirjen

Mësimdhënia dhe nxënia e bazuar në qasjen e integruar

Mësimdhënia dhe nxënia e bazuar në kompetenca

Mësimdhënia dhe nxënia e diferencuar

Çështjet ndërkurrikulare

dhe

Çështjet jashtëkurrikulare

1. Hyrje

Parimet e përgjithshme për zbatimin e KKK-së, në përgjithësi, dhe të KB-së, në veçanti, duhet të përvijohen sipas metodologjisë për arritjen e synimeve të përgjithshme të përcaktuara me dokumentet dhe politikat arsimore. Në të gjitha dokumentet dhe politikat arsimore, të hartuara kohët e fundit në Kosovë, synohet të promovohen vlerat e përgjithshme shoqërore, mbrojtja e të drejtave të njeriut, gjithëpërfshirja në arsim, respektimi i vlerave të njëri-tjetrit si dhe zhvillimi i individit sipas aftësive dhe nevojave të tij për qytetar aktiv.

2. Përkufizimi

Nuk ekziston një metodologji e veçantë e mësimdhënies dhe e nxënies për zbatimin e KB-së apo zbatimin e kurrikulës së një fushe arsimore. Secila fushë e Kurrikulës dhe secila lëndë mësimore ka veçantitë për realizimin e synimeve të paravendosura. Prandaj, këtë metodologji të përgjithshme mund ta përkufizojmë si një sistem të strategjive, të metodave, të mënyrave e parimeve, mjeteve e teknikave, të cilat na shërbejnë si bazë për ndërtimin e konceptit të mësimi ose për organizimin e dhënies së mësimi në shkollë. Me qëllim të përkrahjes dhe ndihmës për mësuesit/edukatorët parafillorë dhe mësuesit e arsimit fillor, në pjesën në vijim do të ofrohen udhëzime të përgjithshme metodologjike lidhur me aspektet¹ e:

- ndërlidhjes së rezultateve të nxënies për shkallë, me rezultatet e të nxënit për fusha kurrikulare/mësimore;
- mësimdhënies dhe nxënies me nxënësin në qendër dhe gjithëpërfshirjen;
- mësimdhënies dhe nxënies, të bazuar në qasjen e integruar;
- mësimdhënies dhe nxënies, të bazuar në kompetenca;
- mësimdhënies dhe nxënies së diferencuar;
- çështjeve ndërkurrikulare dhe
- çështjeve jashtëkurrikulare.

3. Ndërlidhja e rezultateve të të nxënit për shkallë me rezultatet e fushave kurrikulare/mësimore

Për t'i arritur kompetencat kryesore të KKK-së, MASHT-i fton mësuesit që në praktikën e mësimdhënies dhe të nxënies të ndërlidhin rezultatet e të nxënit për shkallë me rezultatet e të nxënit të fushave kurrikulare/mësimore.

Mësuesi, për të realizuar në praktikë këtë ndërlidhje duhet të krijojë “pako”/set/ të metodave, teknikave dhe të mjeteve didaktike për arritjen e secilit rezultat të të nxënit apo secilës kompetencë. Pakoja e tillë, duhet të jetë transparente për çdo ditë dhe për çdo orë mësimore para mësuesit, para nxënësve dhe para prindërve. I gjithë ky material duhet të përfshihet në dosjen e mësuesit.

Pavarësisht metodës së zgjedhur, teknikës dhe mjeteve didaktike, për të bërë ndërlidhjen e rezultateve të të nxënit për shkallë me rezultatet e të nxënit të fushave kurrikulare/mësimore, mësuesi duhet ndjekë hapat në vijim:

- saktëson, përzgjedh rezultatin/et e të nxënit për shkallë, që synon të arrijë me nxënësit;²
- rezultatin e të nxënit për shkallë e zbërthen në rezultat specifik për klasë;
- saktëson, përzgjedh rezultatin/et e të nxënit të fushës kurrikulare/mësimore që ndihmon në arritjen e rezultatit të të nxënit për shkallë;³
- rezultatin e të nxënit për fushë kurrikulare e zbërthen në rezultatet specifik për klasë;

1 Udhëzime specifike për të gjitha aspektet kryesore të këtij kapitulli do të pasqyrohen në kuadër të udhëzimeve për fushat mësimore, si dhe në udhëzuesit për mësimdhënies dhe drejtues të shkollës.

2. (kujto: rezultatet për shkallë janë hartuar nga shteti dhe realizohen nëpërmjet të gjitha fushave kurrikulare);

3. (kujto: rezultatet e të nxënit për fusha kurrikulare/mësimore janë hartuar nga shteti);

- përzgjedh përmbajtjen/et mësimore, mjetet didaktike, metodologjinë e mësimdhënies dhe nxënies, përmes të cilave realizon rezultatet specifike të fushës së Kurrikulës për klasë dhe rezultatet specifike të të nxënies për klasë;
 - planifikon mësimdhënien dhe nxënien duke përfshirë periudhën kohore, kur do t'i arrijë rezultatet specifike të të nxënies për klasë brenda viti shkollor.
- Pas realizimit të orëve mësimore, detyrës, kapitullit, analizohet, vlerësohet ecuria e tyre për të verifikuar arritjet e rezultateve të të nxënies për fushë kurrikulare.

4. Mësimdhënia dhe nxënia me nxënësin në qendër dhe gjithëpërfshirja

Zbatimi i qasjes së mësimdhënies dhe nxënies me nxënësin në qendër kërkon që procesi i planifikimit dhe i organizimit të mësimdhënies dhe nxënies të mbështetet në përvojat individuale të nxënësve, në potencialet, nevojat dhe interesimet e tyre.

Mësimdhënia dhe nxënia me nxënësin në qendër, duhet të mbështetet në parimin e gjithëpërfshirjes, i cili merr parasysh dhe adreson stilet e ndryshme të të nxënies, mënyrën dhe shpejtësinë me të cilën mësojnë nxënësit, si dhe aspektet e tjera të diversitetit të nxënësve, duke përfshirë gjininë, moshën, kulturën, prejardhjen shoqërore dhe ekonomike, si dhe nevojat e veçanta të nxënësve, qoftë për aspektet e nxënies plotësuese qoftë për ato të nxënies shtuese.

Mësuesit kanë mundësi që në mënyrë të pavarur, duke u mbështetur në ekspertizën e tyre dhe në përvojat individuale paraprake të nxënësve, në nevojat dhe interesimet e tyre, të përzgjedhin strategjitë, metodat, teknikat e mësimdhënies dhe të nxënies, mjetet didaktike, etj., por në parim përzgjedhja e tyre duhet të ketë pikësynim mësimdhënien dhe nxënien me nxënësin në qendër dhe gjithëpërfshirjen. Kjo do të thotë se mësuesi duhet të respektojë parimet e mësimdhënies dhe nxënies me nxënësin në qendër, ku:

- nxënësi është në qendër të mësimdhënies dhe të nxënies;
- mësuesi gjatë punës/aktivizimit të nxënësve, mbikëqyr, ndihmon dhe lehtëson të nxënies e nxënësve;
- nxënësi është pjesëmarrës aktiv dhe i angazhuar/i përfshirë në aktivitetet që nxisin nxënien dhe interesimin e nxënësve;
- temat e nxënies janë relevante dhe interesante për nxënësit;
- nxënësit inkurajohen të bëhen përgjegjës, të pavarur e reflektivë dhe të vazhdojnë nxënien gjatë gjithë jetës së tyre;
- mësuesi ndjek ndryshimet individuale të nxënësve përmes vrojtimit dhe bashkëveprimit;
- aktivitetet mësimore përshtaten në bazë të nivelit zhvillimor të nxënësve;
- mësimdhënia dhe vlerësimi planifikohen duke pasur parasysh zhvillimin individual dhe stilet e nxënies së nxënësit;
- ofrohen llojllojshmëri të mundësive të nxënies dhe të metodave të vlerësimit, për të përkrahur stilet e ndryshme të nxënies së nxënësit;
- vrojtimit dhe vlerësimet e nxënësve përdoren për të planifikuar mësimdhënien e mëtejshme.

Është me rëndësi që çdo mësues të jetë në gjendje të shfrytëzojë një gamë të gjerë të metodave mësimore, duke baraspeshuar metodologjinë e përqendruar tek mësuesi dhe atë të përqendruar tek nxënësin, duke iu përshtatur nxënësve dhe rezultateve të të nxënies të përcaktuara për secilën orë mësimi.

5. Mësimdhënia dhe nxënia e bazuar në qasjen e integruar

Lëndët mësimore, duke qenë të ndara nga njëra-tjetra, ofrojnë mundësi që nxënësit të fitojnë njohuri, shkathtësi, qëndrime të fragmentuara (të shpëputura). Me qëllim të integritetit të këtyre aspekteve, Kurrikula Bërthamë për klasën parafillore dhe arsimin fillor, realizohet përmes lëndëve mësimore të integruara në fusha të Kurrikulës dhe përmes mësimdhënies e nxënies së bazuar në qasjen e integruar.

Mësimdhënia dhe nxënia e bazuar në qasjen e integruar ndërlihdh përmbajtjet e veçanta të lëndëve mësimore me qëllim të arritjes së rezultateve në të nxëniet e fushave mësimore me rezultatet e të nxëniet të kompetencave kryesore – për shkallë dhe nivele.

Për t'i përmbushur kërkesat e KKK-së dhe të Kurrikulës Bërthamë për SNKA 1, MASHT-i fton mësuesit parafillore dhe fillorë që të zbatojnë mësimdhënien dhe nxënien e bazuar në qasjen e integruar, duke bërë:

- ndërlihdhjen ndërmjet fushave kurrikulare/mësimore, ku përmbajtjet e veçanta mësimore kontribuojnë në zhvillimin e kompetencave kryesore;
- ndërlihdhjen midis rezultateve të të nxëniet të fushave kurrikulare me rezultatet e të nxëniet për shkallë dhe nivele, me qëllim që aplikimi i njohurive, i shkathtësive, i qëndrimeve dhe i vlerave të jetë i ndërlihdhur me situata konkrete nga jeta e përditshme;
- integritetin në mësimdhënie dhe në nxënie të karakteristikave të përbashkëta të lëndëve të fushës përkatëse (p.sh., të gjuhës amtare me gjuhën angleze) apo të karakteristikave të përbashkëta të fushave kurrikulare (p.sh., të fushës Shoqëria dhe mjedisi me fushën Shkencat natyrore);
- aktivitete me nxënës që të zhvillojnë kompetencat për të gjetur dhe për të përpunuar informata në mënyrë efektive dhe të përgjegjshme, për shfrytëzimin e mësimin elektronik, të teknologjive aktuale dhe të ardhme në epokën digjitale;
- aktivitete me nxënës që promovojnë perspektivën e mësimin tërëjetësor dhe të cilat i ndihmojnë nxënësit që të zhvillojnë kompetencat e tyre për t'u ballafaquar me sfidat dhe mundësitë brenda zhvillimeve në shoqërinë dhe në ekonominë e sotme dhe të ardhshme.

6. Mësimdhënia dhe nxënia e bazuar në kompetenca

KKK-ja promovon perspektivën e bazuar në kompetenca me qëllim që njohuritë e nxënësve, aftësitë dhe qëndrimet e tyre të zhvillohen në funksion të arritjes së kompetencave kryesore dhe me qëllim të adresimit të nevojave të ndryshme të nxënësve për të përmbushur kërkesat e kurrikulës dhe rezultatet kryesore të të nxëniet për shkallë dhe nivele.

Mësimdhënia dhe nxënia e fokusuar dhe e orientuar në kompetenca, nga mësuesit kërkon që të bëjnë përzgjedhjen dhe organizimin e përvojave mësimore të cilat integrojnë njohuritë relevante me vlerat, qëndrimet dhe shkathtësitë e nxënësve. Mësimdhënia dhe nxënia e bazuar në kompetenca për bazë ka rezultatet mësimore, të cilat përshkruajnë se çka është në gjendje nxënësi të dijë, të bëjë, të kuptojë, të vlerësojë dhe të marrë qëndrim lidhur me përfundimin e suksesshëm të një shkalle të Kurrikulës.

MASHT-i fton mësuesit që, duke u mbështetur në rezultatet mësimore për fusha kurrikulare dhe për shkallë/nivel, të planifikojnë mësimdhënien dhe nxënien me synime për të arritur kompetencat e parapara në Kurrikulë për nivelin përkatës të arsimit, duke e zërthyer planifikimin në plane vjetore, mujore dhe ditore të çdo mësuesi. Gjithashtu, MASHT-i fton mësuesit të zbatojnë mësimdhënie dhe nxënie interaktive, ku mësuesi më pak shpjegon dhe më shumë u ndihmon nxënësve si të mësojnë dhe si t'i zhvillojnë kompetencat e tyre të të nxëniet.

Mësimdhënia dhe nxënia e bazuar në kompetenca kërkon që mësuesit të përzgjedhin strategji, metoda, teknika dhe forma të ndryshme të punës me nxënës, si dhe të organizojnë përvojat mësimore të nxënësve që integrojnë njohuritë relevante me shkathtësitë, vlerat dhe qëndrimet.

Mësimdhënia dhe nxënia e bazuar në kompetenca është e lidhur ngushtë edhe me procesin e vlerësimit, me

fokus të veçantë me vlerësimin formativ dhe progresiv. Për të vlerësuar kompetencat e nxënësve, është e rëndësishme që secili mësues të përzgjedhë teknika dhe instrumente për vlerësim, të cilat u mundësojnë nxënësve të

demonstrojnë e të shpërshfaqin njohuritë, shkathtësitë dhe aftësitë e tyre, e jo vetëm njohuritë faktike. Në këtë mënyrë mësuesit sigurojnë informacion për cilësinë e mësimdhënies dhe të nxënies, përparimin e nxënësve dhe zhvillimin e kompetencave.

Ka disa qasje dhe strategji të cilat mundësojnë që mësimdhënia dhe nxënia e bazuar në kompetenca të jetë e suksesshme dhe që të ndihmojë zhvillimin e kompetencave të nxënësit, pa marrë parasysh fushën e Kurrikulës. Vlen për t'i veçuar tri qasje nga më të rëndësishmet që mbështesin parimet e KKK-së, pra edhe qasjen e bazuar në kompetenca:

- Krijimi i mjedisit të përshtatshëm, në klasë dhe në shkollë, në të cilin nxënësit ndihen të mirëpritur dhe të lidhur me njëri-tjetrin, me mësuesin e tyre dhe shkollën e tyre;
- Zhvillimi i mësimëve nëpërmjet qasjeve dhe teknikave të të nxënësve aktiv;
- Zbatimi i strategjive të mësimdhënies dhe të nxënies, zgjidhjes së problemeve dhe zhvillimit të të men duarit kritik.

7. Mësimdhënia dhe nxënia e diferencuar

Mësimdhënia dhe nxënia e diferencuar paraqesin një qasje sipas së cilës mësimdhënia, për zhvillimin e kapaciteteve të të gjithë nxënësve, mbështetet në planifikim, në zbatim, në kontroll, në përkrahje dhe në vlerësim.

Mundëson përfilljen e dallimeve ekzistuese ndërmjet nxënësve në klasë përkthazi me përmbajtjen që do të mësojnë, ecurinë didaktike-metodike të të nxënësve si dhe matjet dhe materialet çfarë duan dhe mund të shfrytëzojnë gjatë mësimin.

Përmes mësimin të diferencuar mundësohet përshtatja e kohës dhe e shpejtësisë së të nxënësve dhe të të mësuarit me veçoritë individuale të secilit nxënës.

Gjithashtu, edhe përshtatja e vëllimit, llojit dhe shkallës së vështirësisë së përmbajtjeve, detyrave dhe obligimeve me veçoritë individuale të nxënësve.

Mësuesi, për ta organizuar dhe për ta zbatuar në mënyrë të suksesshme mësimdhënien dhe nxënien e diferencuar, duhet të mbështetet në motivet, në aftësitë, në interesimet dhe në stilet e të nxënësve nga nxënësit. Këto janë aspektet kryesore në të cilat mësuesi duhet ta mbështesë mësimdhënien dhe nxënien e diferencuar.

Mësuesit e nivelit të parë të arsimit, për organizimin dhe zbatimin me sukses të mësimdhënies dhe të nxënies së diferencuar duhet të:

- bëjnë forma të organizimit mësimor, të cilat promovojnë dhe ndihmojnë zhvillimin e motivimit të brendshëm të nxënësve dhe të mekanizmave të vetëkontrollit të nxënies;
- përdorin me efikasitet aktivitetet me nxënës të cilat promovojnë nxënien e organizuar;
- organizojnë procesin mësimor përmes qasjeve të ndryshme të cilat mundësojnë dhe lehtësojnë hulumtimin dhe identifikimin e përvojave ekzistuese të nxënësve, të njohurive, të pikëpamjeve të tyre dhe të cilat mundësojnë përfshirjen aktive të nxënësve në përmirësimin e gabimeve të mundshme, si dhe që përkrahin nxënësit që të riorganizojnë njohuritë e tyre faktike dhe procedurale për arritjen e kompetencës së nxënësit për të nxënë;
- përdorin teknika dhe forma të ndryshme të nxënies bashkëpunuese në procesin mësimor;
- praktikojnë format e ndryshme organizative të mësimdhënies dhe nxënies (aktivitetet në klasë, puna në grupe, puna në çifte, nxënia individuale), që fokusohen në aktivitetet që zhvillojnë vetëbesimin, iniciativën, zgjidhjen e problemeve dhe kreativitetin e nxënësve;

- organizojnë mësimdhënien dhe nxënien përmes diferencimit në detyra, përmeshja e tyre, kontrolli, vlerësimi dhe shkalla e ndihmës që ofrohet prej mësuesit i përshtatet secilit nxënës;
- aplikojnë teknika të organizimit të mësimi që i përshtaten një detyre të caktuar përmes së cilës zhvillojnë aftësitë e veçanta të nxënësve të favorizuar;
- përdorin forma të ndryshme për organizimin e nxënies për nxënësit të cilët kërkojnë trajtim të veçantë, kanë nevojë të veçanta arsimore, duke përfshirë edhe nxënësit me vështirësi në të nxënë ose me probleme në sjellje;
- organizojnë mësimdhënien përmes së cilës ndihmojnë bashkëpunimin dhe përdorimin e formave organizative (p.sh., gjithëpërfshirjen) që i promovojnë mundësitë e barabarta për nxënien, si në sferën e bashkëpunimit mes nxënësve në aktivitetet brenda klasës dhe shkollës, ashtu edhe jashtë saj;
- përdorin teknologji të ndryshme mësimore, të cilat ofrojnë mundësi më të mëdha të organizimit të avancuar të mësimdhënies dhe të nxënies me anën e të cilave procesin mësimor e bëjnë më tërheqës për nxënësit.

8.Çështjet ndërkurrikulare

Kurrikula Bërthamë për klasën parafillore dhe për klasat fillore përfshin hapësirë për mësim përtej kufijve lëndorë në atë mënyrë që fëmijët/nxënësit të mund të ndërtojnë lidhje mes fushave të Kurrikulës dhe lëmenjve të ndryshëm.

Studimet ndërëndore, të bazuara në grupimin e përvojave dhe të rezultateve të fushave të ndryshme të Kurrikulës, dhe çështjet ndërkurrikulare duhet të ofrojnë përvoja relevante, sfiduese dhe që sjellin kënaqësi në kontekstin e përmeshjes së nevojave dhe të kërkesave të ndryshme të fëmijëve dhe të rinjve.

Krijimi i ndërlidhjeve ndërmjet fushave kurrikulare krijon mundësi për progres në zhvillimin e shkathtësive të nxënësve, për njohjen dhe të kuptuarit e koncepteve të reja apo për rishikimin dhe përforcimin e koncepteve apo të shkathtësive nga perspektiva të ndryshme. Gjithashtu, kjo qasje ndihmon që kurrikula të jetë koherente dhe më kuptimplotë nga pikëpamja e nxënësit.

Integrimi i çështjeve ndërkurrikulare në Kurrikulën Bërthamë për klasën parafillore dhe klasat fillore mund të realizohet përmes:

- gjetjes së korrelacioneve midis lëndëve/temave apo njësive mësimore me qëllim të realizimit të ndonjëres nga kompetencat e KK-së, p.sh., nëse tema mësimore është nga mbrojtja e mjedisit, ajo ndërlidhet edhe me çështje gjuhësore, letrare, por edhe me matematikë, edukatë qytetare etj. Pra, ka mundësi të shumta për të gjetur kësi ndërlidhesh nëpërmjet të cilave arrihen disa objektiva mësimore të fushave të ndryshme kurrikulare;
- formës së projekteve individuale apo kurseve me zgjedhje, në të cilat ndërlidhen, duke ndihmuar njëra-tjetrën, tema apo fusha të ndryshme, si, p.sh., projekte në fushën edukimit qytetarë me udhëzim në karrierë etj., të cilat gjithashtu ndihmojnë realizimin e kompetencave të veçanta.

9.Çështjet jashtëkurrikulare

Janë aktivitete të strukturuar mësimore që ndodhin jashtë kontekstit të fushave dhe lëndëve mësimore formale, por që e ndihmojnë arritjen e kompetencave për shkallë të Kurrikulës dhe nivele formale të arsimit. Për secilin nga aktivitetet e mundshme, mësuesi dhe shkolla duhet të përgatisin plan dhe program të qëllimshëm, të orientuar, e jo aktivitete stihike apo të rastit.

Në klasën parafillore dhe klasat fillore, mësimdhënia dhe mësimnxënien në fushat e ndryshme të Kurrikulës do të mbështeten me anë të aktiviteteve jashtëkurrikulare të organizuara për nxënës, si:

- Vizitat në muze, në parqe, në vende në natyrë dhe në vende historike, në institucione, në galeri, në teatër etj.;
- Festimet në data të veçanta, në ngjarje, në tradita, në suksese;
- Pjesëmarrja në vendimmarrje në shkollë dhe në format e tjera të demokracisë së shkollës;
- Pjesëmarrja në grupe mësimore, në aktivitete të lira dhe në shoqata;
- Diskutimet me mysafirët (d.m.th., me udhëheqësit e bashkësisë, me prindërit, me përfaqësuesit e

bizneseve lokale, me politikanë, me njerëz të medias);

- Puna me projekte që fokusohen në tema dhe në çështje specifike të karakterit shumëdimensional që përkojnë me moshën e nxënësve;
- Ekspozitat (d.m.th. artet e bukura, fotografia);
- Shërbimet për bashkësinë (d.m.th. ndihma për personat në nevojë, mbrojtja e mjedisit, forcimi i lidhjeve midis gjeneratave);
- Lojërat, koret, revistat e shkollës;
- Puna vullnetare.

Rekomandohet që të gjithë nxënësve t'u mundësohet të përfshihen në çështje jashtëkurrikulare, sipas preferencave dhe talentit personal të jenë pjesë e një grupi në aktivitete të ndryshme: ekupe sporti, grup muzikor, ansambël vallëzimi, kor, ansambël teatri, grup për ofrimin e mbështetjes për bashkësinë.

Vlerësimi – vëzhgime të përgjithshme

1.1.1

1.1.2

1.1.3

1.1.4

1.1.5

SYLLABU I

VII.

Vlerësimi – udhëzime të përgjithshme

Hyrje

Qëllimet e vlerësimit

Parimet themelore të vlerësimit

Vlerësimi i brendshëm

Vlerësimi i jashtëm

1. Hyrje

Qëllimi kryesor i shkollës është që të promovojë të mësuarit, ndërsa vlerësimi është pjesë integrale e këtij procesi. Meqenëse të mësuarit paraqet proces kompleks, atëherë edhe vlerësimi i të mësuarit është proces i tillë. Vlerësimi nxënësve u siguron informacione për nivelin e përvetësimit të mësimit, ndërsa mësuesit u siguron informacione që të promovojnë mësuesit më cilësorë, po ashtu u siguron informacione kthyes institucioneve arsimore dhe të gjitha palëve të interesit.

Realizimi i vlerësimit bëhet përmes qëllimit, parimeve dhe llojeve të vlerësimit.

Vlerësimi është pjesa më e rëndësishme e reformës së synuar në sistemin arsimor të Kosovës, nëpërmjet së cilës gjykohej se në çfarë niveli ndodhet arsimit dhe në çfarë niveli dëshirohet të jetë ai. Në tërësi vlerësimi si proces realizohet në funksion të mësuesit/vlerësuesit, të mësuesit dhe të nxënies, duke u ofruar nxënësve jo vetëm kritere të shkruara, por edhe modele ndryshme të llojeve të vlerësimit, për të kuptuar në mënyrë konkrete arritjet që ata i synojnë.

2. Qëllimet e vlerësimit

Vlerësimi ka këto qëllime kryesore:

- Përkrahjen dhe forcimin e të nxënies;
- Raportimin e rregullt të përparimit individual të nxënësve;
- Përbushjen me sukses të kompetencave të përcaktuara në Kurrikulë;
- Vendosjen dhe monitorimin e standardeve të arritshmërisë për çdo nivel;
- Krahasimin, certifikimin dhe orientimin e nxënësve për shkollim të mëtejshëm.

3. Parimet themelore të vlerësimit

Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë ka hartuar standardet kombëtare për vlerësimin me bazë në shkollë dhe kodin e etikës për vlerësim⁴. Vlerësimi gjithmonë të jetë në përputhje me normat e këtyre dy dokumenteve.

- Vlerësimi gjithmonë duhet t'u referohet kompetencave kryesore dhe rezultateve të të nxënies sipas fushave të Kurrikulës, fushës lëndore, për klasë, për shkollë dhe për nivel të shkollimit.
- Instrumentet për vlerësim gjithmonë duhet të jenë të përshtatshme, varësisht prej qëllimit të vlerësimit.
- Forma dhe lloji i vlerësimit dhe veçanërisht mënyra me të cilën raportohen rezultatet, gjithmonë duhet të reflektojnë qëllimin e vlerësimit.
- Mënyra e ndërtimit të vlerësimit gjithnjë duhet të jetë transparente dhe e drejtë.
- Vlerësimi gjithmonë duhet të zbatohet me standardet më të larta etike, me përgjegjësi dhe me llogaridhënie.

4. Vlerësimi i brendshëm

Vlerësimi i brendshëm ose me bazë në shkollë, kryesisht ka për qëllim përkrahjen dhe forcimin e të nxënies dhe raportimin e rregullt të përparimit individual të nxënësve.

Te vlerësimi i brendshëm zakonisht zbatohen këto dy lloje të vlerësimit:

- Vlerësimi i vazhdueshëm;
- Vlerësimi përfundimtar.

Vlerësimi i vazhdueshëm

Vlerësimi i vazhdueshëm është vlerësim në nivel të klasës, i cili udhëzon dhe përkrah të nxënies gjatë tërë vitit shkollor, ndërsa në fund të vitit shkollor vlerësimi raporton përparimin e nxënësve.

Vlerësimi i vazhdueshëm i nxënësve nga mësuesit gjatë procesit të mësimit fokusohet në:

4. Shih udhëzimet administrative "Standardet kombëtare për vlerësimin me bazë në shkollë" dhe "Kodi i etikës për vlerësim".

- evidentimin e rezultateve të të nxënësve, qëllimin e të nxënësve dhe kriteret e suksesit;
- përkrahjen për vetëvlerësim dhe vlerësim të ndërsjellë, duke u bazuar në kriteret e suksesit;
- dhënien e informatave kthyesë për performancat e nxënësve bazuar në kriteret e suksesit;
- evidentimin dhe raportimin e përparimit të arritjeve të nxënësve bazuar në kriteret e suksesit.

Vlerësimi i vazhdueshëm bëhet me nota numerike (1-5), që paraqesin shkallën e vlerësimit të arritjes së nxënësve në zotërimin e njohurive, shkathtësive dhe qëndrimeve për përmbushjen e kompetencave.

Në periudhat e rregullta kohore gjatë vitit shkollor, nxënësit duhet të kenë nota numerike. Mësimdhënësit do të vlerësojnë përparimin e nxënësve, bazuar jo vetëm në teste formale, por edhe në të dhënat e arritjeve që kanë mbajtur gjatë mësimdhënies së tyre, si: vëzhgimit, pyetësorëve, detyrave mësimore, eseve, dosjeve, grupeve në fokus, punës me projekte etj. Ata do t'i raportojnë rezultatet duke përdorur shkallët e vlerësimit që përfshijnë notat.

Nxënësit mund të tregojnë nivelin e arritjes së performancës së përcaktuara përmes dimensioneve të njohurive, shkathtësive, qëndrimeve dhe vlerave që kanë si në sasi, denduri, thellësi, ndihmesë, kreativitetit dhe cilësisë në zotërimin e kompetencave.

Nota 1 (dobët/pamjaftueshëm) përcakton performancën e pamjaftueshme në realizimin e detyrës së dhënë. Nxënësi nuk ka arritur nivelin e minimumit të zotërimit të kompetencave, ai nuk e arrin kufirin e kalimit të poshtëm të lejueshëm të lëndës/fushës lëndore.

Nota 2 (mjaftueshëm) përcakton performancën e mjaftueshme në realizimin e detyrës së dhënë. Nxënësi ka pak njohuri, paraqitet rrallë, ngadalë e sipërfaqësisht dhe është imitues. Ai ka arritur nivelin e minimumit të pranueshëm në zotërimit të kompetencave dhe përmbush kriterin e lejuar të kalimit të lëndës/fushës lëndore.

Nota 3 (mirë) përcakton performancën e mirë në realizimin e detyrës së dhënë. Nxënësi ka njohuri të pjesshme e të cekëta, paraqitet ndonjëherë dhe ka kreativitet të zakonshëm, ai ka arritur nivelin mesatar në zotërimin e kompetencave.

Nota 4 (shumë mirë) përcakton performancë shumë të mirë në realizimin e detyrës së dhënë. Nxënësi zakonisht ka njohuri të plota e të thella, paraqitet shpejt dhe ka imagjinatë, ai ka arritur nivelin shumë të lartë "dëshiruar" në zotërimit të kompetencave.

Nota 5 (shkëlqyeshëm) përcakton performancën e shkëlqyeshme dhe origjinale në realizimin e detyrës së dhënë. Nxënësi ka vazhdimisht njohuri të gjera e të thella, paraqitet automatikisht dhe është kreativ, ai ka arritur nivelin e shkëlqyeshëm të zotërimit të të gjitha kompetencave, e njëkohësisht përdor materiale dhe burime shtesë.

Gjatë procesit të vlerësimit në lëndë/fushë mësimore, nxënësi vlerësohet me notë duke marrë për bazë të gjitha nivelet e dijes, bazuar në rezultatet e të nxënësve për fushë/lëndë mësimore për arritjen e kompetencave.

Vlerësimi përfundimtar

Vlerësimi përfundimtar bëhet në fund të çdo viti shkollor dhe reflekton nivelin e performancës së nxënësve gjatë një viti shkollor.

Në fund të vitit shkollor, nxënësve u jepet nota përfundimtare. Kjo notë përfundimtare do të jetë në formë të një shkronje (A, B, C, D), që del nga mesatarja aritmetike e notave nga vlerësimi i vazhdueshëm gjatë vitit mësimor në nivel klase.

Përshkrimi i notës përfundimtare sipas shkallës së vlerësimit paraqitet si vijon:

Nota A	(mesatarja prej 4.5 deri 5.00)
Nota B	(mesatarja prej 3.5 deri 4.49)
Nota C	(mesatarja prej 2.5 deri 3.49)
Nota D	(mesatarja prej 2.0 deri 2.49)

Shembull të vlerësimit përfundimtar: Vlerësimi i vazhdueshëm, i realizuar në nivel klase gjatë një viti mësimor për një nxënës në njërin nga fushat/lëndët mësimore është bërë me 8 nota me vlerë numerike (1-5), sipas shkallëve të vlerësimit (3, 4, 5, 3, 2, 5, 2, 5). Mesatarja aritmetike e notave numerike në fund të vitit shkollor e nxjerr këtë no përfundimtare:

$$\frac{3+4+5+3+2+5+3+5}{8} = \frac{30}{8} = 3.75 = (\text{Nota } B)$$

Nota nga një lëndë/fushë lëndore, do të jetë bazë e raportimit për nxënësit dhe prindërit. Në raportin e shkollës për prindërit, notat duhet të shoqërohen me komente të shkurtra nga mësimdhënësi, se çfarë mund të bëjnë nxënësit për të përmirësuar arritjet e tyre dhe si mund të jetë përkrahja përmirësuese dhe përkrahja për të talentuarit.

Kjo qasje e vlerësimit përfshin të gjitha fushat mësimore dhe përfshin secilin nxënës. Nxënësit që nuk kanë arritur nivelin D (2.00-2.49), nuk e kanë arritur minimumin e domosdoshëm të rezultateve të të nxënës sipas fushës / lëndës mësimore për klasën përkatëse.

Në rast se nxënësi nuk e ka arritur minimumin e domosdoshëm të rezultateve të të nxënës, në jo më shumë se tri fusha/lëndë mësimore, i mundësohet mësimi plotësues. Mësimin plotësues e organizon shkolla me kohëzgjatje jo më pakë se dy javë mësimore dhe jo më pak se dy orë mësimore në ditë për fusha/lëndë mësimore përkatëse. Mësimi plotësues organizohet nga mësimdhënësi i fushës/lëndës mësimore përkatëse.

Vlerësimi përfundimtar i nxënësve, të cilët kanë ndjekur mësimin plotësues bëhet në shkollë nga mësimdhënësi i fushës/lëndës mësimore përkatëse.

Në rast se nxënësi as pas vijimit të mësimin plotësues nuk e ka arritur minimumin e domosdoshëm të rezultateve të të nxënës, atij i jepet e drejta për t'iu nënshtruar vlerësimit përfundimtar edhe një herë para përfundimit të vitit shkollor⁵.

Vlerësimi përmbyllës

Vlerësimi përmbyllës në nivelin e parë të arsimit bëhet në fund të shkollës së parë (klasa II) dhe në fund shkollës së dytë (të klasës V). Ky vlerësim nuk nxirret nga mesatarja e aritmetike e notave të regjistruara në ditar gjatë periudhës që mbulohet me shkollën përkatëse të Kurrikulës, por vlerësimi i nxënësit bëhet në bazë të listës së rezultateve të të nxënës sipas shkallëve të Kurrikulës për fusha kurrikulare të përcaktuara me Kurrikulen Bërthamë dhe secili rezultat vlerësohet me notë numerike (1-5). Mesatarja e aritmetike e këtyre notave si rezultat nxjerr notën përmbyllëse (A, B, C, D).

Shembull i vlerësimit përmbyllës: Një fushë lëndore brenda një shkalle, p.sh., ka 1-12 rezultate mësimore dhe për secilin rezultat nxënësi e arrin një notë numerike, mesatarja aritmetike e notave e nxjerr notë përmbyllëse

$$\frac{3+4+5+3+4+5+2+5+4+5+4+3}{12} = \frac{47}{12} = 3.92 = \text{Nota } B$$

Kjo qasje e vlerësimit përfshin të gjitha fushat mësimore dhe përfshin secilin nxënës.

Nxënësit që nuk kanë arritur nivelin D (2.00 - 2.49) vazhdojnë shkollën/klasën vijuese me programe shtesë në fushat përkatëse. Pas programit shtesë dhe vlerësimit përmbyllës, nxënësit të cilët nuk e arrijnë nivelin D nuk e vazhdojnë shkollën/ klasën vijuese⁶.

Nota përmbyllëse është vlerësim me bazë në shkollë, në bashkëpunim me autoritetet komunale me qëllim të planifikimit të masave për të siguruar nivelin e domosdoshëm të zotërimit të kompetencave kryesore nga të gjithë nxënësit.

Mësimdhënësi për vlerësimin e rezultateve për shkollë kurrikulare secilin rezultat duhet ta zbërthejë në pesë nivele të arritshmërisë në mënyrë që të vërejë saktësisht arritjen e secilit nxënës për çdo rezultat mësimor. Më pas, varësisht nga niveli i arritjes së secilit rezultat mësimor, planifikon aktivitete plotësuese për nxënësin që ka ngecje në arritjen e rezultatit të caktuar dhe planifikon aktivitete shtesë për nxënësin që i ka arritur të gjitha

5.Rregullohet me Udhëzim Administrativ.

6.Rregullohet me Udhëzim Administrativ.

nivelet e arritshmërisë për rezultatin e caktuar mësimor.

Në librezën e nxënësit dhe në dëftesën e përfundimit të nivelit të parë të shkollimit regjistrohen vetëm notat përmbyllëse të fushave kurrikulare.

5.Vlerësimi i jashtëm

Vlerësimi i jashtëm i arritjes së nxënësve organizohet nga autoriteti qendror profesional i arsimit me qëllim të verifikimit të gjendjes dhe nivelit të cilësisë të arsimit dhe vlerësimit në nivel shkolle, komune apo shteti.

Qëllimet themelore të vlerësimit të jashtëm shërbejnë për:

- Klasifikimin e nxënësve dhe orientimin për shkollim të mëtutjeshëm;
- Certifikimin e individit për përbushjen e kompetencave kundrejt qëllimeve të kurrikulës;
- Monitorimin e sistemit arsimor dhe për të raportuar mbi krahasimin dhe progresin e arritjeve të nxënësve, shkollave dhe komunave në nivel vendi dhe nxjerrjen e rekomandimeve për të gjitha palët e interesit (hartuesit e politikave dhe vendimmarrësit të cilët ndikojnë në përmirësimin e sistemit arsimor).

Certifikimi i zotërimit të kompetencave bëhet duke përdorur vlerësimin kombëtar i cili përgatitet nën mbikëqyrjen e autoriteti qendror profesional, i autorizuar nga MASHT-i. Vlerësimi kombëtar administrohet në fund të nivelit të dytë të arsimit parauniversitar (mbarimi i klasës IX) apo në mbarim të shkallës/klasës, varësisht interesave të politikave arsimore. Këto vlerësime janë të standardizuara dhe kryesisht janë të përqendruara në matjen e nivelit të arritjes në zotërimin e kompetencave kryesore. Kërkesat (pyetjet) e provimit duhet të vlerësojnë një varg gjithëpërfshirës/të hollësishëm dhe të balancuar të kompetencave të Kurrikulës dhe të rezultateve thelbësore mësimore. Rregullat dhe procedurat për këto vlerësime janë të përcaktuara nga ligjet përkatëse dhe udhëzimet administrative⁷.

Monitorimi i progresit përmes procesit të vlerësimit të jashtëm bëhet edhe nga MASHT-i nëpërmjet autoritetit qendror profesional.

Korniza e Kurrikulës gjithashtu, përveç vlerësimit të jashtëm u mundëson shkollave dhe autoriteteve komunale organizimin e vlerësimeve të jashtme në nivel komunal në fund të shkallëve të Kurrikulës, domethënë në fund të klasës II.

Ky vlerësim organizohet për të:

- vlerësuar punën e shkollave në përkrahjen e nxënësve për zotërimin e kompetencave kryesore;
- ngritur përgjegjshmërinë e mësimitdhënësve, të shkollave dhe komunave;
- siguruar zotërimin e kompetencave kryesore nga të gjithë nxënësit.

Ky vlerësim do t'u sigurojë një informatë kthyesë shkollave, prindërve, komunitetit dhe autoriteteve komunale mbi cilësinë e shërbimeve arsimore.

Rezultatet evidentohen në dosje të nxënësve⁸.

Niveli i ARRITJES së nxënësit				Llojet e përkrahjes për nxënësit				
1	2	3	4	5	Përkrahje përmirësuese	Mënyrat	Përkrahje për të talentuarit	Mënyrat
Nxënësi e fillon detyrën pa i bërë një shikim të shpejtë teksti; ai/ajo ka vështirësi në artikullimin e shkronjave dhe të leximit të fjalëve në tërësi, të lidhjes së fjalëve në fjali etj.	Nxënësi e fillon detyrën pa i bërë një shikim të shpejtë teksti; ai/ajo ka vështirësi në artikullimin e shkronjave, t'i lexojë mirë disa fjalë, ka megjithatë vështirësi në lexim të rrjedhshëm të fjalive në tërësi etj.	Nxënësi e fillon detyrën duke i bërë një shikim të shpejtë teksti: ai/ajo i artikulon mirë shkronjat, fjalët lidhen në fjali; megjithatë ai nuk lexon rrjedhshëm në mënyrë të mjaftueshme	Nxënësi e fillon detyrën duke i bërë një shikim të shpejtë teksti: ai/ajo i artikulon shumë mirë shkronjat, fjalët lidhen në fjalitë përkatëse; lexon pa ndërprerje; megjithatë ka ca problem me të leximin e rrjedhshëm	Nxënësi e fillon detyrën duke i bërë një shikim të shpejtë teksti: ai/ajo i artikulon shumë mirë shkronjat, fjalët lidhen plotësisht në fjalitë përkatëse; toni, shpejtësia, theksi janë në vendin e vet; lexon shumë rrjedhshëm	Mësuesi vendos se si të përkrahë nxënësin, ne cilin aktivitet apo çfarë aktiviteti plotësues të zhvilloj	Çfarë metodash të aplikojë duke pasur parasysh stilin e të nxënët të nxënësi	Mësuesi vendos se si të përkrahë nxënësin, në cilin aktivitet apo çfarë aktiviteti shtesë të zhvillojë	Çfarë metodash të aplikojë duke pasur parasysh stilin e të nxënët të nxënësit

7. Rregullohet me Udhëzim Administrativ.

8. Rregullohet me Udhëzim Administrativ.

Fjalorth i termave për mësimdhënës⁹

KONCEPTI	SHPJEGIMI	TERMAT E BARASVLERSHËM (anglisht, shqip dhe serbisht)
Llogaridhënia	Koncepti i qeverisjes etike (duke përfshirë qeverisjen etike të shkollës) që bazohet në njohjen dhe marrjen e përgjegjësisë për vendimet, veprimet dhe pasojat e tyre dhe ndërlidhet me pritjet për dhënien e llogarisë para palëve me interes.	
Gjuha artificiale	Një gjuhë e shpikur, e bazuar në disa rregulla të përkruara dhe të zhvilluar për një qëllim të caktuar, si për komunikim ndërkombëtar ose për programim në kompjuter.	P.sh. Esperanto, Pascal etj.
Vlerësimi	Procesi i mbledhjes së informatave dhe i nxjerrjes së gjykimeve lidhur me arritjen ose performancën e nxënësve.	
Vlerësimi për të nxënë	Synon të përkrahë nxënësit të arrijnë kompetencat kryesore duke u treguar se ku janë për sa u përket rezultateve mësimore të parapara. Bazohet në atë që t'i vetëdijesojë nxënësit dhe t'i bëjë pjesëmarrës në përcaktimin e rezultateve mësimore, kritereve të cilësisë dhe treguesve personalë të suksesit. Nxënësit mësojnë se çka duhet të bëjnë që të arrijnë ato rezultate të vendosura mësimore dhe si të arrihet atje.	Vlerësimi formativ
Vlerësimi i nxënies	Mbledhja e dëshmive valide, të besueshme dhe të krahasueshme për të vlerësuar progresin e nxënësve në nxënie (d.m.th. arritjen e tyre në fusha të ndryshme të Kurrikulës/lëndëve mësimore dhe zotërimin e kompetencave kryesore).	Vlerësimi përfundimtar
Metodologjia e vlerësimit	Strategjitë dhe aktivitetet e zbatuara, zakonisht nga mësimdhënësit (në vlerësimin e brendshëm) apo nga agjenci të specializuara (në vlerësimin e jashtëm), për të matur arritjen ose performancën e nxënësit.	
Qëndrimi	Pozicionimi i brendshëm drejt njerëzve, fakteve, fenomeneve, veprimeve, besimeve dhe situatave; gatishmëria e brendshme për të vepruar.	Dispozitat
Arsimi themelor	Vitet e shkollimit që konsiderohen të nevojshme për t'i arritur standardet minimale për zotërimin e kompetencave kryesore.	Zakonisht mbulon arsimin e detyrueshëm
Mësimdhënia në bllok	Mënyrë fleksibile për caktimin e orëve të mësimi duke përcaktuar periudha më kompakte të kohës për lëndët/njësitë (për shembull, mësimdhënia e një lënde gjatë një semestri prej gjashtë javësh në vend të orëve javore të shpërndara gjatë tërë vitit shkollor). Kjo mund të zbatohet kryesisht në rast të ndonjë lënde ku nuk kërkohen sekuenca jashtëzakonisht të rrepta.	

9. Termat që nuk janë relevantë për mësimdhënësit mund të hiqen.

Lëndë bartëse	Një lëndë që duke u bazuar në fushëveprimin dhe strukturën e saj është më afër të kontribuojë në arrijtjen e qëllimeve të caktuara të mësimin dhe mundëson zhvillimin e kompetencave të caktuara tek nxënësit (p.sh., arsimit për punë ose teknologji; zhvillim personal, aftësitë për jetë, studime sociale).	
Mjedis miqësor për fëmijët	Ambiente të të mësuarit të cilat janë miqësore, të bazuara në të drejta, gjithëpërfshirëse, të shëndetshme dhe mbrojtëse për të gjithë fëmijët. Ato po ashtu përfshijnë marrëdhënie të fuqishme mes familjeve/komunitetit dhe shkollës.	Shih konceptin e UNICEF-it për shkollat dhe sistemet arsimore miqësore për fëmijët dhe të bazuara në të drejta.
Vlerësim me bazë klase/ Vlerësimi nga mësuesit	Vlerësimi që kryhet rregullisht nga mësuesit në klasë si pjesë të mësimin të tyre dhe strategjive të mësimin, ofron informacion të menjëhershëm dhe të vazhdueshëm për sa i përket arrijtjes së nxënësve dhe problemeve në mësim.	
Kodi	Kodi është rregull për konvertimin e një pjese të informacionit (për shembull, një shkronjë, një fjalë, frazë apo gjest) në një formë apo paraqitje tjetër (një shenjë në një shenjë tjetër), jo domosdo në të njëjtin lloj. Në komunikim dhe përpunim të informacionit, kodi është procesi me anë të të cilit informacioni nga një burim konvertohet në simbole për t'u komunikuar. Dekodimi është proces i kundërt, konvertimi i këtyre simboleve në formë kodi përsëri në informacion të kuptueshëm prej një marrësi.	Me këtë i referohemi: - Kodi lingvistik (kur shprehet informacioni përmes mjeteve të ndryshme lingvistike – tingullit, fjalëve, shkronjave, fjalive etj. - Kodi artistik (ngjyra, forma e pikturës /dizajni /arkitektura; zëri – toni për muzikë; lëvizje, gjestet për vallëzim; gjuha – lëvizjet – mimika për dramë etj.
Komunikimi	Komunikimi është aktiviteti i bartjes së informacionit kuptimplotë. Komunikimi kërkon një dërgues, një mesazh dhe një marrës, megjithëse marrësi nuk ka nevojë të jetë i pranishëm ose në dijeni të qëllimit të dërguesit që të komunikojë me të në kohën e komunikimit; kështu komunikimi mund të ndodhë edhe në largësi të mëdha, si në kohë ashtu edhe në hapësirë.	Komunikimi kërkon që palët komunikuese e ndajnë bashkë një fushë të përbashkët të komunikimit, d.m.th. një kontekst. Procesi i komunikimit është i plotë në rastin kur pranuesi e ka kuptuar mesazhin e dërguesit.
Bashkësitë e interesit praktik	Bashkësitë e interesit praktik, sipas antropologut Jean Lave dhe Etienne Wenger, janë një grup njerëzish që kanë interesa, zanate dhe/ose profesione të përbashkëta. Grupi mund të zhvillohet natyrshëm për shkak të interesit të përbashkët të anëtarëve në fushën apo domenin e caktuar, ose mund të krijohet pikërisht për qëllim të fitimit të njohurive që kanë të bëjnë me fushën e tyre.	Community of practice Ndodh përmes procesit të shkëmbimit të informacionit dhe të përvojave me grupin ku anëtarët mësojnë prej njëri-tjetrit dhe se e kanë mundësinë që të zhvillohen personalisht dhe profesionalisht (Lave & Wenger 1991). Bashkësitë e interesit praktik mund të ekzistojnë virtualisht, si përmes grupeve të diskutimit dhe grupeve të tjera të lajmeve, ose në jetën reale, si në kuzhinë gjatë punës, në terren, në dyshemenë e fabrikës ose diku tjetër në mjedis

Kompetenca	Aftësi të gjera për t'i zbatuar njohuritë, shkathtësitë, qëndrimet, rutinën, vlerat dhe emocionet në mënyrë të pavarur, praktike dhe domethënëse.	Kompetenca/ Shkathtësitë (nganjëherë kompetencat barazohen me "shkathtësitë", veçanërisht në shprehjet si "shkathtësitë për jetë". Megjithëkëtë, sipas një përkufizimi më të përshtatshëm të kompetencave, shkathtësitë konsiderohen si pjesë përbërëse e tyre, së bashku me njohuritë, vlerat dhe qëndrimet (kompetencat gjithashtu përfshijnë rutinën, modelet e të menduarit, sjelljet).
Arsimi i detyrueshëm	Kohëzgjatja e shkollimit që konsiderohet si e obligueshme me ligj dhe (zakonisht) është falas për nxënësit dhe familjet e tyre. Përbërja e 'Arsimit të detyrueshëm' në Kosovë përfshin arsimin fillor, të mesëm të ulët dhe të mesëm të lartë (SNKA 1, 2 dhe 3).	
Periudha kontaktuese	Koha që caktohet zakonisht për bashkëveprimin sistematik mes mësimdhënësve dhe nxënësve në kuadër të një lënde, njësie mësimore dhe/ose mësimi.	
Qasjet konstruktiviste	Filozofia dhe praktikat që frymëzohen prej teorive të ndryshme konstruktiviste të mësimin dhe zhvillimit që thekson se të mësuarit ndërtohet përmes kulturës, përvojës individuale dhe shoqërore, si dhe bashkëveprimeve dhe konteksteve. Sipas teorive konstruktiviste, të mësuarit duhet të ketë kuptim (për të qenë kuptimplotë) për nxënësit në mënyrë që të jetë efektiv.	
Kurrikula Bërthamë	Kërkesat e përbashkëta për të gjithë nxënësit në aspektin e kompetencave kryesore, lëndët e përbashkëta dhe orientimet e përgjithshme.	
Çështjet e ndërlidhura ndërkurrikulare	Përmbajtje e rëndësishme kurrikulare që nuk i përket krejtësisht vetëm një lënde apo fushe të Kurrikulës ekskluzivisht mësimore, por që më së miri mësohet në disa lëndë. Shembuj të zakonshëm janë edukimi për paqe, të drejtat e njeriut dhe edukata qytetare, çështjet gjinore, shkathtësitë e komunikimit dhe edukimi ndërkulturor.	Temat e ndërlidhura

Kurrikulë	Tërësia e fushave mësimore, e lëndëve dhe e çështjeve ndërkurrikulare që gjenden në një sistem arsimor. Koncepti zakonisht përdoret për të nënkuptuar Kurrikulën “formale” apo “të parapare” (të shkruar), por mund të përfshijë edhe Kurrikulën “e paparapare” apo “të fshehur”. Po ashtu, bëhen dallime midis Kurrikulës “së parapare” (zyrtare), “të zbatuar”, “ndërvepruese” (që vjen si rezultat i ndërveprimeve në klasë) dhe “Kurrikulës efektive” (atë se ç’mësojnë në të vërtetë nxënësit).	Kurrikulat (sh.)
Korniza e Kurrikulës	Një numër politikash, rregulloresh, orientimesh dhe udhëzimesh që janë qenësore për zhvillimin dhe zbatimin e Kurrikulës që orienton zhvillimin e programeve mësimore dhe dokumenteve të tjera kurrikulare. Duke pasur parasysh statusin e Kurrikulës si një bosht të sistemit arsimor, kornizat e Kurrikulës zakonisht shihen si “kushtetuta” të arsimit parauniversitar. Kornizat e Kurrikulës mund të hartohen për tërë sistemin, për faza të veçanta (si arsimit themelor) dhe/ose për fusha dhe çështje të veçanta të Kurrikulës (si p.sh. korniza për integrimin e çështjeve të ndërlidhura në Kurrikulë).	
Integrimi i Kurrikulës	Procesi i kombinimit/artikulimit të përmbajtjes mësimore dhe lëndore me qëllim të promovimit të mësimi holistik dhe gjithëpërfshirës. Kjo shpie në reduktimin e një numri të lëndëve diskrete dhe zakonisht zbatohet në arsimin fillor dhe të mesëm të ulët.	
Politikat e Kurrikulës	Vendimet formale, të bëra nga qeveria ose autoritetet e arsimit që kanë një ndikim të drejtpërdrejtë ose të rëndësishëm në zhvillimin e Kurrikulës. Këto vendime zakonisht dokumentohen në dokumentet zyrtare të qeverisë.	
Struktura e Kurrikulës	Mënyra se si është organizuar Kurrikula në cilindo sistem, përfshirë lëndët dhe fushat e Kurrikulës, kur ato duhet të mësohen dhe ‘modelin’ me të cilin ato duhet të mësohen. Kurrikula mund të përbëhet, për shembull, prej Kurrikulës kryesore dhe zgjedhore, që mësohen me disa ndryshime midis klasave të ndryshme.	
Sistemi i Kurrikulës	Tërësia e dispozitave dhe e dokumenteve të Kurrikulës përmes të cilave u jepen udhëzime mësimdhënësve dhe palëve të tjera në lidhje me atë se pse, çka, si dhe sa mirë duhet të mësojnë nxënësit. Sistemi i Kurrikulës zakonisht përbëhet nga ligjet arsimore, kornizat e Kurrikulës, kurrikulat lëndore, standardet e vlerësimit, tekstet shkollore dhe materialet e tjera mësimore.	

Vlerësimi diagnostik	Vlerësim që zakonisht realizohet në fillim të procesit mësimor dhe fokusohet në identifikimin e aftësive dhe dobësive të nxënësve që duhet të merren parasysh për përkrahjen e nxënësve që të kapërcejnë problemet e ndryshme në nxënie.	
Mësimdhënia e diferencuar	Mësimdhënia e diferencuar nënkupton krijimin e programeve të shumëfishta ashtu që nxënësit me aftësi, interesa apo nevoja të ndryshme mësimore të përjetojë në mënyrë të barabartë rrugët e duhura për të absorbuar, për të përdorur, për të zhvilluar dhe për të prezantuar konceptet si pjesë e procesit mësimor të përditshëm. U mundëson nxënësve të marrin përgjegjësi më të madhe dhe pronësi mbi mësimin e tyre dhe ofron mundësi për mësimdhënien përmes shokut dhe nxënien në bashkëpunim.	
Kurrikula efektive	Ajo që nxënësit në të vërtetë e mësojnë në aspektin e dijes, qëndrimeve dhe shkathtësive.	Kurrikula e realizuar
Mësimi elektronik	Mësimi që bazohet në përdorimin e teknologjive të reja të informacionit dhe të komunikimit me qëllim të avancimit të qasjes në informata, e po ashtu edhe përdorimi efektiv dhe i përgjegjshëm i tyre në kontekstin (e zakonshëm) të aktiviteteve në distancë dhe në rrjet.	
Kurrikula zgjedhore	Fusha mësimore/lëndët të cilat nxënësit mund t'i zgjedhin në harmoni me interesat, talentet dhe nevojat e tyre.	
Edukimi për ndërmarrësi	Në kuptimin e ngushtë: përgatitja e fëmijëve dhe e të rinjve që të marrin role ndërmarrëse në ekonomi, d.m.th. të krijojnë bizneset/ndërmarrjet e tyre. Në kuptim më të gjerë: pajisja e fëmijëve dhe e të rinjve me shkathtësi ndërmarrëse siç janë iniciativa, vendimmarrja, ndërmarrja e riskut, udhëheqja, shkathtësitë menaxheriale dhe organizative.	
Mësimdhënia e zgjeruar dhe koha për të mësuar	Ndarja e një kohe më të madhe për mësimdhënie dhe mësimnxënie të fituar njohuri, shkathtësi dhe qëndrime të caktuara me qëllim që të nxitet mësimi i thellë dhe i qëndrueshëm.	
Të shprehurit	Të shprehurit mund t'i referohet shprehjes simbolike: të shprehurit (gjuhë), një mendim i komunikuar përmes gjuhës; Të shprehurit (matematikë), një kombinim i shtjelluar i simboleve që janë të formuara mirë sipas rregullave të aplikueshme; të shprehurit (programim), një udhëzim për të ekzekutuar diçka që do ta kthejë një vlerë; të shprehurit (përmes artit) (muzikës) që e shënon dinamikën muzikore.	Shprehjet trupore: Shprehjet emocionale, sjelljet verbale dhe joverbale që komunikojnë emocion; shprehjet e fytyrës, një lëvizje e fytyrës që përçon emocione; shprehja e gjeneve, procesim me të cilin informacioni prej një gjeni përdoret në biokimi; shprehje artistike (vallëzim, dramë, pantomimë, etj.)

Vlerësimi i jashtëm	Vlerësim që kryhet nga agjenci jashtë-shkollore apo bazohet në procedurat dhe instrumentet e ofruara nga agjenci jashtëshkollore (d.m.th. provimet e jashtme; testet e ofruara nga agjenci të specializuara të vlerësimit). Duhet të bazohet në standardet (kombëtare) të vlerësimit që subjektiviteti në vlerësim të zvogëlohet në maksimum.	
Aktivitetet ekstrakurrikulare	Aktivitete të strukturuar mësimore që ndodhin jashtë kontekstit të lëndëve dhe fushave mësimore formale. Në disa sisteme, këto mund të përfshijnë përvojë pune apo sport të organizuar.	
Kurrikula formale	Mundësitë dhe përvojat mësimore që u ofrohen nxënësve në kontekstin e arsimit formal. Kurrikula formale shërben si bazë për certifikata dhe dhënien e diplomave të pranueshme nga shoqëria.	Kurrikula e paraparë/zyrtare/e obliguar
Arsimi formal	Sistem arsimor i strukturuar në mënyrë hierarkike dhe me klasë kronologjike që fillon me arsimin parafillor deri në universitet duke përfshirë, përveç studimeve akademike të përgjithshme, një larmi të programeve të specializuara dhe institucioneve për aftësim teknik dhe profesional me orar të plotë. Rezultatet dhe kualifikimet e fituara në arsimin formal pranohen nga shoqëria përmes certifikatave dhe dhënies së diplomës.	
Vlerësimi formativ	Vlerësim që parimisht është i bazuar në klasë dhe realizohet nga mësimdhënësi me qëllim të përkrahjes së nxënësve që të përparojnë në mësim gjatë tërë një periudhe të caktuar kohore. E parashihet mësimin si proces e jo vetëm si rezultat (shiko po ashtu Vlerësimin për nxënie, me të cilin është i ndërlidhur).	
Arsimi I përgjithshëm (shkollat)	Arritja dhe zhvillimi nga nxënësit më përgjithësisht i një game të gjerë të dijes, shkathtësive dhe qëndrimeve që janë të ndërlidhura me lëndët/mësimin akademik e po ashtu edhe me jetën e punën.	
Kurrikula e fshehur	Besimet, qëndrimet dhe shkathtësitë që nxënësit i kanë apo i zhvillojnë përmes përvojave të tyre personale. Kurrikula e fshehur mund të jetë ose të mos jetë në harmoni me Kurrikulën zyrtare/të obligueshme.	
Mësimi holistik dhe i gjithanshëm	Mësimi që integron aspektet akademike me zhvillimin e nxënësve duke u përpjekur të trajtojë fenomenet si tërësi duke theksuar ndërlidhjen e dimensioneve dhe proceseve natyrore, shoqërore dhe personale.	Shih po ashtu “Mësimin e integruar”
Zhvillimi holistik	Progresi/zhvillimi i harmonizuar i të gjitha dimensioneve d.m.th. aspekteve intelektuale, emocionale dhe motorike.	Qasje për zhvillimin e “personit në plotësi”

Mjedisi për mësimin holistik	Organizimi i përcaktimit të të mësuarit që fton nxënësit për të bërë përdorimin e njëkohshëm intelektual, emocional dhe aftësitë motorike të tyre	
Arsimi gjithëpërfshirës	Arsimi gjithëpërfshirës përpiqet të adresojë nevojat për mësim të të gjithë fëmijëve me fokus të veçantë tek ata që janë të cenueshëm ndaj marginalizimit dhe përjashtimit. Ai nënkupton që të gjithë nxënësit – me ose pa paafësi – janë në gjendje të mësojnë së bashku përmes qasjes në mjedise të përbashkëta para-shkollore, shkolla dhe mjedise arsimore në komunitet me rrjet të përshtatshëm të shërbimeve përkrahëse.	
Arsimi informal	Përvetësimi dhe zhvillimi i dijes, i shkathtësive dhe i qëndrimeve jashtë mjediseve arsimore formale ose jo-formale gjatë përvojave të përditshme dhe në mungesë të procesit mësimor sistematik dhe të paraparë.	
Teknologjitë e Informacionit dhe të komunikimit (TIK)	Instrumentet dhe proceset e reja për të pasur qasje në informata dhe për t'i përpunuar ato, e po ashtu edhe për t'i komunikuar duke u bazuar në pajisje elektronike si kompjuterë, TV, internet, apo pajisje të tjera digjitale.	
Mësimdhënia e integruar dhe të mësuarit	Mësimi që reflekton dhe vë në pah lidhjet dhe ndër-lidhjet në jetën individuale dhe shoqërore (aktivitetet njerëzore), natyrë dhe dije.	Mësimi holistik dhe i gjithanshëm
Klasë bashkëvepruese	Mjedisi mësimor në nivel klase, që bazohet në shkëmbime të vazhdueshme mes mësimdhënësve dhe nxënësve në kontekstin e aktiviteteve të bazuara në kërkim, zgjidhje të problemeve dhe punë konkrete.	
Mësimdhënia dhe mësimnxënia bashkëvepruese	Filozofia dhe praktika e përfshirjes së nxënësve për të përcaktuar dhe për të ndërtuar përvojën e tyre mësimore duke marrë parasysh nevojat e tyre, interesat, dijen paraprake dhe kontekstin.	
Kompetencat kryesore	Kompetenca që konsiderohen nga sistemi i arsimit dhe aftësimi si të rëndësishme për të nxënësit e secilit nxënës dhe të kontribuuesve të rëndësishëm në jetën e secilit anëtar të shoqërisë. Kompetencat kryesore që janë më të përafërta me "Arsimin themelor" mund të njihen edhe si "kompetenca themelore".	Kompetencat gjenerike, transver-sale apo gjithëpërfshirëse

Shkalla kryesore e Kurrikulës	<p>Faza të caktuara përmes të cilave realizohet Kurrikula nëpërmjet niveleve dhe klasave të ndryshme të arsimit. Periudha që mbulojnë karakteristika të përbashkëta në aspektin e zhvillimit të fëmijëve, kërkesave të Kurrikulës dhe qasjeve të mësimdhënies e mësimnxënies për zhvillimin e nxënësve dhe përparimin në nxënie. Në Kornizën e Kurrikulës të Kosovës, shkallët kyç janë fazat e caktuara në nivelet e arsimit për të siguruar:</p> <ul style="list-style-type: none"> • më shumë transparencë dhe saktësi në artikullimin e qëllimeve arsimore dhe detyrave; • mundësi për udhëzime konkrete për organizimin e punës së shkollës me theks në metodat specifike, rezultatet mësimore dhe mjetet e vlerësimit; • mundësi për të ofruar sfida të reja për sa i përket zhvillimit të nxënësve dhe qëllimeve specifike të secilës shkallë kyç të Kurrikulës. 	
Të njohurit	<p>Konceptet dhe informatat faktike (të dhënat) e po ashtu edhe relacionet mes tyre (p.sh., strukturat dhe modelet) lidhur me mjedisin natyror dhe artificial, njerëzit dhe shoqërinë, kulturën dhe ekonominë dhe të pikëpamjet tona për botën, njerëzit dhe shoqërinë. Njohja deklarative vë në pah për të ditur lidhur me “çka”, ndërsa dija procedurale vë në pah njohuritë lidhur me “si”.</p>	
Ekonomi dhe shoqëri e dijes	<p>Shoqëri dhe ekonomi në të cilën dija bëhet burimi kryesor i zhvillimit dhe progresit (veçanërisht përmes internetit, mësimin elektronik dhe proceseve të ndërmjetësuar nga pajisjet elektronike).</p>	
Fushë kurrikulare	<p>Një kategori e gjerë mësimore që grupon lëndët që kanë qëllime dhe detyra të përbashkëta për mësimin e dijes, shkathtësive, vlerave dhe qëndrimeve. Bashkimi i lëndëve në një fushë të caktuar mësimore merr parasysh kontributin e tyre specifik në zhvillimin e nxënësve, në pajtim me qëllimet e përgjithshme e të veçanta të procesit mësimor në shkolla. Ai po ashtu merr parasysh mundësinë për qasjet multi dhe ndërdisiplinore e gjithashtu edhe realizimin e qëllimeve ndërkurrikulare.</p>	Curriculum area
Gjuha	<p>Gjuha mund t’u referohet ose aftësive specifike të njeriut për përvetësimin dhe përdorimin e sistemeve komplekse të komunikimit, ose shprehjes specifike të një sistemi të tillë kompleks të komunikimit. Studimi shkencor i gjuhës në çdo aspekt të tij quhet gjuhësi.</p>	<p>Përafërsisht 3000-6000 gjuhë që fliten nga njerëzit sot paraqet shembullin më domethënës, por gjuhët natyrale mund të bazohen edhe në stimulim vizual jo vetëm në atë dëgjimor, për shembull gjuha e shenjave dhe gjuha e shkruar. Kodet dhe llojet e tjera të sistemeve artificiale të konstruara, aso faresh që përdoren për programim në kompjuterë, po ashtu mund të quhen gjuhë.</p>

Perspektiva me nxënësin në qendër të vëmendjes	Filozofia dhe praktika e organizimit të mësimdhënies, mësimnxënies dhe vlerësimit nga perspektiva e nevojave, interesave dhe aftësive të nxënësve.	
Mësimnxënia	Procesi i fitimit, i absorbimit dhe i zhvillimit të dijeve, shkathtësive, vlerave dhe qëndrimeve të reja është i integruar në strukturat paraekzistuese, ndërsa gjithashtu përbën një bazë për përvetësime të reja.	
Përmbajtja mësimore	Temat, besimet, sjelljet, konceptet dhe faktet, shpesh të grupuara brenda një lënde ose fushe kurrikulare nën dijet, shkathtësitë, vlerat dhe qëndrimet që priten të formojnë bazën e mësimdhënies dhe të nxënimit.	Përmbajtja
Përvoja mësimore	Situatat dhe proceset përmes të cilave nxënësit i fitojnë/zhvillojnë dijet, shkathtësitë, vlerat dhe qëndrimet.	
Mundësitë mësimore	Situata dhe procese që kanë potencial për nxitjen e të mësuarit tek nxënësit.	
Rezultatet e të nxënimit	Deklarata që përshkruajnë atë se çfarë duhet të dinë nxënësit, të besojnë, të vlerësojnë dhe të jenë në gjendje të bëjnë. Rezultatet janë shprehur në Kornizën e Kurrikulës në një varg domenesh, përfshirë dijen, të kuptuarit, shkathtësitë dhe kompetencat, vlerat dhe qëndrimet.	Rezultate Rezultatet mësimore Kompetencat e nxënësve Rezultatet e nxënësve Arrijtjet e nxënësve
Burimi i të mësuarit	Referenca dhe përkrahje për mësimin e nxënësve, përfshirë tekstet shkollore, softuerët arsimorë, vegla eksperimentale, atllase, fjalorë, ushtrimore etj.	
Mësimi tërëjetësor	Pajisja e nxënësve me kompetencat e nevojshme për të qenë nxënës të suksesshëm gjatë tërë jetës.	
Aftësitë për jetë	Aftësi që u ofrojnë nxënësve kapacitete për të ndërmarrë detyra ose procese të ndërlidhura me jetën e tyre të përditshme.	
Arsimi i mesëm i ulët	Cikli i parë i arsimit të mesëm (katërvjeçar në Kosovë) (SNKA 2).	
Mësimi domethënës	Ndryshe nga mësimi përmendsh, shpie drejt zhvillimit të rrjeteve konceptuale (d.m.th. hartave konceptuale) që mund të aplikohen në situata të ndryshme dhe që mundësojnë kreativitetin dhe zgjidhjen e problemeve. Në lidhje me pikëpamjet konstruktiviste, po ashtu i referohet mësimi që ka kuptim për nxënësit (d.m.th. është i ndërlidhur me përvojat e tyre personale dhe është i orientuar në praktikë dhe punë konkrete).	
Koncepti shumështrësor i identitetit	Të kuptuarit e identitetit si rezultat kompleks edhe i faktorëve të paracaktuar edhe i faktorëve zhvillues për shkak të ekspozimit dhe pjesëmarrjes së individëve dhe grupeve të kulturave të ndryshme në kontekstin e fenomeneve aktuale të globalizimit.	

<p>Inteligjencat e shumëfishta</p>	<p>Teori bashkëkohore me ndikim që ka të bëjë me inteligjencën dhe personalitetin (H. Gardner), që thekson se inteligjenca të veçanta mund të detektohen në tru, në vend të një inteligjence të përgjithshme apo të gjenerike, zakonisht të përkufizuara si aftësi për të zgjidhur probleme në mënyrë efektive. Ajo kishte pasoja të rëndësishme në zhvillimin dhe zbatimin e Kurrikulës, posaçërisht përmes konceptit të qasjes me fëmijën apo nxënësin në qendër dhe modelit të zhvillimit të “tërë personit” në procesin e mësimin dhe të zhvillimit. Deri me sot janë identifikuar tetë inteligjenca të shumëfishta: gjuhësore; matematike logjike; hapësinore; kinestetike trupore; muzikore; ndërpersonale; intrapersonale; natyrore. Në mesin e këtyre tetë inteligjencave, si shtesë përmendet edhe inteligjenca ekzistenciale/shpirtërore/morale.</p>	
<p>Gjuha natyrore</p>	<p>Në filozofinë e gjuhëve, një gjuhë natyrore (ose gjuhë e zakonshme) është çdo gjuhë e cila ngrihet në mënyrë të paqëllimtë si rezultat i aftësive të lindura për gjuhën që posedohen nga intelektin njerëzor. Një gjuhë natyrore përdoret për komunikim dhe mund të flitet, të shënohet me shenja ose të shkruhet. Gjuha natyrore dallohet prej gjuhëve të konstruara të tilla si gjuhët e programimit në kompjuterë ose prej “gjuhëve” në studimin e logjikës formale, veçanërisht logjikës matematike.</p>	
<p>Arsimi joformal</p>	<p>Çfarëdo aktiviteti i organizuar dhe i qëndrueshëm që nuk korrespondon saktësisht me përkufizimin e arsimit formal. Prandaj, arsimi joformal mund të mbahet edhe brenda edhe jashtë institucioneve arsimore dhe u shërben personave të të gjitha moshave. Mund të përfshijë programe arsimore që adresojnë shkrim-leximin për të rritur, arsimin themelor për fëmijët që kanë braktisur shkollën, aftësitë për jetë, aftësitë për punë dhe kulturën e përgjithshme. Programet e arsimit joformal nuk ndjekin detyruesisht sistemin e ‘përshkallëzuar’ dhe mund të jenë të ndryshme në kohëzgjatje dhe mund të jepet ose të mos jepet certifikatë për suksesin e arritur në mësim.</p>	
<p>Kurrikula zgjedhor</p>	<p>Pjesa zgjedhore e Kurrikulës që përfaqëson lëndët dhe aktivitetet kurrikulare të vendosura në nivelin e shkollës.</p>	
<p>Vlerësimi shoku-shokun</p>	<p>Vlerësimi i nxënësve për punën e nxënësve të tjerë (mund të jetë edhe formativ edhe përfundimtar).</p>	
<p>Edukimi shoku-shokun</p>	<p>Proceset e mësimin të bazuara në këmbimin e informatave, dijes dhe përvojave mes shokëve në të cilat ata veprojnë si persona burimorë lehtësues të mësimin dhe/ose mentorë.</p>	
<p>Mësimdhënia shoku-shokun</p>	<p>Praktika në të cilën nxënësit marrin rolin e mësimdhënësit në një mjedis shkollor me qëllim të ndarjes së dijes dhe shkathtësive të tyre me nxënësit e tjerë.</p>	

Vlerësimi parashikues	Vlerësimi që synon të parashikojë dështimet dhe sukseset potenciale në zhvillimin e nxënësve me qëllim që të sugjerohen programe efektive për përparimin e tyre e po ashtu edhe veprime të duhura plotësuese në rast të mangësive (të pritura) në mësim.	
Arsimi fillor	Në Kosovë, periudha ose cikli i parë i arsimit prej pesë vjetësh kohëzgjatje, duke përfshirë edhe një klasë parafillore (SNKA 1).	
Aktivitetet përmirësuese	Mundësi dhe përvoja mësimore që ofrohen me qëllim të sigurimit të ndihmës për nxënësit që të kapërcejnë vështirësitë në të nxënë në mënyrë efektive.	
Autonomia e shkollës	Autonomia e dhënë për shkolla në aspektin e menaxhimit të burimeve financiare (me financim publik dhe privat), menaxhimin e burimeve njerëzore (drejtorët e shkollave, personelin arsimor dhe joarsimor) dhe vendimmarrjes brenda shkollave e po ashtu edhe sistemet e vlerësimit (llogaridhënia) e shkollave e realizuar në lidhje me këtë autonomi.	
Kurrikula me bazë shkolle (ose me bazë në institucion)	Pjesa e Kurrikulës që vendoset në nivel shkolle (ose institucioni).	
Arsimi i mesëm	Faza apo cikli i dytë i shkollimit, e ndarë në dy faza - e ulët dhe e lartë (SNKA 2 dhe 3).	
Vlerësimi selektiv	Vetëvlerësimi nga nxënësit i arritjeve dhe i problemeve të tyre në mësim. Sikur në rastin e vlerësimit shoku-shokun bazohet në shkathtësitë intelektuale të nivelit të lartë që i përdorin nxënësit për të vlerësuar mësimin e tyre në aspektin e proceseve dhe rezultateve.	
Vetëvlerësimi	Vetëvlerësimi nga nxënësit i arritjeve dhe i problemeve të tyre në mësim. Sikur në rastin e vlerësimit shoku-shokun bazohet në shkathtësitë intelektuale të nivelit të lartë që i përdorin nxënësit për të vlerësuar mësimin e tyre në aspektin e proceseve dhe të rezultateve.	
Mësimi i bazuar në shërbim	Mësimi që ndodh si rezultat i angazhimit të nxënësit në ofrimin e ndonjë shërbimi të organizuar, zakonisht në bashkësi lokale apo më gjerë.	Mësim i bazuar në shërbime për bashkësinë
Shenja	Një shenjë është diçka që nënkupton një lidhje midis vetvetes dhe objektit të tij. Një shenjë natyrore bart marrëdhënien e shkakut të objektit të tij – për shembull, vetëtima, bubullima është shenjë e stuhisë. Një shenjë konvencionale bëhet me pajtim, ashtu si pika që nënkupton fundin e fjalisë.	Ky është kontrasti me simbolin i cili qëndron për diçka tjetër, ashtu si flamuri që mund të jetë simbol i një kombi. Mënyra me të cilën shenja nënkupton diçka, quhet semiosis, e cila trajtohet në semiotikë dhe në filozofi të gjuhës. Shenja ka një (a) formë dhe (b) kuptim.

Simboli	Simboli është një realitet i cili paraqet një ide, një entitet fizik ose një proces, por dallon prej tij. Qëllimi i simbolit është të komunikojë domethënien e një forme të caktuar sintetike – më ndryshe prej realitetit të komunikuar. Për shembull, një oktagon i kuq mund të simbolizojë mbase kuptimin e “STOP-it”. Në hartë, fotografia e një tende mund të paraqesë një kamping. Numërorët janë simbole për numrat. Emrat e përveçëm janë simbole të paraqitjes së individit.	P.sh. simbolet matematikore, ikonat e kompjuterit, simbolet kombëtare (flamuri, himni etj.) simbolet fetare (kryqi, gjysmëhëna, etj.), emrat etj.
Shkathësia	Aftësia për ta zbatuar dijen për të kryer një detyrë të veçantë sipas një standardi të qëndrueshëm (dimensioni operacional/procedural i dijes).	
Kurrikula spirale	Modeli i zhvillimit të Kurrikulës që përfshin përsëritjen periodikisht të dijes, shkathësive dhe qëndrimeve të ndërlidhura me fusha kurrikulare/lëndë në kontekstin e përvojave mësimore të reja më të gjera e më komplekse. I shërben konsolidimit të mësimi paraprak dhe trajtimit më të thellë të përmbajtjes së ndryshme mësimore.	Rritja spirale e Kurrikulës/mësimi
Standard	1.Vendim, kërkesë ose rregull që pritet të zbatohet apo aplikohet (për shembull, “standardet e cilësisë/ Kurrikulës”). Standardet e Kurrikulës (cilësisë) mund t’i referohen përmbajtjes mësimore (standardet e përmbajtjes), proceseve (standardet e proceseve), rezultateve standardet e rezultateve), dhe mjediseve (standardet e mjedisit). 2.Niveli i arritjes apo suksesit që pritet të arrihet prej nxënësve nëse duhet t’u jepet ndonjë rezultat i caktuar.	
Lënda	Disiplinë e veçantë mësimore (të tilla, si matematika ose historia).	
Vlerësimi përfundimtar	Vlerësimi që përmbledh përparimin dhe arritjen e rezultateve mësimore nga nxënësit në një kohë të caktuar.	
Mësimi i qëndrueshëm	Mësimi i ndërlidhur me dhe në shërbim të zhvillimit të qëndrueshëm të shoqërisë, ekonomisë dhe mjedisit.	
Progresioni i mësimi të qëndrueshëm	Mësimi që bazohet në integrimin efektiv të mësimave të mëparshme në sistemet e reja të dijes, shkathësive dhe qëndrimeve.	

Programi mësimor	Dokument që përshkruan objektivat mësimore, rezultatet dhe përmbajtjen mësimore lidhur me një lëndë të veçantë. Programet mësimore moderne ofrojnë edhe udhëzime për zbatimin e tyre, duke përfshirë metodologji përkatëse për mësimdhënie dhe vlerësim.	Programi i mësimit në/për një lëndë të caktuar
Mësimdhënia	Aktivitet që realizohet me qëllim të nxitjes së mësimit tek nxënësit duke përdorur një gamë të gjerë metodash që u përshtaten stileve të mësimit të nxënësve.	
Fondi i orëve	Koha e caktuar për mësimdhënie dhe mësimin e një lëndë të veçantë apo fushe mësimore gjatë një viti apo jave shkollore. Korniza e Kurrikulës siguron alokim të kohës për punë në projekte dhe mësimdhënie e mësimnxënie bashkëvepruese.	
Vlerat	Ato që njerëzit i çmojnë si parime udhëzuese dhe referenca kryesore për zgjedhjet dhe sjelljet e tyre.	
Arsimi dhe aftësimi profesional	Arsimi dhe aftësimi për t'u mundësuar nxënësve që të fitojnë shkathtësi për punë dhe kualifikime profesionale për profesione të caktuara, përveç arritjes së kompetencave kryesore të përcaktuara përmes Kornizës së Kurrikulës.	

Bibliografia

- Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë (2011), Korniza e Kurrikulës e Arsimit Parauniversitar të Republikës së Kosovës, Prishtinë
- Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë (2011), Ligji për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës
- Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë (2007), Strategjia e Arsimit Parauniversitar e Kosovës 2007 - 2017 Prishtinë
- Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë. (2010). Plani strategjik për arsimin e Kosovës 2011 - 2016 Prishtinë.
- Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë (2012), Udhëzues për përmirësimin e praktikave në klasë, botimi për edukatorët parashkollorë në institucionet parashkollorë, grupmosha 0-3 vjeç dhe 3-5 vjeç.
- Ministria e , e Shkencës dhe e Teknologjisë (2012), Udhëzues për përmirësimin e praktikave në klasë, botimi për edukatorët parafillorë në institucionet parashkollorë dhe në shkolla; grupmosha 5-6 vjeç; klasa parafillorë, shkalla 1 e Kurrikulës.
- Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë (2012), Udhëzues për përmirësimin e praktikave në klasë. Udhëzues për mësimdhënësit Shkolla fillore, mosha 6-10 vjeç, klasat I – V, shkallët 1 dhe 2 të Kurrikulës, niveli 1 sipas SNKA
- Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë (2012), Udhëzues për përmirësimin e praktikave në klasë, botimi për mësimdhënësit/e, arsimit i mesëm i ulët, mosha 11- 14 vjeç, klasat VI-X, shkallët 3 dhe 4 të Kurrikulës, niveli 2 sipas SNKA
- Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë (2012), Udhëzues për përmirësimin e praktikave në klasë, botimi për mësimdhënësit/e, shkolla e mesme e lartë - gjimnazet / shkollat profesionale, mosha 15-17 vjeç, klasat X-XII, shkallët 5 dhe 6 të Kurrikulës, niveli 3 sipas SNKA
- Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë (2012), Udhëzues për përmirësimin e praktikave në klasë, Udhëzues për drejtorët e institucioneve parashkollorë, mosha parashkollorë 0-5 vjeç
- Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë (2012), Udhëzues për përmirësimin e praktikave në klasë, Udhëzues për drejtorët e shkollave, edukimi parafillor, mosha 5-6 vjeç, shkalla 1 e Kurrikulës, arsimit fillor, mosha 6-10 vjeç, klasat I-V, shkallët 1 dhe 2 të Kurrikulës, niveli 1 sipas SNKA, arsimit i mesëm i ulët, mosha 11-14 vjeç, klasat VI-IX, shkallët 3 dhe 4 të Kurrikulës, niveli 2 sipas SNKA
- Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë (2012), Udhëzues për përmirësimin e praktikave në klasë, Udhëzues për drejtorët e shkollave, shkolla e mesme e lartë - gjimnazet / shkollat profesionale, mosha 15-17 vjeç, klasat X-XII, shkallët 5 dhe 6 të Kurrikulës, niveli 3 sipas SNKA.
- Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë (2012), Udhëzues për Kurrikulën Zgjedhore, Prishtinë
- Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë (2012), Udhëzues për mentorim të mësimdhënësve nga drejtorët e shkollave, Prishtinë

Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë (2003), Plani dhe Programi Mësimor 1
 Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë (2004), Plani dhe Programi Mësimor 2
 Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë (2005), Plani dhe Programi Mësimor 3.
 Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë (2005), Plani dhe Programi Mësimor 4
 Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë (2005), Plani dhe Programi Mësimor 5
 Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë (2003), Plani dhe Programi Mësimor 6
 Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë (2004), Plani dhe Programi Mësimor 7
 Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë (2005), Plani dhe Programi Mësimor 8
 Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë (2002), Plani dhe Programi Mësimor 9
 Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë (2005), Plani dhe Programi Mësimor 9
 Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë (2003), Plani dhe Programi Mësimor 10
 Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë (2004), Plani dhe Programi Mësimor 11
 Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë (2005), Plani dhe Programi Mësimor 12
 Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë (2005), Plani dhe Programi Mësimor 13

Sternberg, R. & Subotnik, R., eds. (2006). *Optimizing Student Success with the Other Three Rs: Reasoning, Resilience, and Responsibility*. Greenwich, CT: Information Age Publishing

Wagner, T., Kegan, R., Lahey, L., Lemons, R., Garnier, J., Helsing, D., Howell, A., Rasmussen, H. (2006). *Change Leadership: A Practical Guide to Transforming Our Schools*. San Francisco: Jossey Bass

Perkins, D. "Integrating Thinking and Learning Skills across the Curriculum." In Jacobs, H. (1989). *Interdisciplinary Curriculum: Design and Implementation*

Alexandria, VA: Association for Supervision and Curriculum Development. Tucker, M.S. & Codding, J.B. (2002/1998)

Council of Europe official document, Daniel Coste (ed.), Marisa Cavalli, Alexandru Crişan, Piet-Hein van de Ven, *A European Reference Document for Languages of Education? Council of Europe, Language Policy Division, Strasbourg, 2007, 88 pp*

Departamenti i Arsimit dhe Shkencës (2001), *Korniza e Kurikulit të Ri të Kosovës*

Finnish National Board of Education (2004), *National Core Curriculum for Basic Education*

The National Curriculum Handbook for Primary Teachers in England (www.nc.uk.net)

The National Curriculum Handbook for Secondary Teachers in England (www.nc.uk.net)

Ministria e Arsimit dhe e Shkencës Tiranë (2008), *Korniza Kurrikurale e Gjimnazit*

Në hartimin e kurrikulave bërthamë morën pjesë:

Komisioni për finalizimin e kurrikulave bërthamë

1. Nehat Mustafa, zëvendësministër në MASHT
2. Drita Kadriu, këshilltare politike në kabinetin e Ministrit
3. Ragip Gjoshi, këshilltar politik në kabinetin e Ministrit
4. Xhavit Dakaj, sekretar i përgjithshëm në MASHT
5. Alush Istogu, drejtor i Departamentit të administratës së arsimit parauniversitar
6. Agim Berdyna, drejtor i Departamentit të zhvillimit të arsimit parauniversitar
7. Zeqir Veselaj, prodekan në Fakultetin e Edukimit
8. Ramush Lekaj, udhëheqës i Divizionit për sigurimin e cilësisë në arsimin parauniversitar
9. Enesa Kadiq, udhëheqëse e Divizionit për Minoritete
10. Ryve Prekorogja, Divizioni i Arsimit Profesional
11. Mustafë Kadriu, udhëheqës i Divizionit për Vlerësim dhe Standarde

Ekipi udhëheqës për koordinimin dhe hartimin e kurrikulave bërthamë

1. Ramush Lekaj, udhëheqës dhe koordinator i zhvillimit të kurrikulave
2. Shqipe Gashi, koordinatorë për nivelin e parë ISCED I
3. Laberie Luzha, bashkëkoordinatorë për nivelin e parë ISCED I
4. Ismet Potera, koordinator për nivelin e dytë ISCED II
5. Selim Mehmeti, koordinator për nivelin e tretë ISCED III
6. Ryve Prekorogja, bashkëkoordinatorë për nivelin e tretë ISCED III
7. Valbona Kadriu, bashkëkoordinatorë për nivelin e tretë ISCED III

Ekipe për koordinimin dhe hartimin e kurrikulave bërthamë sipas fushave kurrikulare

Gjuhët dhe komunikimi

1. Feime Llapashtica – MASHT, Koordinatorë e fushës dhe hartuese
2. Nezafete Kutillovci – MASHT, Bashk-koordinatorë dhe hartuese
3. Shejnaze Elezi - MASHT, Zyrtare për Plan Programe
4. Afërdita Hajdari – Mësuese kl. I-V, Shkolla Fillore “Elena Gjika”, Prishtinë
5. Dragoslava Macula – MASHT, Prishtinë
6. Hyrishahe Korça - X-XII Gjuhë shqipe, Shkolla e Mesme ” Sami Frashëri”, Prishtinë
7. Iqbal Bivernik - VI-IX Gjuhë turke SHMU “Sami Frashëri”, Prishtinë
8. Kujtim Rrahmani – Instituti Albanologjik i Prishtinës
9. Merita Zeqiri - Mësuese kl. I-V, Shkolla Fillore “Vëllezërit Frashëri”, Lipjan
10. Sadik Idriz – Gjuhë dhe letërsi boshnjake, Universiteti i Prishtinës, Prishtinë
11. Sevdije Maliqi - Shkolla Fillore e Mesme e Ulët “Meto Bajraktari” Prishtinë
12. Shkëndije Mejzini - I-V parashkollor, Shkolla Fillore “Fatmir Berisha”, Prishtinë
13. Shykrane Gërmizaj - Universiteti i Prishtinës, Prishtinë
14. Valona Gashi - Shkolla fillore “Hasan Prishtina”, Prishtinë

Artet

1. Besa Luzha, Fakulteti i Muzikës, UP - koordinatore e fushës dhe hartuese
2. Haki Xhakli, Fakulteti i Edukimit, UP - bashkëkoordinator dhe hartues
3. Adhurim Rasimi, Profesor i artit muzikor – Universiteti I Prishtinës
4. Gazmend Osmani, Mësimdhënës, Art Figurativ – Gjimnaz, Prishtinë
5. Muhamet Ahmeti, Fakulteti i Artit Figurativ, UP, Prishtinë
6. Nexhmi Bardhi, Mësimdhënës, Art Figurativ, Prishtinë
7. Violeta Krasniqi, Drejtoreshë e Shkolla e Muzikës, Prishtinë

Matematika

1. Mustafë Kadriu – MASHT, koordinator dhe hartues , MASHT
2. Nezir Hajdini - MASHT, bashkëkoordinator dhe hartues, MASHT
3. Armend Shabani - prof. në Fak. Mat. Nat.- për të gjitha nivelet
4. Fadil Latifi - mësimdhënës i m. klasor në shk. fill. dhe e m.ul - për nivelin I – Gjilan
5. Fehmi Sylejmani – mësimdhënës i matematikës në shk.fill.dhe e m.e ul.-për niv.II- Gjilan
6. Hadije Jashari – drejtoreshë shkolle – Shkolla fillore “Jusuf Rexha”, Mitrovicë
7. Ibe Gashi - mësimdhënës e matematikës në sh.f. dhe të m. ul. – për nivelin II – Prishtinë
8. Indira Huruglica mësimdhënës e shk. fill. dhe e m.ul - për nivelin I (parafillor) - Prishtinë
9. Isane Bajrami – mësimdhënës e matematikës në gjimnaz - për nivelin III- Prishtinë
10. Nexhmije Barani-mësimdhënës e matematikës në shk.f.dhe m.ul për nivelin II - Mitrovicë
11. Teuta Zogiani – mësimdhënës e matematikës në gjimnaz - për nivelin III - Prishtinë
12. Xhevat Krasniqi – prof. në Fak e Edukimit - për të gjitha nivelet
13. Zijadin Ibrahimimi – mësimdhënës i matematikës në sh. teknike - për nivelin III – Prishtinë

Shkencat natyrore

1. Rexhep Kastrati, MASHT - koordinator dhe hartues
2. Mirlinda Dehari Zeka, MASHT - bashkëkoordinator dhe hartuese
3. Agim Gashi - Departamenti i Biologjisë, UP-Fakulteti i Shkencave Matematiko-Natyrore, Prishtinë
4. Drita Curri - mësimdhënës X-XII e biologjisë, Gjimnazi “Gjergj Kastrioti”, Drenas
5. Fetah Podvorica, Prof. Dr. Kimi, Universiteti i Prishtinës, Prishtinë
6. Mirnije Halili - mësimdhënës VI-IX, Shkolla Mesme e Ulët “Meto Bajraktari”, Prishtinë
7. Rasim Bejtullahu – Departamenti i Fizikës, UP-Fakulteti i Shkencave Matematike-Natyrore, Prishtinë
8. Sadik Berisha - Mësimdhënës X-XII, Kimi, Gjimnazi “Bedri Pejani”, Pejë
9. Selvete Mujaj, Mësues I-V, Shkolla Fillore “Faik Konica”, Prishtinë

Shoqëria dhe mjedisi

1. Arbër Salihu, MASHT - koordinator dhe hartues
2. Besa Halimi Zagragja, MASHT - bashkëkoordinator dhe hartuese
3. Dashmir Bërxuli, Departamenti i Psikologjisë, Fakulteti Filozofik - Universiteti i Prishtinës,
4. Fehmi Rexhepi, Departamenti i Historisë, Instituti i Historisë, Prishtinë
5. Nexhat Rexha, Gjeografi, Gjimnazi ”Zenel Hajdini”, Gjilan
6. Pranvera Shemsedini , Mësimdhënës e Edukatës Qytetare, Shkolla Fillore “Jeronim De Rada”
7. Shemi Krasniqi, Departamenti i Sociologjisë, Fakulteti Filozofik, Universiteti i Prishtinës
8. Shemi Reçica, Departamenti i Filozofisë, Fakulteti Filozofik - Universiteti i Prishtinës
9. Sheribane Bahtiri, mësimdhënës, klasa VI-IX, Shkolla Fillore “Faik Konica” Prishtinë

Shëndeti dhe mirëqenia

1. Lulavere Behluli, MASHT - koordinatore dhe hartuese
2. Enesa Kadic, MASHT - bashkëkoordinatore dhe hartuese
3. Albana Desku, Psikologe - Shkolla Filllore "Zenel Hajdinii", Prishtinë
4. Bedri Çejku, Mësues i Edukatës Fizike - Shkolla Filllore e Mesme e Ulët "Mustafa Bakiu", Prizren
5. Diana Qarkaxhiu, Mësuese e nivelit I-V - Shkolla Filllore "Zekirja Rexha", Gjakovë
6. Emine Ahmetaj, Mësuese I-V - Shkolla e Mesme e Ulët "Pavarësia", Prishtinë
7. Hajrije Balidemaj, Shkolla Filllore "Naim Frasheri", Prishtinë
8. Merita Berisha, Mjete nutriceiste - Universiteti i Prishtinës - Fakulteti i Mjekësisë, Prishtinë
9. Qazim Elshani, Fakulteti i Edukatës Fizikës - Universiteti i Prishtinës
10. Ramzije Krasniqi, drejtoreshë në Entin parashkollor në SOS

Jeta dhe puna

1. Binak Gërguri, MASHT - koordinator dhe hartues
2. Radica Berisha, MASHT - bashkëkoordinatore dhe hartuese
3. Agron Zeqiraj, Arsimi i mesëm i ulët (klasa VI-IX) - Shkolla e Mesme e Ulët "Bajram Curri", Istog
4. Arbnor Pajaziti, Fakulteti i Informatikës, Universiteti i Prishtinës
5. Besiana Blakaj, Mësimdhënëse - Shkolla Filllore "Bajram Curri", Prishtinë
6. Kastriot Buza, Fakulteti i Edukimit - Profesor, Universiteti i Prishtinës
7. Mustafë Ukaj, Arsimi i mesëm i lartë X-XII, shkollat e AAP- Shkolla e Mesme Teknike "Shaban Spahija", Pejë
8. Myzafer Ademaj, Arsimi i mesëm i lartë - gjimnazet (klasa X -XII - Shkolla e Mesme Teknike "Gani Çavderbasha", Prizren
9. Nebi Caka, Fakulteti Elektronik, Profesor, Universiteti i Prishtinës
10. Rizah Haxhiu, Arsimi i mesëm i lartë X-XII shkollat e AAP - Shkolla e Mesme Teknike "Shaban Spahija", Pejë
11. Xhejlane Aliu, Mësuese - Shkolla Filllore "Elena Gjika", Prishtinë

Kontribues të tjerë:

- Arif Demolli - MASHT, Sektori për Tekste dhe Mjete Mësimore
 Abdurrahman Simnica - MASHT, Divizioni për Arsimin Profesional
 Fatime Jasiqi - MASHT, udhëheqëse e Zyrës për Gjini
 Igballe Cakaj - MASHT, udhëheqëse e Sektorit të Trajnimit
 Leonora Shala - MASHT, koordinatore për Shkollat promovuese të shëndetit
 Luan Sahiti - MASHT, Sektori i Trajnimit
 Merita Jonuzi - Bajraktari, MASHT - udhëheqëse e Sektorit për të Drejtat e Njeriut
 Nuhi Gashi - MASHT, Sektori për Diasporë
 Shukri Maxhuni - MASHT, Divizioni për Arsimin Profesional
 Shyhrete Reçica - MASHT, inspektore e arsimit

Konsulentët ndërkombëtarë e vendorë:

- Alexander Chrisan - EU SWAP
- Chris Waller - EU SWAP
- Eda Vula - EU SWAP
- Meriat Shala - EU SWAP
- Naser Zabeli - EU SWAP
- Osman Buleshkaj - EU SWAP
- Tom Gougeon - EU SWAP
- Xhavit Rexhaj - EU SWAP

Katalogimi në botim – (CIP)

Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës

37.016:373.3

Kurrikula bërthamë për arsimin e mesëm të lartë të Kosovës : (klasa X, XI, XII) / Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë. - Prishtinë : MASHT, 2012. - 138 f. ; 30 cm.

Bibliografia : f. 133-134

ISBN 978-9951-16-052-0



The first part of the book is devoted to a general history of the
 country, and to a description of the various parts of it. The
 author has endeavored to give a full and accurate account of
 the state of the country at the time of his writing, and to
 show the progress it has made since that time. He has also
 given a list of the principal towns and cities, and of the
 principal occupations of the people. The second part of the
 book is devoted to a description of the various parts of the
 country, and to a list of the principal towns and cities. The
 author has endeavored to give a full and accurate account of
 the state of the country at the time of his writing, and to
 show the progress it has made since that time. He has also
 given a list of the principal towns and cities, and of the
 principal occupations of the people.

The third part of the book is devoted to a description of the
 various parts of the country, and to a list of the principal
 towns and cities. The author has endeavored to give a full
 and accurate account of the state of the country at the time
 of his writing, and to show the progress it has made since
 that time. He has also given a list of the principal towns
 and cities, and of the principal occupations of the people.

The fourth part of the book is devoted to a description of the
 various parts of the country, and to a list of the principal
 towns and cities. The author has endeavored to give a full
 and accurate account of the state of the country at the time
 of his writing, and to show the progress it has made since
 that time. He has also given a list of the principal towns
 and cities, and of the principal occupations of the people.

ISBN 978-9951-16-052-0



9 789951 160520